

ETIKA

Revistë edukative-kulturore

Shqipëri: 150 Lek

Kosovë: 1 Euro

Maqedoni: 60 Den

Europa: 2 Euro

Mars 2011 • Numri: 36 • E përmuajshme

Mbulesa Islame



EDITORIAL

*H*istorikisht, mbulesa daton që nga njeriu i parë, Ademi (a.s.) dhe bashkëshortja e tij Havaja. Allahu (xh.sh.), krijoi rrobat për ta dhe i udhëzoi se si të visheshin. Kjo është edhe arsyeja që mbulesa si dispozitë fetare ka ekzistuar që para Islamit, pra edhe tek ithtarët e Librit, ku përfshihen të krishterët dhe çifutët. Këtë e dëshmojnë shumë citate nga Dhjata e Vjetër dhe e Reja.

Dijetarët islam, njëzëri, pranojnë se mbulesa është një kusht i domosdoshëm i fesë. Vendimin e tyre ata e mbështesin në disa ajete kuranore dhe në traditën e mrekullueshme të Profetit.

Shamia në fenë islame nuk është petku i një besimtareje misionare, teologeje, por petku i çdo femreje që i përket kësaj feje. Sigurisht shamia e kokës nuk ka lidhje fare me dhunën apo imponimin, pasi vetë islami nuk ka lidhje me këtë. Por ajo femër myslimane që zgjedh rrugën e vetëdijësimit islam, me vullnetin e saj të lirë vendos të përmbushë një urdhër të Allahut të Lartmadhëruar, të Vetmit që i takon të na japë urdhra.

Mbulesa islame nuk duhet të shikohet si një simbol. Islami nuk ka simbole, sepse nuk mund të ndihet dot i përfaqësuar tërësisht prej tyre. Shamia për një femër simbolizon devotshmërinë dhe pastërtinë e saj, por jo islamin në tërësi. Islami nuk është fe e një gjinie të vetme. Funkcioni mbulues i shamisë, si i shumë veshjeve të tjera, është jashtë konceptit të simbolikave.

Duhet theksuar fakti se shamia nuk është diçka arabe, por një urdhër hyjnor për mbarë njerëzimin në të gjitha besimet hyjnore, për t'i dhënë gruas mbrojtje dhe siguri. Ato gra, të cilat zbatojnë urdhrin kuranor për t'u mbuluar, shfaqin kulturën dhe civilizimin hyjnor dhe jo atë lindor.

Sot, fatkeqësisht, të pakta janë femrat myslimane të dalluara në fusha të ndryshme. Si mund të kemi shumë të tilla, kur ua mohojmë të drejtën e mësimin, të drejtën e studimit dhe të punës?! Mënyra më e mirë për t'i dhënë një mundësi femrës myslimane është të mbështeturit në parimin bazë të pluralizmit: *të kemi respekt për të ndryshmen*. Nuk është e domosdoshme të pëlqehet "mbulesa" për të mbrojtur të drejtat e atyre që e pëlqejnë. Shenja e vërtetë dalluese e një shoqërie të civilizuar është mbrojtja e të drejtave të të tjerëve, kur ato nuk bien ndesh me parimet njerëzore të bashkekzistencës. Pluralizmi kulturor bazohet në pranimin e "tjetrit" siç është dhe jo si do të donim të ishte.

Do të lexoni:



Selaheddin Kip /
Mbulesa Islame

4



Selaheddin Kip / 4

Prof. dr. Njazi Kazazi / 9

Prof. dr. Hasan K. Jëllmaz / 12

Doc. dr. Sulejman Derin / 14

Redi Shehu / 16

Imam Muhamed Sytari / 18

Nexhat Ibrahim / 21

Ma. Gilman Kazazi / 24

Sadik Dana / 26

Fariduddin Attar / 27

Suela Dibra (Kaca) / 28

Mbulesa Islame

Koha, një pasuri që duhet ta shfrytëzojmë me dobi

Shpresë

Mendja dhe Udhëzimi

Barra e intolerancës

Sahabët e Resulullahit (a.s.) yjet e kësaj feje, prijësit tanë...

Orientalistët dhe Hadithi

Shamia, arsimi dhe laiciteti

Të rinjtë dhe koha e agimit

Qëlloni këtu
Ata që mbërrijnë qëllimin

Mes stereotipeve,
diskriminimit
dhe të vërtetës së besimit

Imam Muhamed Sytari /

Sahabët e Resulullahit (a.s.) yjet e kësaj feje

18



Sadik Dana /

Të rinjtë dhe koha e agimit

26



Viti: VI | Numri: 36 | Mars 2011

Administrator i Progresi botime:

Shuaip Bashhan

bashan43@hotmail.com

+355 69 20 76768

Drejtor & Kryeredaktor:

Alban Kali

albankali@yahoo.com

+355 69 24 23989

Përkthyesit:

Alban Kali / Albert Halili

Elvira Puka / Elona Sytari / Evans Drishti

Fatmir Sulaj / Ilir Hoxha / Merxhan Shehu

Redaktor:

Zija Vukaj

Korrektore:

Ma. Irida Hoti

Dizajn - Grafik:

Bledar Xama

bledar_xama@hotmail.com

Për artikuj

e-mail: revistaetika@progresibotime.com

e-mail: kosova@progresibotime.com

e-mail: maqedoni@progresibotime.com

Mars 2011

32

Osman Nuri Topbash /

Toleranca dhe durimi ndaj të paditurve



40

Mr. sci. Flamur Sofiu /

Transplantimi, mbjellja e organeve të trupit



48

Maksud Aftab /

Si ndikoi Islami në shkencë



/ 30- 31

Një ajet - një hadith

Osman Nuri Topbash / 32

Toleranca dhe durimi ndaj të paditurve dhe nopraneve

Mr. sci. Flamur Sofiu / 40

Transplantimi, mjellja e organeve të trupit, onduksioni dhe dhënia e gjakut

Vehap S. Kola / 44

Me shami të bardhë

Fariduddin Attar / 45

Mjeshtri në pikën e vdekjes
Një shërbëtor
që i mungon druajtja

Imam Naim Drijaj / 46

Mbulesa është besim, jo simbol

Maksud Aftab / 48

Si ndikoi Islami në shkencë

Enciklopedi Islame / 50

Farabiu

Ma. Ermal Nurja / 52

90 vjet pas kongresit të Prishtës,
në Skrapar

Familja / 54

Vazhdimësia e dritës Profetike,
Hz. Fatma (r.a.)

Shëndeti / 56

Ilaçi i ri për shërimin e shpejtë
të djegieve

Teknologji / 58

Shi në shkretëtirë



Adresa:

L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi

Shkodër / Albania

Tel: +355 22 254 634

Fax: +355 22 254 633

Zyra e përfaqësimit Maqedoni

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25

Shkup / Maqedoni

+389 71 956 271

Zyra e përfaqësimit Kosovë:

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin

Prizren / Kosovë

Tel: +381 29 222 795

Fax: +381 29 222 797

+377 441 63 651

Çmimi:

Shqipëri: 150 Lekë

Abonim (një vjetor): 1500 Lekë

Kosovë: 1 Euro

Abonim (një vjetor): 10 Euro

Maqedoni: 60 DEN

Abonim (një vjetor): 720 DEN

Europë: 2 Euro

Abonim (një vjetor): 24 Euro

MBULESA Islame

Komentimi i Ajetit 31 i Sures Nur

Selahaddin Kip

Tesettur në fjalor do të thotë mbulesë. Kjo temë është një prej çështjeve të rëndësishme të fesë islame. Ajo sot po e mbush axhendën me shfaqje që trazon një pjesë të popullit. Për këtë arsye dëshiroj të shpjegoj rregullat e kësaj teme në aspektin fetar.

Në konsultimet dhe debatet që janë bërë mbi këtë çështje ka edhe prej atyre njerëzve që ia turbullojnë mendjen popullit duke bërë shpjegime të ndryshme, të cilat nuk e argumentojnë njëra-tjetrën.

Në çështjet fetare, para mendimeve dhe opinioneve racionale e intelektuale duhet të njihet në mënyrë të qartë dhe të pakomentueshme gjykimi i fesë.

Siç dihet feja nuk është çështje imponimi. Gjëja që imponohet në të vërtetë del nga të qenët fetare. Njerëzit që i besojnë fesë kanë të drejtë dhe detyrë që t'i dinë ligjet fetare, që të dinë të jetojnë atë që u urdhëron feja. Për shkak se dijetarët e fesë janë ata që do t'ua mësojnë njerëzve këtë, duhet t'ua shpjegojnë në mënyrë të pavaruar, ashtu siç janë të pavarura dhe të pakomentueshme çështjet fetare. Në të kundërt kanë një përgjegjësi të madhe. Për këtë arsye duhet t'u referohemi burimeve të fesë. Feja ka katër burime kryesore:

1. Kurani Fisnik
2. Tradita e të Dërguarit të Allahut
3. Konsensusi i dijetarëve
4. Analogjia e juristëve Islamë

Le të shikojmë me radhë se si është vendosur ligji në lidh-

je me këtë çështje.

Shprehjen më të qartë e shohim në ajetin e 31 të sures En-Nur. Aty thuhet:

“O i Dërguari im! Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara) dhe ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)! Kjo është më e pastër për ta! Me të vërtetë, Allahu është i dijsëm për atë që bëjnë. Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara), ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme) dhe të mos i hapin vendet e stolive të tyre, përveç atyre që janë të dukshme. Le t'i mbulojnë kraharoret me mbulesat e tyre (të kokës) dhe të mos i shfaqin vendet e stolive të tyre...”

Në pjesën tjetër vijuese të ajetit tregohen se kujt prej të afërmeve mund t'ua tregojnë stolitë e tyre. Ne këtu do të bëjmë analizën e fjalëve që kalojnë në ajet dhe të shikojmë se çfarë dispozite shprehin!

“Ulja e shikimeve” në ajet është shprehur me fjalën **“Gad”**. Gadd shpreh “uljen e shikimeve”. Domethënë, nëse e ul shikimin ndaj diçkaje, nuk do ta shikosh atë. Por këtu është lidhësa “min”, e cila tregon se nuk kërkohet që të ulen shikimet plotësisht. “Min” shpreh teb'iz (pjesshmëri). Domethënë, shpreh se kërkohet të ulen një pjesë e tyre. Nisur nga kjo, qëllimi është ulja e shikimeve kundrejt gjërave që janë problematike. Domethënë është e pjesshme.

Kur i jepet kuptimi ajetit, janë disa rregulla të rëndësishme që duhet të respektohen. Së pari duhet që fjala t'i përshtatet

kuptimit. Po ashtu duhet që ai kuptim të mos bjerë në kontradiktë me ndonjë ajet tjetër. Ai nuk duhet të ketë kontradiktë me çdo lloj ligji të vërtetuar me traditën profetike apo me konsensusin e dijetarëve. Uljen e shikimeve këtu e kuptojmë nga fjala e ajetit se është nderi. Por ky hadith fisnik shpjegon se ulja e shikimeve nuk duhet të jetë e plotë. *“Birit të Ademit i është shkruar një pjesë nga zinaja dhe ai do të njolloset me të. Zinaja e syrit është të shikuarit, zinaja e gjuhës është të folurit, zinaja e veshit është të dëgjuarit, zinaja e dorës është të prekurit, zinaja e këmbëve është të ecurit pas saj, vetja këtë e dëshiron dhe ndjen oreks për të. Organi gjenital ose e vërteton ose e përgënjeshtrohet.”* (Transmetojnë Buhari, Muslimi dhe Ebu Davudi)

Ndërsa një hadith tjetër fisnik, thotë: *“Jini vetvetja dhe mos qëndroni në rrugë! Por nëse thoni se do të qëndrojmë patjetër, atëherë jepini hakun rrugës.”* Kur i thanë: *“Cili është haku i rrugës, o i Dërguari i Allahut?”* Ai u përgjigj: *“Ulni shikimet, mbajeni dorën, ktheni përgjigje nëse ju jepet selam, urdhëroni për të mirë dhe ndaloni nga e keqja!”* (Buhari, Muslim, Ebu Davud)

Nga këto kuptojmë se qëllimi i uljes së shikimit që kalon në ajet nuk është vetëm ulja e shikimit, por është ulje shikimi për të ruajtur nderin. Në lidhje me këtë çështje ka edhe fjalë të urta. Hammasi në një strofë të tij thotë:

“Nëse ti e lë syrin të lirë, shikimet do të të lodhin një ditë. As nuk është e mundur që të arrish çfarëdo që shikon, as nuk të ngelet durim mbi disa gjëra!”

Edhe Shevkiu në një strofë të tij thotë:

“Është një shikim, është një e qeshur e hutuar, është një selam, është një fjalë, është një caktim dhe është një takim.” Ndikimi që ka mbi marrëdhëniet të shikuarit dhe të shikuarit e ndërsjelltë ndërmjet njerëzve nuk mund të mohohet... Në ajetin që njofton për zinanë, thuhet: **“Mos iu afroni zinasë!”** (17/32) Domethënë se çdo lloj gjëje paraprake që të afron te zinaja, është bërë haram. Fjalja **“Kjo është më e pastër për ju.”** që kalon në ajetin fisnik, i mëson njerëzit të qëndrojnë të pastër pa u njollosur. Edhe në një vend tjetër kur flet për bashkëshortet e pastra të të Dërguarit të Allahut, thotë: **“Nëse do të kërkonit diçka prej tyre, kërkojeni pas perdes. Kjo është më e mirë për ju dhe për to, që zemrat tuaja të ngelin të pastra.”**

Në hadithin fisnik thuhet: *“Dijeni që një burrë dhe një grua kurrë nuk duhet të qëndrojnë vetëm pranë njëri-tjetrit. Nëse do të qëndrojnë pranë, patjetër i treti i tyre është djalli. Jini vetvetja dhe mos u ndani nga xhemati! Djalli është më afër atij që qëndron vetëm dhe më larg nga ata që qëndrojnë dy bashkë.”* (Tirmidhi) Në këtë mënyrë na ka mësuar masat paraprake që duhet të respektohen, që myslimanët të mos njollosen me papastërti. Këto në gjuhën e legjislacionit Islam quhen



“Seddudhderaji”. Ai na ka mësuar dhe na ka këshilluar që të qëndrojmë larg këtyre, përderisa nuk është e nevojshme. **“Ai që pastrohet, pastrohet për veten e tij”.**

Në ajet thuhet: **“Vela jubdine zinetehunne. Të mos i shfaqin vendet e stolive të tyre.”** Kjo fjali në ajet përsëritet dy herë. Kjo sigurisht që tregon rëndësinë që ka. Çfarë synohet me “stolitë” kur thuhet: **“Të mos i shfaqin vendet e stolive të tyre.”?** Dijetarët në lidhje me këtë kanë thënë: “Gjendja është përmendur, ndërsa vendi është synuar”. Stolitë këtu nuk janë objekte zbukurimi si gjerdani, varësja, byzlyku, vathi, makiazhi, unaza e martesës etj. Këto gjëra nuk është problem të duken. Ato nuk janë të ndaluara të duken në argjendari, në dyqan, në kuti apo në vende të ngjashme me to. Por vendet ku vendosen këto, edhe nëse nuk janë stolitë, është ndaluar të ekspozohen, sepse ajo që bëhet shkak për përçarje, ajo që ua hap derën gjërave imorale nuk janë vetë këto gjëra, por ekspozimi i vendeve ku varen ato. Ata që i prishin këto veprime të cilat janë qartazi haram në fe dhe për të cilat njoftohen se janë shkak për përçarje, nëse këto nuk i pranojnë si stoli, përse duan t’i ekspozojnë me insistim? Pastaj këto, a nuk janë amanet? Në fe është sqaruar se kush e ka të lejuar të përfitojë nga këto. Të tjerët e kanë haram që të përfitojnë nga këto me sytë e tyre, me veshët e tyre, me duart e tyre dhe me çdo lloj organi tjetër të tyre. Ky është një ligj i qartë. Çdo mysliman, i cili dëshiron ta mësojë



këtë, mund t'i gjejë dhe t'i mësojë këto dispozita me lehtësi. Në komentimin e ajetit Zemahsheri ka thënë: "Këtu fakti që është përmendur vetë stolia dhe nuk është përmendur vendi i stolisë është për mbrojtjen dhe lartësimin e mbulesës. Fakti që ekspozimi i stolive është haram vjen nga ekspozimi i vendeve të tyre. Stoli është emri i diçkaje të bukur dhe të zbukuruar. Për shembull, mund të ketë stoli prej mineraleve të shtrenjta, si floriri dhe argjendi ose artikujt e makiazhit. Po ashtu njeriu mund të ketë bukuritë e krijimit që janë në natyrën e tij. Me të vërtetë bukuria e dytë (natyralja) është më tërheqëse. Për shkak se bukuria mund t'i japë shkas përçarjes, rreziku i bukurisë së dytë është më i madh. Atëherë është edhe më e rëndësishme që të largohemi nga fitneja e saj. Kurani Fisnik e paralajmëron njeriun kundrejt këtij rreziku. Për këtë arsye afrimi ndaj këtyre është bërë haram.

Imam Ibnu'l-Kajjimi jep këtë shpjegim në lidhje me ruajtjen e syrit: "Këtu ka disa përfitime: 1- Bindje ndaj urdhrit të Allahut që është lumturia më e madhe. 2- Mbrojtja nga rreziku i shigjetës së helmosur. 3- Kjo e qetëson zemrën duke e forcuar atë. Kjo çështje është shpjeguar kështu në një hadith kudsij: "Shikimi është një nga shigjetat helmuese të djallit." 4- Në zemër i shfaqet një miqësi me të cilën vjen në vete. 5- Ai fiton një dritë nga zemra. 6- Fiton një perceptim me të cilin e ruan të ardhmen nga rreziku. 7- Mbyll dyert e hyrjes së dja-

llit. 8- Ndërmjet syrit dhe zemrës hapet një dritare ku lind një ndjenjë komunikimi." (Sabuni, Ajetet e hukmit, 2/143)

Për frazën "**Përveç atyre që janë të dukshme**" që kalon në ajet, thuhet se në lidhje me pjesët që duken vetë ka komentime që vijnë nga disa sahabë dhe tabiinë. Sa'id bin Xhubejr, Ata Dahhak dhe Ibn Abbasi, të cilët janë disa prej tyre, e kanë komentuar si "duart dhe fytyra". Veçanërisht këtë temë e kanë marrë nga ky hadith fisnik që transmetohet nga Hazreti Aishe.

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, shkoi te vajza e Ebu Bekrit, radijallahu anh, Esmā. Ajo kishte veshur një rrobë të hollë. Kur i Dërguari i Allahut e pa këtë, i ktheu kurrizin duke i thënë: "O Esmā, kur gruaja të arrijë moshën e pubertetit, nuk bën që të tregojë përveç kësaj e këtyre", i tregoi fytyrën dhe duart. (Ebu Davudi në Libas). Domethënë se kjo pjesë e cila duket vetë nuk është ajo që disa e kanë komentuar sipas dëshirave dhe pasioneve të tyre, por e shikojmë si një kufi që e ka vendosur vetë feja. Kalimi i kësaj është dhunim i kufirit dhe ndërhyrje në fe, gjë që bie ndesh me kuptimin fetar.

Ndërsa për pjesën "**Veljadribne bihumurihinne ala xhujubihinne / Le t'i mbulojnë kraharoret me mbulesat e tyre (të kokës)**", thuhet se ky është një urdhër. Urdhri absolut shpreh detyrim. Urdhrrat që shprehin lejim apo lutje duhet të kenë një kajd (lidhje) dhe një karine (një shenjë, një të dhënë). Në vende ku nuk ka një gjë të tillë dijetarët kanë rënë në konsensus se aty shprehet detyrim. Atëherë, të thuash se ky urdhër nuk shpreh detyrim, është mohim i bazave shkencore dhe shkelje e rregullave të fesë, gjë që shfaq rrezik fetar, Allahu na ruajt. Ai që pohon diçka të tillë ka kundërshtuar konsensusin e dijetarëve dhe nuk mund të gjejë argument që vërteton se e pranon fenë. Në shumë komentime apo përkthime të komentimit të këtij ajeti fisnik thuhet: "Le ta mbulojnë qafën me mbulesën e kokës." Unë këtë shprehje e shoh të mangët dhe të pamjaftueshme. Ndërmjet shprehjes "Le t'i mbulojnë shamitë e tyre" dhe "le t'i mbulojnë me shamitë e tyre" ka dallim. Kur thuhet shami, shamia ka një detyrë të vetën, e cila është të mbulojë kokën. Pa i sjellë ndonjë mangësi kësaj detyre kryesore dhe duke përfituar nga një anë e saj, këtu ka edhe mbulim të kraharorit. Faktikisht kjo është ajo që urdhërohet. Këtë duhet ta kuptojnë nga struktura e fjalës. Kështu "Humur" është shumësi i "Himar". Nëse në shumës hyn harful xherr shpreh pjesshmëri. Po kështu në ajetin që lajmëron për fshirjen e kokës gjatë abdestit shkronja be e xherrit ka hyrë te "ruus" e cila është shumësi i "re's". Këtu është kuptuar se duhet të fshihet një pjesë e kokës. Edhe këtu me një pjesë të "humurit" është urdhëruar mbyllja e mbulimi i kraharorit. Shprehja "Të mbyllë mbulesën e saj" nuk lejon që të merret vesh ky kuptim.

Pastaj fjala “Darb” është masdar muteaddi. Për teaddin e tij nuk ka nevojë për harfu’l-xherr, por për shkak se “be” do të thotë të ngjitësh, të lutesh dhe të ndihmosh, duke u nisur nga aty është urdhëruar mbulimi i kraharorit. Ky proces nuk e pengon edhe mbulimin e kokës, e cila është detyra kryesore e shamisë. Fakti që shkronja e xherit “ala” gjendet këtu, ajo shpreh përforcim. Kështu fakti që fjala darb dhe shkronja e xherit ala përmenden bashkë e bën të detyrueshëm mbulimin e shamisë. Pastaj “Humur” është emri kryesor i shamisë. Është i vërtetë dhe jo figurativ. Sepse “Himar” dihej edhe para Islamit dhe përdorej si emri i mbulesës së kokës. Pas këtyre edhe një herë vjen urdhëri: “Të mos i tregojnë vendet e stolive”. Madje siç nuk lejohet të tregohen vendet e stolive, po ashtu është ndaluar që t’ia tregosh dikujt tjetër duke ia komentuar me fjalë. Për shkak të këtij shqetësimi nuk është parë e pranueshme që gratë jomyslimane t’i shikojnë gratë myslimane. Ndodh që ato gra, duke ua treguar burrave të tyre anët e bukura të grave myslimane, bëhen shkak për fitne. Nisur nga kjo kanë thënë: “Nganjëherë veshi dashurohet para syrit”.

Në ajetin fisnik: **“T’i ulin shikimet e tyre, ta ruajnë nderin e tyre. Le t’i mbulojnë kraharoret me mbulesat e tyre (të kokës)”** ka tre urdhra në formë të prerë njëri pas tjetrit. Me shprehjen **“Të mos i hapin dhe të mos i shfaqin vendet e stolive”** vijon ndalesa të formës së prerë. Këto janë shprehje që plotësisht shprehin detyrim. Njëri është urdhër i qartë dhe tjetri është i kuptueshëm. Domethënë se është farz zbatimi i këtyre urdhrave. Kryerja e këtyre gjërave të ndaluara me këto urdhra është haram. Kjo është feja për të cilën myslimani ka përgjegjësi. Këto nuk janë mendimet e dikujt apo gjëra që pëlqehen apo nuk pëlqehen. Myslimani i përvetëson e i pëlqen dispozitat e fesë së tij dhe përpiqet t’i zbatojë ato. Ndoshta nuk do të ketë mundësi t’i zbatojë, por ai ndjen keqardhje për dispozitat, urdhrat dhe ndalesat fetare që nuk mund t’i zbatojë. Ai e pranon mangësinë dhe gabimin e tij duke thënë “sikur ta bëja”, kërkon falje nga Allahu dhe nuk tenton që ta mbrojë mangësinë e tij, duke thënë: “Çfarë rëndësie ka nëse nuk e bëj? Domethënë, a nuk është mysliman ai që nuk e mbulon kokën e tij?” Një fjalë e tillë që nuk duhet ta thotë, i sjell atij përgjegjësi më të rënda prej shumë detyrave që nuk mund t’i bëjë. Feja dihet dhe vlerësohet si fe. Moszbatimi i dispozitave të saj falet, por ama kundërshtimi i tyre apo mohimi nuk falet. Kjo temë duhet të kuptohet qartë. Një poet thotë: “Fillimi i ngjarjeve nis me shikimin, zjarri i madh i nënvlerëson sherret.”

Për të parë dhe për të kuptuar rëndësinë dhe vlerën që kanë fe mbulesa dhe nderi si shkak i kësaj, tregohet në rrugë dhe mënyra të ndryshme se sa shumë rëndësi i ka dhënë feja asaj. Kur të hyjmë në shtëpitë e të tjerëve, urdhërohet që të kërkohej leje. Madje edhe njerëzit që janë pjesëtarë të

familjes, në kohë të caktuara kërkohej që të marrin. Vendet që burri nuk mund të shikojë te burri dhe gruaja te gruaja janë caktuar ndërmjet barkut dhe gjunjëve. Po ashtu është ndaluar që të shikohen edhe pjesët e tjera pa ndonjë arsye. Gratë janë paralajmëruar që të mos tërheqin vëmendjen e të tjerëve kur të ecin në rrugë. Pikërisht vetë të Dërguarit të Allahut i është dhënë ky urdhër: **“O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre (të kokës) përreth trupit. Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët. Me të vërtetë, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”** (33/59) Në fjalor fjala “Xhilibab” shpjegohet si mbulesë e sipërme dhe mbulesë e kokës. Ajo është një llojë rrobe që mund ta shpjegojmë si “pallto” ose “çarçaf” që vishet mbi rroba. Kjo është ajo që sugjerohet. Veçanërisht Allahu i Madhëruar thotë: **“O gratë e të Dërguarit! Ju nuk jeni si gratë e tjera. Nëse i frikësoheni Allahut, mos flisni me përkëdheli, që të mos ju dëshirojë ai që ka zemër epshore, por flisni drejt dhe në mënyrë të ndershme! Qëndroni në shtëpitë tuaja e mos i zbuloni stolitë tuaja, ashtu siç zbuloheshin në kohën e padijes! Falni namazin, jepni zekatin dhe bindjuni Allahut e të Dërguarit të Tij! O Familja e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t’ju pastrojë plotësisht. Mbani në mendje ato që lexohen në shtëpitë tuaja prej Shpalljes së Allahut dhe Urtësisë (profetike)! Me të vërtetë, Allahu është Bami-rës i pakufishëm dhe di çdo gjë.”** (24/32) Nisur nga këto tekste ka edhe prej atyre që thonë se zëri i gruas është auret. Domethënë se duhet të mbrohen deri te zërat e tyre.

Të njëjtat sugjerime u bëhen edhe grave besimtare, sepse nuk mund të mendohet se një grua që thotë se “unë jam myslimane” dhe një grua tjetër që thotë “unë nuk jam myslimane” të mbartin të njëjtën përgjegjësi fetarisht... Veçanërisht në hadithin fisnik thuhet: **“Ka dy lloje banorësh të xhehenemit. Ata nuk i shikoj akoma. Lloji i parë janë disa njerëz që i rrahin njerëzit me një shkop në dorë të ngjashëm me brirët e kaut. Ndërsa lloji i dytë janë disa gra të cilat janë të veshura por janë të zhveshura, përhapin shqetësim dhe kokat e tyre i kanë si gungat e deveve. Ato nuk hyjnë në xhenet dhe nuk e marrin erën e xhenetit, edhe pse era e xhenetit ndihet shumë larg.”** (Muslim, 2128)

Kuptimi për fenë i atyre që akoma qëndrojnë kundër mbulesës së kokës dhe tesetturit duke dalë kundër gjithë këtyre shenjave dhe argumentave, krahas të gjithë këtyre teksteve të qarta, pritet me dyshim. Nëse nuk është injorancë, atëherë është nijet i keq. Siç është në të gjithë urdhrat fetarë edhe këtu bashkëbiseduesit e kësaj dispozite janë njerëzit që besojnë. Asnjë që thotë se beson nuk imponohet dhe nuk mund të imponohet me dispozitat fetare, sepse dispozitat mbartin kuptimin e adhurimit. Adhurimi i imponuar nuk



është i pranueshëm.

Thonë se **“Zemra nuk njeh urdhër”**. Edhe besimi nuk mund të nënshtrohet me kanun. Madje besimi, i cili është përgjegjësia e parë dhe më e rëndësishme e njeriut, për shkak se është çështje e zemrës dhe e shpirtit, është diskutuar në duhet të lejohet apo të propozohet. Por fakti që shkaqet dhe mjetet të cilat janë kusht për saktësinë e propozimit duhet të jenë siguri, e bëjnë të domosdoshëm saktësinë e propozimit. Duke thënë kështu, kanë rënë në konsensus për detyrimin e besimit. Edhe veprat të cilat janë sekondaret e besimit, kanë të njëjtën dispozitë. Nisur nga kjo, përderisa nuk ka një arsye ligjore për ta zbatuar gjënë e urdhëruar, është farz që ai urdhër të zbatohet. Me argumentet e mësipërme pamë se mbulesa e kokës është farz për gruan. Ky farz nuk ka ndonjë pengesë ligjore për zbatimin e tij. Atëherë çdo grua e obliguar që thotë se unë jam myslimane, e ka farz që ta mbulojë kokën, sepse kjo është ajo që kërkon besimi. Besimi forcohet në lidhje me devocionin ndaj asaj që besohet. Besimi i cili nuk është obligues dhe i pafuqishëm në atë gradë, nuk e mbart dispozitën e besimit.

Në të vërtetë besimi është fryt i dashurisë. Njeriu që beson, e do Zotin që i beson dhe dashuria që ka ndaj Tij nuk mund të krahasohet me dashurinë që ka ndaj çdo gjëje tjetër. Njeriu mund të ketë shumë gjëra që i do dhe që mund t'i dojë,

por ato nuk mund të krahasohen me dashurinë ndaj Allahut. Kur Kurani Fisnik e tregon këtë, thotë: **“E megjithatë, disa njerëz zgjedhin (për të adhuruar) në vend të Allahut (zota) të tjerë, (duke i konsideruar) si të barabartë me Atë dhe duke i dashur siç duhet Allahu. Por ata që besojnë, e duan shumë më tepër Allahun (se sa ç'i duan idhujtarët idhujt e tyre). Sikur keqbërësit të shihnin që tani çastin kur do të përballen me ndëshkimin, do ta kuptonin se e tërë fuqia i përket Allahut dhe se dënimi i Tij është fort i ashpër.** (Sigurisht se nuk do ta bënë këtë padrejtësi të qartë. Këtu përgjigja e “Lev”it, i cili është prej lidhëzave të kushtit, është e fshehtë. Ky rregull tregon madhësinë e rrezikut.) **Ah, sikur ta shihnin çastin kur të adhuroarit do t'i braktisin adhuruesit e tyre, kur të gjithë do të shohin dënimin e midis tyre do të këputet çdo lidhje.”** (2/165-166)

Çdo ditë po shikojmë se çfarë po sakrifikon për hir të mbulesës së kokës një grua myslimane, e cila i beson Allahut dhe fesë. Këta janë dëshmitarët e fortë të fuqive që kanë në besim ato gra.

Mbulesa e kokës është një çështje religjioni dhe besimi. Ajo nuk është një çështje që mund të zgjidhet duke ushtruar dhunë. Asnjë ligj njerëzor nuk mund të kalojë para besimit. Qoftë ky ligj kombëtar apo ndërkombëtar. Nëse njerëzit të cilët përfaqësojnë gjykatën e të drejtave njerëzore do të jepnin vendime duke e ditur në të vërtetë se çdo të thotë fe e besim dhe duke e llogaritur këtë, nuk mund t'i miratonin dhe nuk mund t'i simpatizonin këto lloj ligjesh që ndërhyjnë te besimi që është e drejta e njeriut.

Njerëzit, që besojnë kanë sanksione të paimagjinueshme në këto fusha. Këto i kuptojnë vetëm ata, ndërsa armiqët e tyre nuk mund t'i kuptojnë. Allahu (xh.sh.), në Kuranin e Tij Fisnik, thotë: **“Allahu kurrë nuk do t'u japë mundësi mohuesve që të nënshtrojnë besimtarët”**. (4/11) Përsëri thotë: **“Me të vërtetë, atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu”, e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t'u zbresin ëngjëjt (para vdekjes) dhe do t'u thonë: “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar. Ne jemi mbrojtësit tuaj në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër. Atje do të keni çfarë t'ju dëshirojë zemra dhe çfarë të kërkon. Kjo është një dhuratë e pasur prej Zotit Falës dhe Mëshirëplotë.”** (40/ 30-32) Përse të shqetësohet një besimtar, i cili merr mbështetje nga një fuqi e tillë? Çfarë mund të frikësohet se do të humbë kundrejt këtij premtimi? Për këtë arsye besimtari është i fuqishëm.

Me dispozitat e Allahut nuk mund të luhet. Ata të cilët futen në diskutime të pabaza dhe të padrejta, një ditë, madje shumë afër, do t'i shikojnë ato që kanë humbur. Ata do të poshtërohen në këtë botë dhe në ahiret do të ndëshkohen. Feja nuk mund të mposhtet kurrë.

Koha, një pasuri që duhet ta shfrytëzojmë me dobi

Prof. dr. Njazi Kazazi
Naim Drijaj

*B*esoj se jemi në një mendje që në ditët tona, ngado që të hedhësh sytë, shikon njerëz të moshave, profesioneve dhe shtresave të ndryshme shoqërore që kalojnë a vrasin kohën e lirë kot, pa asnjë qëllim dhe që nuk e shfrytëzojnë me dobi këtë dhuratë të çmueshme të Zotit (xh.sh.). Pikërisht ky është argumenti që po përpiqemi të trajtojmë sot, sigurisht pa pretenduar për ta shtruar këtë problem kaq të gjerë dhe kompleks, për të cilin është shqetësuar shoqëria njerëzore që me lindjen e saj.

Në psikologjinë e popujve të ndryshëm vlera e kohës është dhënë edhe nëpërmjet proverbave, si: për ne shqiptarët “Koha është flori”; për anglezët “Koha është para” (The time is money); për italianët “Koha është (përsëri) para” (Il tempo é denaro); ndërsa për arabët “Koha është si shpata, po s’e preve, të pret...” etj.

Mbi të gjitha koha ka një vlerësim të jashtëzakonshëm në Librin e Allahut, në Kuranin famëlartë. Për të treguar vlerën e kohës Allahu (xh.sh.), është betuar në të, në fillimin e disa sureve të Kuranit, si: Në suren Lejl ajeti 1-2

“Pasha Natën që me errësirën mbulon gjithësinë, pasha ditën kur ajo shkrepetin (agon).”

Surja Fexher, ajeti i parë, fillon me fjalët: “Pasha agimin!”.

Surja Duha, ajeti i parë, fillon me fjalët: “Pasha paraditen...”.

Surja Asr, ajeti i parë, fillon me fjalët: “Pasha Kohën!”

Fahrudin Er-Razi, në tefsirin e tij thotë: “Allahu (xh.sh.), është betuar në kohën, sepse ajo përmbledh të gjitha aspektet që janë pjesë e jetës njerëzore. Në të ka gëzimet, hidhërimet, shëndetin, sëmundjen, pasurinë, varfërinë, etj”.

Duke shfletuar dy tregues të Kuranit, hartuar nga E.Presheva dhe H.Shehu, del se në rreth 28 versete preket dhe trajtohet problemi i kohës, raporti që duhet të krijohet me të, si ta shfrytëzojmë, si ta bëjmë atë të dobishme për veten, familjen e shoqërinë. Kështu, ndonëse njerëzit betohen dhe duhet të betohen vetëm në Zotin (xh.sh.), Allahu betohet, ndërmjet të tjerave, “Për Kohën”. Le të meditojmë pak çaste se çfarë vlere e jashtëzakonshme i jepet asaj. Allahu betohet në krijesat e tij për të na tërhequr vërejtjen, për të na kujtuar, për të na treguar vlerat dhe rëndësinë e asaj në të cilën Ai është betuar.

Edhe thëniet profetike theksojnë një gjë të tillë. Nga katër pyetjet që do t’i drejtohen njeriut, dy prej tyre kanë të bëjnë me kohën. “Nuk do të lëvizë këmba e njeriut ditën e gjykimit, pa u pyetur për katër gjëra: “Jetën e tij ku e ka çuar? Rininë e tij ku e ka shfrytëzuar? Pasurinë e tij ku e ka fituar dhe ku e ka shpenzuar? Me diturinë e tij çfarë ka



punuar?” (Taberani)

Transmetohet nga Buhariu se Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Dy prej begative apo nimeteve të Zotit (xh.sh.), shumica e njerëzve nuk ua dinë vlerën, shëndetit dhe kohës së lirë.”

Në një hadith tjetër thuhet: *“Shfrytëzo pesë gjëra para pesë të tjerave: rininë para pleqërisë, shëndetin para se të bëhesh i sëmurë (para sëmundjes), jetën para vdekjes, pasurinë para varfërisë dhe kohën e lirë para se të zihesh me punë”.*

Meqë parashtrimi ynë u drejtohet më tepër të rinjve që janë e ardhmja e shoqërisë sonë, nga ky këndvështrim po përpiqemi të japim disa ide dhe konsiderata se si mund të shfrytëzohet ajo në mënyrë të dobishme, me përfitim, mbi të gjitha për fitimin e njohurive, të dijeve në fusha të ndryshme të shkencës, për t’iu përgjigjur kohës në të cilën jetojmë, por edhe për t’u përgatitur në përballimin e sfidave të së ardhmes, gjë e cila nuk mund të arrihet pa kulturë të gjerë, pa përgatitje fetare dhe shkencore, pa punë e mundim. E të gjitha këto mund të realizohen, në qoftë se punojmë shumë në rini, shfrytëzojmë kohën në mënyrë racionale, pa lënë asnjë minutë të na shkojë kot, duke pasur parasysh:

Së pari: Për të arritur në mënyrë të kënaqshme realizimin e një gjëje të tillë duhet të kuptohet thellë në shpirt e në ndërgjegje vlera e kohës. Të gjitha këto që cituam deri tani nga Kurani e Hadithet Profetike, na bindin për rëndësinë që duhet t’i japim asaj, por do të mjaftonte vetëm betimi i Allahut (xh.sh.), në ajetin “Pasha kohën”, për të na bindur për këtë. Por meqë Islami, veç të tjerave, është

mënyrë jetese, kështu natyrshëm rrjedhin detyrat për çdo njeri, i çfarëdo moshe, formimi, profesioni, që ta zbatojë atë në jetën e përditshme, të mendojë dhe të gjejë rrugë e forma për të përfituar sa më shumë prej saj, që të mos pendohet një ditë kur të jetë vonë.

Ibnul-Kajim el Xhevzi ka thënë: “Humbja e kohës është më e madhe se vdekja. Sepse humbja e kohës e largon njeriun nga Allahu (xh.sh.) dhe nga bota tjetër, ndërsa vdekja e largon vetëm nga kjo botë”.

Së dyti: Kurrë nuk duhet të harrojmë se koha ikën shpejt. Thuhet se, kur Hz. Nuhut (a.s.), i erdhi meleku i vdekjes dhe i tha: “O pejgamberi me jetën më të gjatë, si e gje-te botën?” Ai iu përgjigj: “Si një shtëpi që kishte dy dyer, hyra tek njëra dhe dola nga tjetra”. Besoj se ideja e mesazhi i saj janë të qarta dhe s’kanë nevojë për koment.

Të njëjtën gjë tregon Kurani, kur përshkruan momentin e shkatërrimit të botës në suren Nazi’at, në ajetin 46: **“Ditën kur ta përjetojnë atë (kijametin), atyre do t’u duket sikur nuk kanë jetuar më tepër se një mbrëmje ose një mëngjes të saj”.**

Së treti: Të kemi gjithnjë parasysh se koha ikën dhe nuk kthehet më, çdo çast që kalon nuk përsëritet. Transmetohet se një dijetar i njohur, Hasan El-Basriu ka thënë: “Çdo ditë e re që lind thërret: “O biri i Ademit (o njeri), unë jam një krijesë (ditë) e re dhe për veprat tuaja jam dëshmitare, më shfrytëzo mua, sepse unë, nëse iki, s’kthehem më deri në ditën e gjykimit”. Koha është quajtur me të drejtë njëra prej tri gjërave, që ikën e s’kthehet më. Atëherë ta përdorim sa më mirë, ta shfrytëzojmë sa më tepër këtë dhuratë, sepse do të ikë dhe s’do ta gjejmë më.

Muhasibiu, Zoti e mëshiroftë, ka thënë: “Po të ishte e mundur që koha të ishte mall tregëtie dhe të blihej, tërë pasurinë do ta kisha shpenzuar për të blerë kohë të lirë.” Kur e kanë pyetur: “Prej kujt do ta kishe blerë atë kohë të lirë?” Është përgjigjur: “Prej neglizhentëve!”


Së katërti: Ta menaxhojmë kohën dhe jo ta lëmë atë të na marrë përpara. Menaxhimi i vetvetes dhe kohës është i lidhur me disa faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, ka anët e veta teknike dhe ato psiko- sociale. Në kohën që kalojmë, vështirësitë dhe problemet që ndeshim çdo ditë shpesh na largojnë nga një mundësi e tillë, por këtu qëndron edhe kyçi i suksesit, në vështirësi provohet i formuari, ai që ka edukatë punën, i devotshmi, ai që ka një qëllim fisnik në jetë. Rutina e përditshme e punës dhe e mësimin nuk duhet të na marrë përpara, por të përpiqemi ta drejtojmë ne atë. Kjo mund të realizohet shumë mirë

duke ndërtuar plane pune, me afate të shkurtra dhe perspektive.

Në planifikimin e kohës rekomandohet të ndiqen këto rregulla: Planifikohet vetëm një pjesë e kohës. Sipas përvojës rreth 60% mbetet kohë për gjëra të paparashikuara. Të punohet rregullisht dhe sistematikisht me plane kohore (ato mund të jenë javore, mujore dhe vjetore). Për një student, në pamjen e jashtme duket se nuk ka se çfarë të planifikojë, mbasi orari i leksioneve dhe seminareve hartohet nga të tjerët dhe atij i mbetet vetëm ta zbatojë. Por nuk është pikë për pikë kështu, mbasi gjatë javës krijohen boshllëqe, orë të lira, ngarkesa nga njëra javë në tjetrën ndryshon, pra duhet një planifikim dhe parashkrim. Provojeni dhe do të ndiheni shumë shpejt mirë. Në diskutim me miq dhe kolegë shpesh disa shprehin mendimin se planifikimi i gjërave, mbajtja e një “axhende”, siç quhet sot në botë, sikur i shtrëngon, i mban peng i planifikimit, kështu që nuk e pëlqejnë dhe nuk e përdorin, por nga psikologët-didaktë këshillohet që të mos neglizhohet “princiipi i të shkruarit”, sepse, sipas tyre, çdo gjë e shkruar nuk harrohet, të tjerat mbase po. Bëjeni provë disa kohë, pastaj zbatoni atë që ju duket më e dobishme. Besoj se me planifikim do të dilni të fituar.

Një rezervë tepër e rëndësishme ku mund të fitojmë “kohë për vete”, kështu quhet koha e lirë dhe hapësirat që mund t’i krijojmë vetes gjatë një pune, është ndërtimi i një raporti të drejtë ndërmjet librit (leximit) dhe ekranit të vogël të televizorit. Nga një anketim për qëllime të tjera mësimore që kemi bërë kohë më parë me një grup studentësh, doli se mesatarja e orëve që kalonin para ekranit të vogël ishte rreth 3, 5, 4 orë në ditë. Është një problem botëror që media elektronike “ka mbytur” në një farë mase leximin, për shumë arsye që dihen, por mendojmë se, sikur një orë nga këto t’i kushtohet leximit, në fund të një muaji do të bëheshin 750 faqe, pra mesatarisht 3 libra të lexuar, në vit 36 dhe gjatë tetë viteve të shkollës së mesme dhe të lartë rreth 360 libra, që nuk janë pak.

Një nga rrugët e rëndësishme për të fituar kohën është edhe sigurimi i bashkëpunimit, ofrimi dhe pranimi i tij. Përveç vlerave të gjithanshme shkencore, intelektuale, qytetare, njerëzore dhe shpirtërore që sjell bashkëpunimi ndërmjet njerëzve, ai mbi të gjitha është edhe përfitimi i madh në kohë. Kemi mjaft shembuj në jetë që njerëz të cilët kanë bashkëpunuar, kanë dhënë vepra me vlerë dhe se bashkëpunimi u ka siguruar sukses dhe krijimtari të begatë. E për rrjedhim shembulli i tyre duhet ndjekur...Bie fjala, kur më ftuan për të përgatitur këtë shkrim të shkurter (mbi bazën e një kumtese për këtë problem, mbajtur



më parë) m’u desh t’i rikthehem kësaj ideje. Lexova dhe rilexova disa herë shumë ajete të Kuranit, shfletova dhe konsultova disa libra, diskutova dhe rraha mendime me miq dhe teologë që më ndihmuan për ta përgatitur, shkrova disa ide që i kisha prej kohësh në mendje dhe pa këtë shtysë nuk do t’i kisha hedhur në letër, e për rrjedhim, i fituar dola unë.

Hasan El Basriu ka thënë: “Jeta e njeriut përmbledhet në tre ditë: E djeshmja, që ka kaluar, e nesërmja; e ndoshta atë ditë nuk mund ta arrish, dhe e sotmja; është dita jote, prandaj shfrytëzoje mirë atë.”

Një poet arab ka thënë: “Koha është gjëja më e shtrenjtë që duhet ruajtur, ndërsa është gjëja më e lehtë që mund të humbësh.”

Në këtë pikëpamje ne deshëm të ritheksojmë se të gjithë kemi nevojë të mendojmë dhe të përpiqemi në çdo rast të menaxhojmë kohën që kemi. Në përfundim po i rikthehem edhe një herë Ajetit që fillon me fjalët “Pasha kohën” që është shumë e çmueshme për njeriun, nëse e shfrytëzon atë si duhet. Është këshilluesi më i mirë që të jep mësim sesi i dobëti me angazhimin e tij në punë, në dituri, arriti të bëhet më i forti dhe më i larti: ndërsa ai që ishte i fortë e i lartë, me përtacinë e tij u bë më i dobëti. Koha është plot e përplot me ngjarje të çuditshme; njerëz të mëdhenj e humbin vlerën, njerëz të panjohur arrijnë famë, pasanikët varfërohen, të varfërit pasurohen e kështu me radhë në të gjitha fushat e jetës, andaj duhet të marrim mësim, të nderuar vëllezër e motra, që të mos humbasim, por të jemi gjithnjë në përparim, ashtu siç është i përparuar Islami.



Shpresë

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Një nga kushtet e shëndetit është fakti që besimi është “Bejne’l-havf ve’r-rea”, pra besimi ndodhet mes frikës dhe shpresës. Një besim i sigurtë, siç nuk e lë asnjëherë individin të pashpresë nga mëshira e Allahut, nuk i jep siguri as edhe për dënimin e Tij. Një besim i tillë i jep individit një motivim serioz për të gjetur një rrugëdalje në momente dhe kohë të vështira.

Mendimtarët e mëdhenj janë ushqyesit e shpresës për njerëzit. Njëri prej tyre është edhe Mevlana, i cili u dha shpresë njerëzve, sepse koha në të cilën jetoi, ishte e tillë, ku myslimanët qenë zhytur në skepticizëm. Ai nuk e toleronte kurrë skepticizmin, pasi, sipas tij, është shpresa ajo që i jep ndjesinë e shpëtimit njeriut dhe besimi që e vë në lëvizje këtë shpresë.¹ Allahu thotë në Kuran: “**Vetëm mohuesit janë të pashpresë**”.² Ky ajet tregon se Jakupi nuk e humbi shpresën për të gjetur Jusufin.

Shpresa e lartë e Mevlanës u jepte shpresë njerëzve edhe në kohët më të vështira. Ai thoshte:

Mos ano nga skepticizmi, pasi ekzistojnë dyert e shpresës.

Mos shko në zonën e errësirave, pasi dielli ndriçon.³

Sipas vizionit të tij, pesimizmi është një shfaqje e qartë e paafësive të atyre që kanë natyrë dhunuëse, sikurse lakuriqi i natës, i cili s’mund të shohë diellin.⁴ Pesimizmi, është si një kosë që copëzon jetën e njeriut duke i prerë rrënjët.⁵ Prandaj ai i këshillonte njerëzit në nevojë t’i luteshin Allahut duke u thënë:

Ki kujdes dhe mos u bëj skeptik, mbaje veten në formë.

Kush t’i jep përgjigje vuajtjes sate thirre për ndihmë.⁶

Shpresa e të dashuruarit është ta shohë të dashurën e vet. Ja si e shpreh Mevlana në Divanin e tij një dashuri të tillë që mbart këtë ndjesi: “E dashura ime, po pres tek dera me shpresën se do kesh pak mëshirë të hapësh dhe të më thuash: “Ç’pret aty, futu brenda”.⁷

Nëse lëviz damari i dorës, kjo lloj lëvizjeje është një shpresë takimi. Pasi me mijëra duar të prera kanë çuar në ritakime të lumtura.⁸

Çdo gjë e gjithësisë vijon rrugën e vet drejt Krijuesit me shpresë dhe e emocionuar për një arritje të tillë. Vërshton si ujrat që përplasen sa në një gur në tjetrin. Natyrisht, një shpresë e tillë, i jep kuptim jetës dhe shton gjallërinë në gjithësi. Si mund të jetë në lëvizje çdokush dhe çdo gjë, po të mos ishte një shpresë e tillë?

Njerëzit që vuajnë nga ndarjet dhe u djeg shpirti janë përherë në kërkim. Shpresa për të arritur atë që do, e bën më të kuptimtë kërkimin për atë që është në këtë rrugë. Allahu na i ka krijuar organet që të jenë në lëvizje. Lëvizja shpreh një gjallëri. Kush e kupton që në këtë lëvizje ka begati nuk bëhet pre e dembelizmit.

Njeriu e ka të vështirë të shpëtojë me përpjekje dhe sakrifica. Madje edhe mërzitet. Por bota është një pus pa fund. Rrugat e vetme për të shpëtuar nga ky pus i pafundëm është shpresa dhe përpjekja. Ose do preferosh të qëndrosh në botën e errësirës ose do përpiqesh të ngjitesh sipër me

shpresën për të shpëtuar nga ai pus.

Një zog i mbyllur në kafaz, sipas Mevlanës, në çdo çast dëshiron të dalë e të fluturojë. Për këtë edhe rrah krahët, por nuk e lë trupin e tij me shpresën se do bjerë në sy të Krijuesit.⁹

Ademi, me zbritjen e tij në tokë nga xheneti, humbi çdo gjë, por shpresën kurrë. Edhe qante edhe ishte në pritje. Ai thoshte përherë: “Mos e humbni shpresën prej Allahut, i cili është dhurues i madh!”¹⁰ Mevlana shpresonte se biri i Ademit do kthehej sërish atje.

Ndryshon pamja e pemëve që mbyllen në shpresën për t’u takuar me pranverën, gjelbërohen dhe marrin shtat. Nëse gjendja e bimëve, që jetojnë me shpresën për të ardhur pranvera, është e tillë, po ajo e frymorëve si do të jetë? Njeriut nuk i shkon pesimizmi, pasi shpresa nuk humbet nga fuqia e Allahut. Ja si shprehet Shinasi në lutjen e tij:

*Sado fajtor të jem, shpresën s’e humb,
Prej madhësisë së Tij, ku Ai është det i pafund.*

Nëse shpresa pranverore sjell lot në sytë e njerëzve, sikurse shirat e prillit, në kopshtin e pendimit çelin bimët e freskëta aromatike. Në shpirt hedhin rrënjë trëndafilat e dashurisë, përvëlimi i mallit kthehet në shpresën e arritjes dhe ndjenja për t’i kaluar vështirësitë, për t’u bërë ballë atyre del fitimtare tek njeriu.

Njeriu në këtë botë ka mbetur i etur me shpresën se do gjejë burimin e eliksirit të jetës. Ka një dashamirës të madh që e rrethon njeriun si një det i pakufijshëm nga para, pas, majtas, djathtas duke i dhënë atij dhunti të panumërta, por është e dhimbshme kur njeriu mbetet i painformuar dhe i pashpresë para këtij deti dhuntish. Në fakt, shpirti i të dashuruarit kurrë nuk bie në pesimizëm. Edhe sikur vuajtjet ta lidhin për duarsh, edhe sikur ndarja t’ia plagosë shpresën, ai përsëri nuk mbetet i pashpresë.

Mevlana shprehet se, ashtu siç kërkohet ndihmë për të hapur derën e mbyllur, ashtu kërkohet edhe përpjekje dhe sakrificë për vijimësinë e jetës dhe ata që përpiqen do fitojnë shpresën e kërkuar.¹¹

Është shpresa ajo që e thërret njeriun në çdo lloj arti dhe suksesi. Edhe sikur njerëzit të dërrmohen nga përpjekjet e tyre në punë, përsëri me shpresë ia arrijnë qëllimeve përkatëse. Por shpresa duhet t’i shpëtojë dembelizmit dhe të piqet me zjarrin e mundimit. Përpjekja dhe mundimi janë të rëndësishme. Edhe kalorësi i mullirit është përherë në lëvizje. Por kjo lëvizje dhe përpjekje e tij bëhet vetëm për të shpëtuar kërbaçin që mbart mbi supe. Lëvizja dhe përpjekja e bërë për të shpëtuar kërbaçin natyrisht që nuk është e njëjtë me lëvizjen dhe përpjekjen e bërë për një qëllim të caktuar. Përpjekja dhe mundimi kanë kuptim kur bëhen

me qëllime të sinqerta.

Mevlana u jepte këto këshilla të dashuruarve ndaj Zotit, që ata të mos ishin pesimistë dhe të mos e linin pas dore mundimin dhe përpjekjen: “O i dashuruari i Zotit! Bëje detyrën që të takon. Mos u bëj skeptik, pse nuk u çel syri i zemrës, pse nuk arrite të shpëtosh nga halli i mirëqenies dhe gjërave të përbotshme. Pasi i gjithmëshirshmi Allah në një kohë të paimagjinueshme vjen dhe të merr gjithçka ke në dorë dhe shpëton.”¹²

Ai ka një mëshirë aq të madhe sa edhe robërit që i kalojnë kufijtë në gjynahet e bëra i kujton duke u thënë “Robërit e mi”¹³ dhe kërkon prej tyre të mos i humbasin shpresat se ai do u falë të gjitha gjynahet. Një rrugë të tillë Mevlana e tregon me këtë shprehje: “O robi i Zotit, ngrihu me shpresën se do e gjesh rrugën që të çon drejt qiejve. Qëndro në këmbë para mihrahit sikurse qiriu, adhuro! Qaj gjithë natën si qiriu kokëprerë, derdh lot, digju! Lidhe shpresën tënde me Zotin në çdo çast! Mundohu të ngrihesh deri atje! Nga qielli do bien reshje shiu shpirtërore. Dashuria hyjnore do vijë e vrullshme dhe do e mbushë zemrën. Ti mos u bëj skeptik duke menduar se je i pafuqishëm! Kërko me ngulm atë që do! Allahu do që edhe ata që kanë humbur shpresat prej mëshirës, të mos ia kthejnë shpinën robërisë, në mënyrë që edhe ata të arrijnë robërinë tek Zoti dhe nëpërmjet saj të arrijnë edhe shpresën. Mëshira e Allahut përfshin çdokënd dhe çdo gjë. Allahu do që çdo zotëri dhe shërbëtor të jetë mes frikës dhe shpresës.”¹⁴

Sipas Mevlanës, humbja më e madhe është ndarja, të kthyerit në të huaj për veten. Prandaj është e pëlqyeshme edhe të vdesësh me shpresën për të arritur tek Ai. Dhimbja e ndarjes nga Allahu është më përvëluese se vetë zjarri. Kush është mbështetur nga shpresa për të mbërritur tek Ai, asnjëherë nuk është frikësuar nga ajo përpjekje. Shpresa është një e ftuar nderi që s’flet, e pa zë dhe e pafjalë që thotë “Eja!” Kjo e ftuar nderi, e ftuar nga besimi, fshin të gjitha dhimbjet e shpirtit dhe pastron çdo gjë.

Thëniet e Mevlanës për shpresën, ashtu siç kanë forcën për ta ngritur në këmbë njeriun e pashpresë, symbyllur dhe të përgjëruar, ashtu kanë forcën edhe për t’i dhënë një motivim më shumë dhe për të ngritur në këmbë një popull të tërë.

Referencat: 1) Mesnevi, II, b. 304. 2) Yüsuf, 12/87. 3) Mesnevi, I, b. 725. 4) Mesnevi, I, b. 3647. 5) Mesnevi, I, b. 2296 vd. 6) Mesnevi, I, b. 3251. 7) Përzgjedhje nga Divan-ı Kebir, I, 19. 8) Përzgjedhje nga Divan-ı Kebir, I, 82. 9) Përzgjedhje nga Divan-ı Kebir, I, 377. 10) ez-Zümer, 39/53. 11) Përzgjedhje nga Divan-ı Kebir Rubailer, IV, 52, no: 184. 12) Përkthimi Mesnevi, I, 46. 13) ez-Zümer, 39/53. 14) Mesnevi, V, b. 1728-31.



MENDJA dhe Udhëzimi

Doc. dr. Sulejman Derin

Ska dyshim se një ndër mirësitë më të mëdha që i është dhënë njeriut është mendja. Rigjallërimi i fesë dhe zhvillimi i botës është i lidhur me nivelin e përsosjes mendore. Megjithatë këtë shumë liderë mistikë, si Imam Rabbani, Mevlana dhe plot të tjerë, e kanë quajtur të natyrshme kritikën ndaj mendjes, e cila nuk ka kaluar në disiplinën hyjnore. Çdo mirësi që Allahu ia ka dhuruar njeriut, siç përdoret për mirë, mund të përdoret edhe për keq. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për mendjen, e cila mund të përdoret edhe për ta njohur Allahun edhe për ta mohuar Atë. Edhe tani ka plot njerëz që çdo çështje aktuale mundohen ta zgjidhin vetëm me mendjen e tyre, bile ka prej atyre që edhe për çështjet fetare thurin fjalë me fjalët “sipas meje” dhe me këtë mundohen t’i zgjidhin ato sipas këndvështrimit të tyre, duke u bazuar vetëm tek mendja. Ka edhe prej atyre që, duke i anashkaluar profetët, mundohen t’i quajnë mendjet e tyre **“profetë të kohës moderne”**. Hz. Imam Rabbani, ndërkohë që analizonte marrëdhëniet ndërmjet çështjeve fetare me mendjen, doli në konkluzion se mendja që është larg vahjit (zbulesës hyjnore), është e paaftë dhe e mangët dhe se dërgimi i profetëve, për ne është mirësia më e madhe hyjnore. Ja si e ka përmbledhur ai këtë fakt:

“Mirësia më e madhe, e cila u është dhuruar njerëzve nga Allahu i Madhëruar është dërgimi i Profetit. Cila gjuhë mund ta bëjë falënderimin e kësaj mirësie? Cila zemër mund ta përjetojë mirësinë e të dërguarit të tyre? Cili organ mund t’i perceptojë të gjitha këto mirësi? Po të mos ishin ata njerëz të nderuar, kush do të na e mësonte neve, njerëzve të thjeshtë, ekzistencën e Krijuesit të kësaj bote?” (Letra 259.)

Hz. Imam Rabbani na jep një shembull të Filozofëve të Greqisë antike për të na treguar se vetëm me mendje është i pamjaftueshëm udhëzimi. Filozofët e Greqisë antike, përsa i përket zgjuarsisë, padyshim ishin gjeni, mirëpo me mendjet e tyre, jo vetëm që nuk e konceptonin ekzistencën e Krijuesit, por as që kuptonin domosdoshmërinë e ekzistencës së Allahut. Kishte filozofë të mëvonshëm që e pranuan ekzistencën e Allahut. Kjo gjë ndodhi në sajë të njohurive të vahjit (zbulesës hyjnore) që ishte sjellë nga profetët:

“Filozofët e Greqisë antike, nuk e kuptuan dot ekzistencën e Krijuesit. Ata pretenduan se kozmosi është krijuar nga natyra. Pas kohës së injorancës, kur bota u ndriçua me dritën (nurin) e Profetëve, filozofët grekë mesjetarë, të ndikuar prej dritës së njohurive të marra nga Profetët, i refuzuan idetë e filozofëve antikë dhe në librat e tyre argumentuan ekzistencën e Krijuesit të gjithësisë. Prandaj mendjet tona do të ishin larg konceptimit të këtyre temave madhore pa ushqimin e dritës së profetësisë.” (Letra 259)

Imam Rabbani kritikon edhe dijetarët maturidi, të cilët mbrojnë idenë se ekzistenca dhe njësimi i Krijuesit mund të arrihet vetëm me anë të mendjes. Sipas medhhebit Maturidi, njeriu, edhe nëse jeton i vetmuar në pyll pa i ardhur asnjë shpallje e qartë, duhet të përdorë mendjen e tij për të njohur ekzistencën dhe njësimin e Allahut (xh.sh.), në të kundërt, ai do të ndëshkohet me xhehenem përjetësisht. Imam Rabbani, duke menduar ndryshe, mbron pikëpamjen se nuk do të ndëshkohet me xhehenem përjetësisht personi të cilit nuk i ka mbërritur mesazhi i shpalljes. Sado që mendja e njeriut është e krijuar për të njohur Allahun, përsëri vetëm me

mendje është e vështirë ta njohë Atë, prandaj për t'u udhëzuar është kategorikisht e nevojshme shpallja hyjnore. Sipas këndvështrimit të Imam Rabbaniut, personave mohues të cilëve nuk u ka ardhur shpallje nga Allahu, ashtu sikurse edhe krijesat e tjera, pasi të ringjallen dhe të japin llogari, më pas do të asgjësohen. I njëjti gjykim vlen edhe për mushrikët dhe fëmijët e tyre, të cilëve nuk u ka ardhur argumenti i qartë për njohjen e Allahut. Pra gjykimi është i njëjtë, për këto kategori personash nuk do të ketë as ndëshkim dhe as shpërbim të përhershëm. Megjithatë, sipas tij, numri i vendeve që nuk u është dërguar profet është jashtëzakonisht i vogël. Në një letër, dërguar birit të tij, ai thekson:

“Biri im! Edhe pse jam një krijesë e dobët, kam medituuar thellë dhe dola në përfundimin që nuk ka vend në sipërfaqe të tokës, ku të mos ketë arritur udhëzimi i Profetit Muhammed (a.s.). Sepse duket qartë drita (nuri) e thirrjes së tij që ka ndriçuar botën ashtu siç e ndriçon dielli, saqë, jo vetëm neve, por edhe Jexhuxh-Mexhuxhëve që ndodhen jashtë botës sonë, u ka arritur shpallja e tij.” (Letra 259.)

Ekziston një ide e gabuar tek shumë njerëz që pretendojnë se në Indi dhe përreth saj nuk është dërguar asnjë profet. Imam Rabbani e kundërshton plotësisht këtë ide të gabuar dhe mendon se në atë zonë janë dërguar shumë profetë, duke theksuar se: “Gjendem në një vend në të cilin janë dërguar profetë që kanë bërë thirrje për të njohur Allahun e Madhëruar, edhe pse është një vend i largët. Ka vende në Indi, ku duken dritat e profetëve që ngjasojnë si pishtarë në errësirë e shirkut (mosbesimit). Mund t'i përmend edhe emrat e këtyre vendeve, nëse dëshiron. Ka profetë që s'kanë pasur asnjë pasues, ka prej atyre që u ka besuar vetëm një person, disave ua kanë pranuar ftesën dhe u kanë besuar dy-tre vetë. Nuk mund të gjesht profet në Indi dhe përreth që t'i kenë besuar më shumë se tre persona.” (Letra 259.)

Sipas këndvështrimit të Imam Rabbaniut, njohuritë që gjenden në librat e shenjtë të Indianëve, janë marrë nga shpalljet hyjnore të përcjella nga profetët: “Ska dyshim se për çdo pupull është dërguar nga një profet që i ka informuar njerëzit në lidhje me domosdoshmërinë e ekzistencës së Allahut, me cilësitë dhe atributet e Tij, me pangjashmërinë e asnjë krijese tjetër me Atë dhe me madhështinë e Tij. Po të mos kishin ardhur këta njerëz të zgjedhur, si mund të ishte arritur kjo mirësi me mendje plot mangësi dhe thatësi, të mbushura me kundërshti dhe prapësi?”

Sipas Imam Rabbaniut, personat që nuk pranojnë profetët dhe shpalljen hyjnore, mbartin në qeniet e tyre prirje hyjneti:

“Këta njerëz mediokër me mendjet e tyre të mykura, duke refuzuar profetët, nuk bëjnë gjë tjetër vetëm se shpallin veten e tyre zot. Këta nuk pranojnë zot tjetër përveç vetes së tyre. Këtë gjë e pati shprehur edhe Faraoni: “O pari! Unë nuk di

që për ju ka tjetër zot përveç meje!” (el-Kasas, 38). Në një vend tjetër: “Nëse ti merr për zot tjetërkënd përveç meje, me siguri do të të fus në burg!” (esh-Shu'ara, 29)

Sipas Imam Rabbaniut, mendja është si thika me dy tehe. Nganjëherë ndodh që dëshiron të bëhet pjesë në hyjnitetin e Allahut, në vend që ta kërkojë dhe pranojë Atë. Duke përfutuar nga besimi në një Zot, që është shumë i përhapur, “të hyjnizuarit” supozuan se fryma e Zotit ka hyrë brenda tyre.

“Kur mësuan nga profetët për domosdoshmërinë e ekzistencës së një Krijuesi, pati nga ata që supozuan ide të gabuara në mendjet e tyre. Ata pranuan ekzistencën e Krijuesit, pastaj pretenduan se fryma e Tij është futur brenda tyre dhe është bashkuar duke u bërë një e vetme me ta. Me këtë mashtrim u bënë thirrje njerëzve që të adhuroheshin. Ndërsa Allahu është sublim nga këto pretendime të mizorëve.”

Veçanërisht në disa shkolla mistike heretike indiane, gjenden besime të tilla dhe misticizmi i vërtetë duhet të jetë i kujdesshëm ndaj këtyre lloj qasjesh.

H.z. Mevlana, filozofit materialist, që i beson vetëm mendjes së tij duke lënë mënjanë Kuranin dhe udhëzimin e profetëve, u përgjigjet me këto vargje në formë esenciale:

Një person, i cili po lexonte nga Kurani ajetin: “**Nëse uji ju shterron, kush do t'jua sjellë atë?**”

Allahu i Madhëruar urdhëron dhe thotë: “**Unë e pres ujin, e shterroj burimin dhe e kthej atë në vend të thatë dhe të shkretë.**”

*Kush tjetër veç Meje me virtyt dhe aftësi
Mund të sjellë në burim një ujë të ri?*

*Një filozof i thatë dhe i pavlerë
Po kalonte pranë shkollës, atëherë...*

*Ngaqë nuk e pëlqeu ajetin kur e dëgjoi,
Tha: “E sjellim ne pasi me kazma ta gërmojmë...”*

*E çajmë me bel, me kazmë e gërmojmë
Dhe ujin nga poshtë-lart arrijmë ta çojmë...”*

*Në darkë ra në gjumë. Në ëndërr pa një trim të prapë
Që i ra një grusht dhe ia qorroi të dy sytë që kish në ballë...*

*I tha: “O rob pa tru! Në qofsh i sigurtë në atë që the,
Nxirr dritë me kazëm nga burimi yt i syve...”*

*Në mëngjes filozofi fluturoi nga shtrati
Dhe kuptoi se shikimi i kish ikur të ngratit...*

*Po qe se do të pendohej duke vajtuar,
Bujaria e Zotit, dritën do ia kish lëshuar.*

(Mesnevi, v. II, 1633-42.)



BARRA e intolerancës

Redi Shehu

Sado që gjatë leximit të përditshëm të shtypit tonë mendo-hem, si një qytetar i mirë, të jem i distancuar dhe i emancipuar nga ndjenja e paragjykitimit dhe mllëfit, praseprapë, eksponentë të izoluar ishullorë, bëjnë të pamundurën për t'i aktivizuar këto ndjenja, jo vetëm në ndërgjegjen individuale, por edhe në atë kolektive.

Që t'i biem shkurt, e kam fjalën për një shkrim të Andis Gjonit në gazetën "Panorama", i cili duke përfutur nga liria e shtypit, që jo rrallë shtyp edhe vetë njerëzit, solli një duhmë mesjetare inkuizicioniste plot kundërmim, duke sulmuar baza fetare dhe baza të një shteti të së drejtës, i cili përfaqësohet nga liritë dhe të drejtat e individit.

Ka dy alternativa. Të përgënjeshtroj gabimet e shkrimit të z. Gjoni, të cilat gjenden pothuaj në çdo gërmë, apo të vazhdoj të jem një qytetar i çliruar nga ndjenja e mllëfit, duke përqafuar argumentin si rrugëzgjidhje. Sigurisht që do të zgjedh të dytën edhe për faktin e mosrënies në kënetën e injorancës së disa pesëthundrakëve që, edhe pse vegjetojnë në një shoqëri me parametra të larta demokracie, nuk kanë arritur akoma të ngrihen.

Në fokus të këtij shkrimi ishte debati mbi të drejtën e grave dhe vajzave myslimane për të frekuentuar qendrat tona të edukimit, debat i cili kohët e fundit u riaktivizua si pasojë e përjashtimeve të radhës nga shkolla të myslimaneve si dhe prononcimeve negative të Ministrit të Arsimit dhe prononcimeve pozitive të Kryeministrit.

Në fakt vetë ekzistenca e këtij debati në njëfarë mënyre demonstroi dukshëm nivelin konceptual që kemi në mbi demokracinë dhe shoqërinë e lirë. Është pothuaj e pabesueshme që në vitin 2009 të diskutohet privimi i së drejtës së arsimimit të një qenieje njerëzore në kohën kur vëmendja dhe dashuria janë ndaj kafshëve ka arritur kulmin. Vetë mënyra e këtij debati të jep përshtypjen se vërtet po flasim për njerëz apo për kafshë. Është pikërisht ky mentalitet i trajtimit të besimtarëve si dythundrakë apo majmunë nga ana e Andis Gjonit në shkrimin e tij, që për fatin tonë të keq, shënoi edhe rekordin mediatik të radhës.

Nuk ka shpjegim tjetër, se ndryshe askush nuk do të guxonte të mendonte se si pasues të besimeve të mund të kufizohen nga e drejta bazë, mbi të gjitha njerëzore e pastaj ajo kushtetuese.

Ka nga ata që akoma nuk e kanë kuptuar lirinë e fjalës dhe lirinë e të qenit i lirë nga ajo, lirinë e të shprehurit dhe lirinë e të mos qenit i cënuar, lirinë e ndërgjegjes e besimit dhe lirinë e të shprehurit të tij publikisht. Ndaj edhe klithmat rrënjëqethëse mesjetare janë vikatje e vërrima për të nxjerrë jashtë ligjit demokracinë dhe shoqërinë e lirë. Në fakt sulmi ndaj shamive myslimane në thelb është sulm ndaj një besimi fetar, ku për ironi përdoret laicizmi.

Raporti mjaft miqësor që kanë disa me injorancën nuk mundet asesi të shëmtojë traditën e popullit tonë të mishëruar edhe në kostumografi, e cila për hir të së vërtetës është

e privuar nga minifundet, korsetë, mbërtheakat apo tangat. Edhe heronjtë apo figurat tona kombëtare janë mishërim i burrërisë apo përulësisë e thjeshtësisë. As mjekrrat e Skënderbeut, Ismail Qemalit, Naim Frashërit e Fan Nolit e as shamitë e Nënë Terezës apo të mijëra nënave e gjysheve shqiptare përgjatë historisë nuk thërrasin për paligjshmëri. Ajo që në Shqipëri duhet të zhduket njëherë e mirë, është mendësia e mykur fetare e bodrumeve që brez pas brezi ka helmuar shëndetin e një kombi.

Sigurisht që nuk ka menduar kështu Presidenti Obama, kur zgjodhi një grua të mbuluar në Shtëpinë e Bardhë si përfaqësuese e grave myslimane. Sigurisht që nuk mendon kështu Kongresi Amerikan apo Dhoma e Përfaqësuesve Anglezë që në gjirin e tyre kanë të zgjedhur myslimanë e myslimane edhe me shami. Sigurisht që nuk mendojnë kështu pjesa më e madhe e vendeve demokratike perëndimore, pikërisht se dinë të respektojnë fenë si burim virtyti.

Por, le të fokusohemi mbi argumentet se përse vajzat me shami duhet të mos pengohen të frekuentojnë shkollat.

Nuk po përmendim një numër nenesh të kushtetutës apo edhe konventash ku Shqipëria aderon, sepse tashmë janë bërë pjesë e debatit, por le të themi se kundërshtarë të flaktë të shamisë në shkolla përdorin nenin 17 të kushtetutës ku në një paragraf citohet kufizimi i të drejtës kushtetuese për “interesa publike dhe në mbrojtje të të drejtave të të tjerëve”. Ky nen keqpërdoret në rastin e vajzave me shami, sepse prerogativa e tij qëndron kur bëhet fjalë për privimin e së drejtës kushtetuese si në rastin e pronës për interesa apo investime publike. Sepse në rastin e vajzave me shami, ato nuk çenojnë interesa publike. Edhe nëse do të ishte e vërtetë kjo, kush është kriteri matës i cënueshmërisë ose jo të këtij interesi publik? Edhe në rastin e mohimit të së drejtës së pronës për interesa publike, kushtetuta parashikon kompensimin e të cënuarit që kryesisht është financiar. Por për cënimin e së drejtës kushtetuese të arsimit të vajzave me shami, cili është kompensimi? A ka kompensim tjetër për arsimimin përveçse arsimit?

“Laik” në thelb do të thotë popullor, pra ka një kontradiktë mes laicizmit si sistem që buron nga populli në kundërvënien ndaj vetë popullit, në këtë rast popullit besimtar. Aq më tepër që preambula e Kushtetutës së Shqipërisë fillon me:

“Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera të tjera universale, me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror, me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar, me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bash-

këpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit, Vendosim këtë Kushtetutë”.

Pra, një popull me besim në Zotin në frymën e tolerancës dhe bashkëjetesës fetare ndër të tjera vendosin këtë Kushtetutë. Tani, një pjesë e këtij populli ngrihet kundër pjesës tjetër duke mohuar frymën e tolerancës dhe bashkëjetesës fetare dhe thyen parimet kushtetuese që vetë ka miratuar.

Procesi i mësimdhënies apo teksteve shkollore është proces laik i miratuar. Nuk ka asnjë dokument ligjor ose jo, që thotë se procesi i nxënies apo përthithjes së dijes duhet të jetë laik, sepse do të ishte absurde dhe në të njëjtën kohë imponuese duke shkelur bazën e demokracisë. Për rrjedhojë përthithja e dijes bëhet lirshëm e emancipuar nga nevoja për laicizëm. Ajo është një e drejtë individuale dhe, si e tillë, gëzon të gjitha parametrat e lirisë së individit.

Shamia nuk është simbol fetar. Simbol do të thotë shprehje e koncentruar e një ideologjie apo etnie, kombi etj. siç është rasti i flamurit. Simboli i ka të paracaktuara elementët e vet: ngjyrën, stemën formën dhe përmasat. Shamia nuk është shprehje e koncentruar e Islamit, sepse është thjesht një element i tij. Nuk ka ngjyrë të paracaktuar as formë të prerë. Mund të blihet si në dyqane firmato po ashtu edhe tek tregu çam.

Shamia është menyrë jetese dhe jo simbol kleri apo hierarkie, për arsyen e thjeshtë se në Islam nuk ka hierarki (kler). Kështu që mënyra e jetesës nuk mund të identifikohet me simbolin. Kjo do të thotë se jo domosdoshmërisht një e mbuluar duhet të jetë klerike, si në rastin e murgeshave. Çdo femër myslimane e mbuluar mund të jetë inxhinieri, mësuese, doktoreshë, administratore, tregtare etj. Shamia është bindje ndaj një urdhri hyjnor ndërsa pjesëmarrja në jetën publike është qasje individuale.

Sistemi arsimor publik u shërben publikisht qytetarëve që në të njëjtën kohë janë edhe taksapagues. Preteksti i laicizmit të një shërbimi publik është precedent për të privuar besimtarët me shami nga shërbime të tjera publike si: shërbimi shëndetësor, shërbimi spitalor, shërbimi i gjendjes civile dhe çdo shërbim tjetër dhe e gjitha kjo në emër të laicizmit. Kështu shkohet bukur drejt një aparteidi par excellance nga një vend anëtar i NATOS.

Teoria e ndikimit të fesë nga vajzat me shami tek nxënësit e tjerë bie poshtë për arsye se, një vajzë besimtare e pambuluar mund të bëjë më shumë propagandë fetare në shkollë dhe të mos hiqet nga shkolla, ndërkohë që një e mbuluar menjëherë i bën nxënësit të pozicionohen në vetvete.

Në shkollat tona po ndodhin të pabëra. Kush nuk njih shqetësimet e prindërve për shkollat në të cilat ata duan të edukojnë fëmijët e tyre. A janë këto shkolla ku përhapen e prodhojnë video seksuale edhe orale bile, ku droga dhe kryeneçësia bëjnë laicizmin të duket qesharak, shpërfytyrojnë mësuesin dhe edukatën si virtyt?

Sahabët e Resulullahit (a.s.) yjet e kësaj feje, prijësit tanë...

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Nga gjuha arabe, fjala *sahib*, do të thotë shoqërues, mik, shok. Në terminologjinë fetare islame, sahabiu është: “Ai që e ka takuar profetin (a.s.), duke qenë besimtar dhe që ka vdekur në Islam”.¹

Për nga natyra humane, sahabët janë njerëzit më të mirë pas profetëve të Allahut. “Eh-lus-sunne janë dakord se të tërë sahabët janë të ndershëm e të drejtë”², fakt që na obligon me më shumë respekt dhe nderim për secilin prej këtyre burrave të nderuar që Allahu i Madhëruar i përzgjedhi të ishin në krahët e më të dashurit të krijesave të Tij, në momentet më kulminante të jetës dhe misionit të tij profetik.

Në ilahitë e tij, të botuara me shkronja arabe, Hafiz Jusuf Këlmendi (1876-1943), thotë:

**Salavat bjerni rob mas atij habibit
Sahabeve tan rob se janë yjet e dinit
Nër sahabe rob fort ruje gojen ti
Se me sha sahabet rob bahesh rafidí
Rafidí asht q’aj hej që levdon Alínë
Shan Eba Beqirin hej edhe Omerínë**

Gjashtë vargjet e mësipërme tërheqin vëmendjen drejt një çështjeje për të cilën duhet të zbardhim disa fakte. Au-

1. Ky është përkufizimi i Ibn Haxher Askalanit, si në librin: “Faslul-khitab fi mevakifil-ashab”, të Shejkh Muhamed Salih el-Garsi, botimi i parë, Damask, 2006, fq. 15.

2. Po aty, fq. 19.

tori nxit salavatën dhe respektin ndaj sahabëve të Resulullahit (a.s.). Në këtë pikë, ai shkon pas udhëzimit kuranor, në të cilin sahabët kanë marrë një vlerësim të jashtëzakonshëm duke u etiketuar si: “populli më i mirë i dalë për njerëzimin”³. Ata kanë merituar pëlqimin dhe kënaqësinë e Allahut, sikurse dëshmohet në Librin e Tij: “Sa u përket besimtarëve të parë prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim; edhe ata janë të kënaqur me Atë.”⁴ etj.

Autori tregon se sahabët “janë yjet e dinit” dhe ka plotësisht të drejtë. Për këtë dëshmohet në transmetime të ndryshme profetike, si thënia e tij (a.s.): “Sahabët e mi janë si yjet, cilindo që të pasoni, do të udhëzoheni”⁵, ose transmetimi i Rezinit, nga hadithi i Omerit⁶, në thelbin e të cilit qëndron një pyetje me të cilën Resulullahi (a.s.), i drejtohet Krijuesit të gjithësisë rreth divergjencave të sahabëve, pas tij. Zoti i Madhëruar i përgjigjet: “O Muhamed, sahabët e tu tek Unë, janë si yjet në qiell, njëri më i fortë se tjetri, ku secili ka dritë...”.⁷ VAllahu a’lem!

Më pas, autori tërheq vëmendjen e lexuesit për të ruaj-

3. Kurani, Ali Imran, 110.

4. Kurani, Teube, 100.

5. Shih: Muhamed Jusuf el-Kandehlevi, “Hajatus-sahabe”, botimi i 6-të, Damask, 1993, vëll. I, fq. 33-34.

6. Merfu.

7. Muhamed Jusuf el-Kandehlevi, “Hajatus-sahabe”, botimi i 6-të, Damask, 1993, vëll. I, fq. 34.

tur gjuhën në hak të sahabëve, krejt sahabëve, sepse shajja, fyerja a mungesa e respektit në hak të cilitdo prej sahabëve është diçka e ndaluar në fenë tonë. Resulullahi (a.s.), urdhëron: “Mos i shani sahabët e mi!”⁸ Po ashtu, thotë: “Kijeni frikë Allahun, kijeni frikë Allahun në sahabët e mi! Mos i bëni ata objekt sharjesh pas meje!...”⁹

Transmetohet nga Enesi (r.a.), se Resulullahi (a.s.), ka thënë: “... Do të ketë në kohën e fundit (ahirizaman) njerëz që do të pakësojnë vlerën e tyre (sahabëve). Mos u martoni me ta! Mos i martoni ata! Mos u falni me ta! Mos u falni për ta! Ata e kanë merituar mallkimin!”¹⁰

Gjithashtu është transmetuar se Resulullahi (a.s.), ka thënë: “Kur të shfaqen fitnet (sprovat e intrigat) dhe të shahen sahabët e mi, **le ta shfaqë i dituri dijen e tij**, e nëse nuk e bën këtë i qoftë mallkimi i Allahut, melekëve dhe mbarë njerëzve. Atij nuk do t’i pranojë Allahu as farz, as synet.”¹¹

Në vargjet e mësipërme, ata që shajnë sahabët janë krahasuar me rafiditë, që janë një “grupim shiit që beson se njerëzit e ehli-bejtit meritojnë të jenë prijës mbi të gjithë sahabët e tjerë, përfshi edhe Ebu Bekrin dhe Omerin...”¹²

Me fjalë të tjera, autori kthehet me vëmendjen tonë në çështje të vjetra divergjenciale që e kanë ndarë këtë ymet të madhnueshëm islam në sunitë e shiitë. Por, unë nuk do të hy në këtë temë, sepse gjykoj që nuk është as vendi as koha për ta bërë një gjë të tillë. Ajo që do të bëj është të zbardh fakte rreth madhësisë së sahabëve dhe të nxjerr në pah gabimin fatal të atyre që guxojnë të prekin me gojë të tyre emrin, madhëstinë dhe përkushtimin e cilitdo prej sahabëve të Resulullahit (a.s.), kushdo qofshin ata e kudo qofshin!

Rafidí asht q’aj hej që shan Muavínë
Përmi gjithë sahabet hej qet Hazret Alínë
Rafidí asht q’aj hej që levdon Alínë
Shan Eba Beqirin hej edhe Omerínë

Në lidhje me atë çfarë ka ngjarë në mesin e disa sahabëve, dijetarët thonë se, “ajo çfarë ka ndodhur, ka qenë me planifikim dhe kurdisje të sebeistëve, pasuesve të jehudiut Ibnus-Seuda.”¹³ Ndërkohë, Ibn Haxher Hejtemiu thotë se:

8. Transmetuar nga Bukhariu dhe Muslimi, nga Ebu Said Khudriu (r.a.).

9. Transmetuar nga Tirmidhiu dhe Ibni Hibbani, nga Abdull-llah ibni M - gaffel (r.a.).

10. Transmetuar nga Imam Shafiu, sikurse e kam gjetur në librin: “Faslul-khitab fi mevakifil-ashab”, fq. 18.

11. Transmetuar nga Khatibi në “El-Xhamiu” dhe të ngjashëm me të Ibni Asakiri. “Ka thënë dr. Muhamed Uxhaxh el-Khatib: *Lajm i dobët!*” - Me përshtatje nga: “Faslul-khitab”, vep. e cit., fq. 18.

12. Dr. Mani el-Xhuheni, “El-meusuatul-mujesseretu fil-edjani vel-medhahibi vel-ahzabil-muasereti”, botimi i tretë, Rijad, 1418, vëll. II, fq. 1069.

13. Shejkh Muhamed Salih el-Garsi, “Faslul-khitab fi mevakifil-ashab”, vep. e cit., fq. 21.

“duhet të mbajmë gojën rreth asaj që ka ndodhur në mes tyre, **veçanërisht injorantët e rafiditëve dhe shpikësit përçudnues në hak të ndonjërit prej tyre** (sahabëve), pasi Resulullahi (a.s.), ka thënë: “Kur të përmenden sahabët e mi, mbani gojën!”¹⁴ Detyrë e kujtdo që dëgjon diçka është ta vërtetojë dhe të mos ia atribuojë ndonjërit prej sahabëve, vetëm se e ka lexuar në ndonjë libër a e ka dëgjuar prej dikujt...”¹⁵

Realisht, në botën e sotme ka njerëz, që autori i etiketon si “rafiditë”, të cilët të veshur edhe me rrobë fetare dhe në emër të besimit dhe dashurisë së elementëve të caktuar fetarë, shajnë dhe mallkojnë më të mirin e sahabëve të Resulullahit (a.s.), Ebu Bekrin (r.a.), i cili në Kuranin Famë-lartë cilësohet si: “shoku i tij”¹⁶ dhe njeriun, për të cilin Resulullahi (a.s.), ka thënë: “Allahu e ka vendosur të vërtetën në gjuhën dhe zemrën e Omerit!”¹⁷

E kam parë me sytë e mi, e kam dëgjuar me veshët e mi, një njeri me rroba të zeza, në një ekran të zezuar nga zia e tij, teksa lutej dhe mallkonte “armiqtë” e Fatimesë (r.a.), dhe babait të saj! Allahu e udhëzoftë! Në jetën time nuk kam ndjerë keqardhje dhe zemërim më të madh se në atë moment për atë rrobëzi dhe nga ai zipërhapës, që vetëm zi e përçmim shpërndante teksa lutej, lutjen e tij injorante, duke mallkuar dy ndër sahabët më të dashur të Resulullahit (a.s.)!

Ne si myslimanë, jemi të urdhëruar të mbajmë gojën dhe të jemi të kujdesshëm në fjalët tona, kur flasim për sahabët e Resulullahit (a.s.), ata që sakrifikuhan dhe qëndruan krah për krah me të Dërguarin (a.s.), në ditët më të vështira, në bojkote e beteja, në etje e uri, në skamje e persekutime të papërshtueshme!

Ne i duam dhe i lartësojmë krejt sahabët. Cilësojmë me veçoritë përkatëse ata që i ka cilësuar vetë Resulullahi (a.s.), pa dashur të bëjmë me këtë veprim dallim a anim nga njëri apo tjetri prej tyre. Në këtë kontekst, Imam Tahaviu thotë: “Ne i duam sahabët e Resulullahit (a.s.), por nuk e tepërojmë në dashurinë tonë ndaj tyre, as nuk heqim dorë nga asnjëri prej tyre. Urrejmë këdo që i urren! Dashuria e tyre është fe, besim, ihsan, ndërsa urrejtja e tyre femohim, hipokrizi dhe devijim!”¹⁸

E teksa rasti na ndal tek Ebu Bekri (r.a.) dhe Omeri (r.a.), e

14. I transmetuar nga rrugët e Ibni Mes’udit, Thoubanit dhe Ibni Omerit (r.a.).

15. Shejkh Muhamed Salih el-Garsi, “Faslul-khitab fi mevakifil-ashab”, vep. e cit., fq. 22.

16. Kurani, Teube, 40. Ajeti i plotë është: “Nëse ju nuk e ndihmoni atë (Muhamedin a.s.), Allahu tashmë e ka ndihmuar ditën kur atë e dëbuan mohuesit **vetë të dytin**, kur ishin në shpellë e ai i thoshte **shokut të vet** (Ebu Bekrit): “Mos u mërzi, se Allahu është me ne!”...”

17. Transmetuar nga Ahmedi, Ebu Davudi, Ibni Maxheh etj, nga Ibni Omer (r.a.).

18. Shejkh Muhamed Salih el-Garsi, “Faslul-khitab fi mevakifil-ashab”, vep. e cit., fq. 21.

shoh të udhës të zbardh disa argumente në hak të madhështisë, gradës dhe vendit të tyre në zemrën e Resulullahit (a.s.).

Transmeton Bukhariu, nga Ebu Hurejra (r.a.), që thotë: Ka thënë Resulullahi (a.s.): “Ai që më bindet mua, i është bindur Allahut. Ai që më kundërshton mua, ka kundërshtuar Allahun. Ai që i bindet *dy emirëve të mi*, më është bindur mua. Ai që kundërshton dy emirët e mi, më ka kundërshtuar mua!”

Amr ibnul-Asi (r.a.), tregon: E pyeta Profetin (a.s.): “Kush është më i dashuri i njerëzve për ty?” Tha: “Aishja!” Thashë: “Po prej burrave?” Tha: “*I ati i saj!*” I thashë: “Pastaj kush?” Tha: “*Omer ibnul-Hattabi!*”¹⁹

Ibn Omeri, thotë: Doli Resulullahi (a.s.), në mes të Ebu Bekrit dhe Omerit dhe tha: “*Kështu do të ringjallemi!*”²⁰

Ebu Xhuhajfe es-Suvai, thotë: Kam dëgjuar Aliun (r.a.), që thoshte: “A t’ju tregoj për më të mirin e këtij ymeti pas profetit të tij? *Ebu Bekri!* A t’ju tregoj për më të mirin e këtij ymeti pas Ebu Bekrit? *Omeri!*”²¹

Transmeton Enes ibni Malik (r.a.), nga Profeti (a.s.), që ka thënë: “Më mëshiruesi i ymetit tim për ymetin tim, *Ebu Bekri!* Më korrekti i tyre në fenë e Allahut, *Omeri!*”²²

Transmeton Said ibni Vekkas (r.a.), në një hadith të gjetë, ku Resulullahi (a.s.), i thotë Omerit: “*O i biri i Hattabit*, pasha Atë që e ka shpirtin tim në dorën e Tij, sa herë që shejtani të takon duke ecur në një shteg, do të ndjekë një shteg tjetër, ndryshe nga shtegu yt!”²³

Këto argumente e shumë të tjera si shembulli i tyre, duhet të na mësojnë mbi të gjitha edukatën dhe respektin e madh në hak të këtyre burrave të nderuar që sakrifkuan çdo gjë nga jeta e tyre për hatrin e fesë dhe përhapjes së saj me drejtësi, dashuri e argumente të qarta!

Gjithashtu, duhet theksuar se, teksa flasim për këta dy sahabë të nderuar, nuk nënvlehtësojmë aspak asnjë nga sahabët e tjerë, aq më tepër hz. Aliun (k.v.), i cili ka një vend të madh në zemrën e Resulullahit (a.s.), një përkushtim e kontribut të pashoq në përhapjen e fesë dhe mësimave të saj, një dashuri të madhe në zemrat tona!

Ndërkohë, është e çuditshme sesi “rafiditët” e mallkojnë në Omerin (r.a.), për hz. Aliun, kur historia na tregon se Omeri (r.a.), është martuar me vajzën e Aliut dhe Fatimes, vajzës së Resulullahit (a.s.), zonjën Ummi Kulthum, prej të cilës ka pasur dy fëmijë, Zejdin dhe Rukajen²⁴!?

19. Transmetuar nga Bukhariu dhe Muslimi.


20. Transmetuar nga Ibni Maxheh dhe Tirmidhiu.

21. Transmetuar nga Ahmedi në “Musned”.

22. Transmetuar nga Ahmedi në “Musned” etj.

23. Transmetuar nga Bukhariu, Muslimi dhe Ahmedi në “Musned”.

24. Naxhi dhe Ali Tantavi, “Akhbaru Omer”, botimi i 11-të, Xheddah, 1999, fq. 364.



Sidoqoftë, Allahu ua ndriçoftë mendjen dhe zemrën për t’u kthyer nga rruga e gabuar në të cilën shtegtojnë ditë pas dite!

Në këtë pikë, po mjaftohem me thënien e Ebu Zur’at Raziut, i cili thoshte: “Nëse sheh dikë që pakëson vlerat e sahabëve të Resulullahit (a.s.), dije se ai është **zindik!** Kjo, sepse Resulullahi (a.s.) është hak, edhe Kurani hak, edhe ajo çfarë ai na ka mësuar hak. Të gjitha këto na kanë mbërritur nëpërmjet sahabëve, ndërsa ata (pakësuesit e vlerës së sahabëve) deshën të preknin dëshmitarët tanë (sahabët) për të hedhur poshtë Kuranin dhe Synetit. Në të vërtetë, ata kanë rënë poshtë, ata janë zindikë!”²⁵

Sahabet të tan rob janë yjet e dinit Cilit don i ujdishesh ti ja mrrin pështimit

I dërguari i Allahut ka urdhëruar: “Nderojini sahabët e mi, sepse ata janë më të mirët tuaj!”²⁶ Ndërsa Imam Kurtubiu ka thënë: “Ata krejt janë prijësit tanë!”²⁷

Allahu na ruajtë nga devijimi dhe na bëftë prej respektuesve të sahabëve të Resulullahit (a.s.), yjeve të kësaj feje!

25. Shejkh Muhamed Salih el-Garsi, “Faslul-khitab fi mevakifil-ashab”, vep. e cit., fq. 20.

26. Transmetuar nga Nesaiu me isnad të saktë, si në “Faslul-khitab”, vep. e cit., fq. 22.

27. Shejkh Muhamed Salih el-Garsi, “Faslul-khitab fi mevakifil-ashab”, vep. e cit., fq. 21.



Orientalistët dhe Hadithi

Nexhat Ibrahim

HYRJE¹

Hadithi² ka qenë objekt shqyrtimi debatesh e përkushtimi qysh nga ditët e para të tij. Në periudhën më të hershme hadithi kontestohet, për faktin se vihet në jetë dhe respektohet nga një masë e madhe njerëzish që ishin, pjesa dërrmuese bashkëvendas të Muhamedit (a.s.). Më vonë, fronti i kundërshtimit që zgjeruar, duke u shtrirë edhe përbrenda myslimanëve e sidomos kjo tendencë gjeti vend në preokupimet e jomuslimanëve. Megjithatë kundërshtimet ekzistojnë qysh nga fillimi e deri në fund të shekullit III hixhri, kundërshtim të organizuar nuk pati. Edhe kur ekzistonte, ai ishte më shumë individual, i zbehtë dhe nuk paraqiste ndonjë pengesë serioze që meritonte ndonjë përkushtim të veçantë. Më tepër ishte si manifestim i fanatizmit fetar kristian. Mirëpo, me kalimin e shekujve, me intensifikimin ushtarak, politik, tregtar e kulturor islamo-kristian edhe interesimi për studimet ndaj hadithit filloi të rritej. Kjo ndodhi sidomos gjatë shekullit XIX-të dhe XX-të, kur hadithi studiohet si fushë e veçantë, në kuadër të studimeve të përgjithshme të orientalistëve pe-

1. Synimi i këtij shkrimi është të shtrojë zhvillimet për hadithin dhe rreth hadithit të orientalistët, kalimthi, duke theksuar përfaqësuesit e tyre kryesorë, qëndrimet, paragjykimet, por edhe kontributin e tyre. Meqë pretendimet e shkrimit janë modeste, edhe literatura edhe autorët e përdorur janë të kufizuar.

2. Hadith është ajo që Muhamedi (s.a.v.s.), ka thënë, vepruar, miratuar apo heshtur. Në hadith bëjnë pjesë edhe ato lajme të cilat flasin për cilësitë e Pejgamberit (a.s.). Shih gjerësisht: Imam Vehbi Ismaili, *Vepra 6*, Logos-A, Shkup, 2009, fq. 19 etj. H. Mehmed Hanxhiq, *Hyrje në shkencën e hadithit*, përktheu Nexhat Ibrahim, Logos-A, Shkup, 1997, fq. 7-9.

rëndimorë dhe botërorë.³

FILLIMET E ORIENTALIZMIT DHE TË STUDIMEVE ORIENTALE

Fillimet e orientalizmit nuk duhen kërkuar në kohët e lashta, edhe pse fërkimet e para rrjedhin qysh atëherë. Kur bota myslimane dhe kristiane u ndeshën me tërë forcën, atëherë filluan edhe studimet më të hovshme e më sistematike. Kjo është koha e Kryqëzatave. Superioriteti mysliman në rrafshin ushtarak, politik, tregtar, shkencor e kulturor, shtrirja e fuqishme myslimane në të katër anët e botës, rënia e territoreve kristiane një nga një (Spanja, pjesë të territorit Bizantin, etj.), i nxiti krerët kishtarë sidomos perëndimorë, por edhe prijësit politikë, që krahas fuqizimit politik e ushtarak duhej të ndodhte edhe fuqizimi intelektual, që ta mbronte fenë dhe territoret e tyre.⁴

Ndër veprimet e para në atë që do të quhet *orientalistikë* është angazhimi i Robert Kettanit nga ana e klerikut me ndikim nga Clunyi në Francë, Petri i Madh, që të bënte përkthimin e Kuranit në gjuhën latine, me synimin e vetëm që të mposhtej feja islame.⁵ Normalisht, përkthimet dhe studimet e tilla nuk kanë mundur të ofrojnë një pasqyrë objektive për

3. Omer Nakicevic, *Uvod u hadiske znanosti*, Sarajevë, 1986, fq. 19.

4. Safvet Halilovic, *Umjesto predgovora*, në veprën: Mustafa es-Sibai, *Orijent - lizam i orijentalisti (za i protiv)*, prijevod Nezir Halilovic, Zenicë, 2003, fq. 5.

5. Ismail Ibrahim Navvab, *Orijentalne studije: pregled korijena*, Beharistan, casopis za kulturu, 5/6, 2002, preveo Ahmet Alibašić, fq. 124, cituar sipas: Aljo Cikotic, *Orijentalisti i hadis*, Glasnik Rijaseta Islamske Zajednice Bosne i Hercegovine, nr. 5-6, 2009, fq. 419.

Islamin, sepse synimet nuk ishin qëllimmira. Ato bëheshin me kërkesë të Kishës dhe nën direktivat e saj. Një frymë e tillë studimesh për fat të keq ka mbetur edhe pas Kryqëzave, ndonëse studimet për Islamin nuk ishin ekskluzivitet i Kishës, por edhe i subjekteve të tjera.⁶ Kjo bëri që studiuesit e Islamit të viheshin në shërbim të kolonializmit perëndimor, shpeshherë në lidhje të ngushta me misionarët kristianë, kurse gjatë shekullit të fundit, në lidhje edhe me lëvizjen sioniste.⁷ Këto rrethana kanë bërë që deformimi i mësimave islame dhe paragjykimet të shtriheshin në tërë hemisferën perëndimore: Amerikë, Angli, Gjermani, Rusi, Francë, Itali, Holandë etj.⁸

ORIENTALISTËT DHE HADITHI

Studimet orientaliste për një kohë të gjatë nuk ishin të specifikuar në një fushë të caktuar, por ishin të përgjithësuara. Studiohej Kurani, filozofia apo aspekte të fushave ekzakte. Vetëm më vonë, në shekullin XVII, vërejmë një studim të hollësishëm. Ndër perëndimorët e parë, i cili shkroi për hadithin, ishte orientalisti francez De Herbelot.⁹ Ky mendon se nëntë përmbledhjet kryesore të hadithit janë të huazuara nga Talmudi.¹⁰ Mirëpo, në shekullin vijues, studimet e hadithit thellohen edhe më tepër, kurse hadithi studiohet më vete. Në shekujt XIX-XX, hadithi i kushtojnë kujdes të veçantë Leone Caetani (1869-1926), S. W. Muiri (1819-1905) etj. Megjithatë, njeriu që më së shumti u angazhua në atakimin e hadithit ishte Ignaz Goldziher.¹¹ Vepra e tij *Muhamedanische Studien* (Muslim Studies) (Halle, 1889-1890, 2 vol.), është bërë strumbullar i të gjitha studimeve perëndimore.

Më vonë, studimet avancuan, por në aspekt të cilësisë. Kështu kemi edhe orientalistin Joseph Schacht (1902-1969). Edhe ai ishte tejet tendencioz, kurse vepra e tij burim tendencioziteti orientalist.¹² Madje, sipas orientalistit Ser Ha-

milton Gibb¹³ "Ajo vepër në të ardhmen do të bëhet themel për të gjitha studimet e kulturës, qytetërimit dhe së drejtës islame në Perëndim."¹⁴

ORIENTALISTËT DHE SHKRIMI I HADITHIT

Nëse William Muiri është ndër autorët e parë seriozë që e kontestoi në përgjithësi teorinë klasike të autenticitetit të Kuranit dhe në veçanti të shkruarit e tij, atëherë Ignaz Goldziheri është kulmi i këtij kontestimi. Muiri pohon se hadithin i pari e shkroi Ibn Shihab Ez-Zuhri¹⁵ në shekullin II hixhri, sipas urdhrit të Omer Ibn Abdulazizit.¹⁶ Këtë ide e përpunoi edhe Goldziher në veprën *Muhamedanische Studien*, duke pohuar se hadithin myslimanët filluan ta shkruajnë vetëm në shekullin II hixhri. Ai pohon se ky ishte hapi i fundit për ta ruajtur traditën e Pejgamberit (a.s.), pasi thekson se është e pamundur të ruhet, memorizohet dhe transmetohet.¹⁷ Orientalistët e tjerë më vonë do të thonë se përmbledhjet e hadithit, që sot i kemi, janë vetëm "manifestim i tendencave që kanë ekzistuar në bashkësinë myslimane gjatë periudhës më të pjekur të zhvillimit" e jo manifestim i fjalës së vërtetë të Pejgamberit (a.s.).¹⁸ Orientalisti gjerman Schacht shkon edhe më tej, duke e shtyrë edhe më vonë shkrimin e hadithit. Sipas tij, pohimi se hadithi është shkruar në pjesën e parë të shekullit II hixhri, është vetëm pretekst për të trilluar hadithe që do të arsyetojnë traditat zakonore dhe ato shoqërore arabe.¹⁹ Tentime të tilla kemi edhe brenda myslimanëve, qoftë të motivuar me mendime islame qoftë të ndikuar nga orientalizmi evropian.²⁰

Dijetari mysliman Imam Vehbi Ismaili ynë, në studimin e tij për shkencën e hadithit, pohon se hadithi nuk e kishte tretmanin e Kuranit, por edhe ai shkruhej sipas nevojë. Në një rast, siç raporton Abdullah ibn Amri, thotë: "Unë shkruaja çdo gjë që dëgjoja nga Profeti (a.s.), me qëllim që më vonë t'i mësoja përmendsh. Disa më kritikuan për këtë gjë. I tregova Profetit dhe ai më tha: 'Shkruaj se unë flas vetëm të vërtetën.'" ²¹ Raportohet se kanë ekzistuar disa përmbledhje hadithesh: Sahifja e Sa'd ibn Ubadete El-Ensariut, Nus'hat'ul-kebareh

6. Ismail Ibrahim Navvab, po aty, fq. 125.

7. Ahmed Smajlovic, Felsefetu'l-istishraki ve etheruha fi'l-edebi'l-arabijji'l-muasir, Kajro, 1980, Daru'l-Mearif, fq. 119-125.

8. Orientalistika në përgjithësi kishte motive fetare, politike, ekonomike, por edhe shkencore. Gjerësisht shih: Mustafa es-Sibai, *Orijentalizam i orijentalisti (za i protivu)*, po aty, fq. 63-68.

9. Barthélemy d'Herbelot (1625 -1695) është orientalist francez, sipas: shih: http://en.wikipedia.org/wiki/Barth%C3%A9lemy_d'Herbelot.

10. Akram Diya al-'Omari, *Ma'qif al-istihsaq min as-sunna 'ea-s-sira an-n -ba'ijja*, Revistë e Univerzitetit Katar: Merkez buhuth as-sunna 'ea-s-sira, nr. VII, 1994/95, fq. 70, sipas Aljo Cikotic, po aty.

11. Ignaz (Yitzhaq Yehuda) Goldziher (1850-1921) është orientalist hu -garez me prejardhje hebraike dhe bashkë me gjermanin Theodore Noldeke dhe gjermanin Christiaan Snouck Hurgonje konsiderohet si themelues i studimeve moderne të islamistikës. Sipas: http://en.wikipedia.org/wiki/Ign%C3%A1c_Goldziher.

12. Joseph Schacht (1902-1969) orientalist gjerman me prejardhje he -raike dhe autor i disa veprave për Islamin (fikhun, usuli-fikhun etj.). Vepra më e rendësishme e tij është *Origjina e jurisprudencës muhamedane* (Origins of Muhammadan Jurisprudence, 1950). Shih këtë vepër: <http://islam-and-muslims.com/Origins-Muhammadan-Jurisprudence-Schacht.pdf>.

13. Ser Hamilton Gibb (1895-1971) është ndër orientalistët më të njohur anglezë në shekullin XX.

14. Muhammad Bahauddin, po aty, fq. 21. Krhs.: Omer Nakicevic, po aty, fq. 20.

15. Shih: Muhamed Ikbali, Ripërtëritja e mendimit fetar në Islam, pë -ktheu: Nexhat Ibrahim, Logos-A, Shkup, 2006, fq. 220.

16. Muhammad Bahauddin, po aty, fq. 34. Omer b. Abdulaziz (61-101 h.), i biri i Abdulaziz b. Mervan dhe pasardhës i Omer b. El-Hattabit r.a. Ky si halif ishte dy vite e pesë muaj. (Ibn Sa'd, *Tabekat*, vëll. V, fq. 408), sipas: Aljo Cikotic, po aty.

17. Muhammad Bahauddin, po aty, fq. 34.

18. Sipas: Aljo Cikotic, po aty, fq. 418-426.

19. Omer Nakicevic, po aty, fq. 20-21. Muhammad Bahauddin, po aty, fq. 80-81.

20. Omer Nakicevic, po aty, fq. 19-32.

21. Për këtë dhe raste të tjera shih gjerësisht: Suneni i Ebi Davudit, 24:3, sipas: Imam Vehbi Ismaili, po aty, fq. 24.

e Semureh ibn Xhundubit, Sahifja e Xhabir ibn Abdullahut, Sahifja e Abdullah ibn Amr ibn El-Asit, Kodeksi (Kitab) i Muhamedit (a.s.), Sahifja e Abdullah ibn Abbasit, Sahifja e Ebu Hurejres respektivisht e Hemmam ibn Munebbihut, Suhufet e Ebu Bekrit etj.²²

ARSYET E QËNDRIMIT NEGATIV TË ORIENTALISTËVE NDAJ HADITHIT

Shkaqet që orientalistët patën qëndrim negativ ndaj hadithit janë të shumta, por disa janë kryesore:

- Mosnjohja zyrtare e Islamit, Kuranit dhe Muhamedit (a.s.), nga ana e Kishës kristiane. Kjo mosnjohje ka ndikuar që edhe çfarëdo që rezulton prej tyre të mos njihet, të përçmohet, të kritikohet dhe të devijohet doktrina e tij.²³

Në përgjithësi, orientalistët mohojnë se Islami është feja e fundit nga Allahu (xh. sh.), e shpallur Pejgamberit (a.s.), nëpërmjet Kuranit.²⁴ Për shkak të këtij problemi shpeshherë ata ngatërrojnë tekstin e Kuranit dhe të Hadithit, pa ditur si t'i specifikojnë, duke thënë se edhe Kurani edhe Hadithi janë produkt i Muhamedit (a.s.).²⁵

KONTRIBUTI I ORIENTALISTËVE NË STUDIMIN E HADITHIT

Është e padiskutueshme se orientalistët, për shkak të paragjyimeve dhe bindjeve të tyre të shtrembëruara ndaj Islamit, kanë bërë dëme të konsiderueshme. Por, gjithashtu është e padiskutueshme se kanë dhënë edhe kontribut që vlen të theksohet. Motivet mund të jenë edhe jo fort humane, por në disa raste kemi synime të pastra shkencore. Kështu, kemi gjetjen, përpunimin dhe publikimin e disa veprave në dorëshkrim me rëndësi parësore. Veprat zakonisht janë botuar në origjinal dhe në përkthim në ndonjërin nga gjuhët evropiane me standarde të larta shkencore.

Por, projekti që vlen të përmendet është Indeksi i Haditheve të Pejgamberit (a.s.), i punuar prej orientalistëve me titull "*El-Mu'xham el-mufahras fi elfadh'il-hadith*". Këtë projekt e filloi orientalisti Arent J. Wensink dhe zgjati rreth 50 vjet. Vëllimi i parë doli më 1936 në Leiden, kurse i fundit më 1987.²⁶ Në këtë vepër janë radhitur sipas rendit alfabetik hadithet e nëntë përmbledhjeve të njohura si *Kutub'ut-tis'a*, e ato janë: *Dy Sahihët*: i Buhariut dhe Muslimit, *katër Sune-ne*: Tirmidhiut, Ebu Davudit, Nesaiut dhe Ibn Maxhes, *dy musnedet*: Ahmed ibn Hanbelit dhe Darimiut dhe *Muvatta`i*

22. Seid Ramadan, E drejta islame, përktheu: Nexhat Ibrahim, Logos-A, Shkup, 2007, fq. 45 e tutje. Omer Nakicevic, po aty, fq. 38-40 a.; H. Mehmed Hanxhiq, po aty, fq. 17-19.

23. Mustafa as-Siba'i, *As-Sunna wa makanatuha fi at-ta'sri'i al-islamijji*, al-Maktab al-Islami, Bejrut, 1985, fq. 188-189.

24. Mustafa es-Sibai, *Orijentalizam i orijentalisti (za i protiv)*, po aty, fq. 71.

25. Mustafa es-Sibai, po aty, fq. 74.

26. Mustafa es-Sibai, *Orijentalizam i orijentalisti (za i protiv)*, po aty, str. 22.



i Malik ibn Enesit.²⁷

Dijetarët myslimanë kanë zotëruar disa indekse dhe metoda për gjetjen e haditheve (kutub'ul-etraf), por projekti evropian është mjaft praktik, më i lehtë, ndonëse edhe këtij realizimi i bëhen ca vërejtje në aspektin praktik. Kohët e fundit ky projekt po përgatitet edhe në formën elektronike, kështu që puna do të lehtësohet edhe më shumë.

NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Preokupimi dhe interesi i orientalistëve për hadithin nuk është i hershëm. Këtë e kanë kushtëzuar shumë faktorë, por kryesorja është panevoja e tyre për hadithin. Edhe preokupimet e para të tyre nuk janë të motivuara për synime të ndritshme, por për ta goditur Islamin edhe nga ky kënd, si në rastin e Goldziherit, Schachtit etj., duke zhvilluar teorinë se nuk ekziston hadith autentik. Për fat të keq, shkenca orientaliste e hadithit nuk ka ecur shumë përpara në këtë rrafsh.

Edhe pse kemi dëshmi burimore se hadithi është shkruar edhe në kohën e Muhamedit (a.s.), madje me dijen dhe rekomandimin e tij, por jo, në mënyrë masive, orientalistë të caktuar e mohojnë këtë mundësi. Shkrimi sistematik dhe metodologjik i hadithit ka filluar të bëhet në pjesën e fundit të shekullit të parë, e sidomos gjatë shekullit të dytë, kur kemi Ez-Zuhriun, Ebu Hanifen²⁸ etj., për të vazhduar në shekullin e tretë me Buhariun, Muslimin dhe kolosët e tjerë.

27. Imam Vehbi Ismaili, po aty, fq. 42 e tutje. H. Mehmed Hanxhiq, po aty, fq. 23-26 e tutje.

28. Veprën e Imam Ebu Hanifes për Hadithin e kemi edhe në gjuhën shqipe: Fuad Sediç, *Musnedi i Imam Ebu Hanifes*, SHB Dituria Islame, Prishtinë, 2009, fq. +287.

SHAMIA, ARSIMI DHE LAICITETI



Ma. Gilman Kazazi

*Q*ebate televizive, kronika lajmesh dhe artikuj gazetash rreth mbulesës, por akoma nuk u vendosën pikat mbi i. Provokojnë ndjenjat e femrave myslimane dhe prindërve të tyre duke analizuar termat: shtet laik, shkollë publike, simbol fetar, veshje arabe etj. dhe akoma u vjen era komunizëm.

Para se të them atë çfarë mendoj lidhur me termat e lartpërmendur, dua të pyes: nga ku buron e drejta e “laikut” për të imponuar norma mbi shoqërinë demokratike?

Shteti laik nënkupton që institucionet e tij duhet të shfaqin paanshmëri ndaj besimeve fetare; nuk duhet të pasqyrojnë asnjë parapëlqim ndaj tyre; të gjitha ambientet shtetërore duhet të jenë asnjansë ndaj çështjeve fetare. Nga ana tjetër, simbolet nuk paraqesin asgjë të panatyrshme, të mbahen në shkolla private si mjete identifikuese të besimit.

Për sa u përket qytetarëve, ata janë të lirë të përzgjedhin dhe të deklarojnë besimin fetar, bindjet e tyre jofetare apo edhe të mbajnë ndonjë simbol fetar. Laicitet do të thotë ndarje e shtetit nga feja dhe jo provokim i shtetit ndaj fesë. Kjo ndarje nënkupton që nuk ka një fe zyrtare, shteti nuk përkrah apo nuk mbështet asnjë pikëpamje fetare. Por kjo nuk do të thotë që shteti është kundër shfaqjeve fetare në

hapësirën publike, përndryshe i bie që në hapësirën publike të marrin pjesë vetëm ata qytetarë që nuk besojnë.

Shkollat publike janë institucione arsimimi, të cilat janë ndërtuar nga prindërit tanë, me taksat e tyre, për të mirën e shoqërisë. Nga vetë emri, publike, ato duhet t’u përgjigjen nevojave të gjithë qytetarëve, pa dallim feje, dielekti, ngjyre apo gjinie. Funksioni i shkollës publike është që të edukojë shoqërinë dhe jo të përjashtojë dhe të përbuzë një pjesë të saj. Çështja e arsimimit të femrave të mbuluara është shqetësuese.

Arsimimi i femrës është arsimimi i familjes dhe i komunit. Mohimi dhe shkelja e së drejtës për arsimim dëmton aftësinë e njerëzve që të zhvillojnë personalitetet e tyre, të mbështesin dhe të mbrojnë vetveten dhe familjet e tyre, si dhe të marrin pjesë përshtatshëmrisht në jetën shoqërore, politike dhe ekonomike. Mohimi i arsimimit dëmton çështjen e demokracisë dhe përparimit shoqëror. Arsimimi është e drejtë themelore e çdo qenieje njerëzore. “*Është mbrojtës më i mirë i lirisë, sesa një armatë e tërë.*” Nga ana tjetër, ndalimi i shamisë dhe lejimi i minifundëve e veshjeve provokuese në shkolla, ku tregohen hiret e trupit femëror, të cilat nxisin pasione amorale jo vetëm tek nxënësit, por edhe tek mësimdhënësit, sinjalizon diskriminim ndaj

vajzave myslimane, të cilat zbatojnë me dashuri e bindje parimin dhe urdhrin Kuranor - mbulesën fetare. Me këtë veprim institucionet përkrahin dekadencën dhe shthurjen morale si dhe propagandën antiislame. Ndoshta është harruar fakti që *lakuriqësia dallon popujt e egër nga popujt e qytetëruar*.

Institucioni shkollor është burim i kulturës dhe qytetërimit të një vendi. Morali i lartë duhet të jetë prioritet për të ushqyer dhe përsosur shpirtat e nxënësve.

Ka shumë gjëra për të debatuar rreth asaj që po ndodh në shkollat publike, si: alkooli, prostitucioni, droga, duhani, veshjet provokuese që nxisin pasione të fshehta satanizuese, cilësia e ulët e mësimdhënies e deri tek kapja e arsimit nga partitë politike, që pa pikë turpi emërojnë aty mësuesit militantë të partive. Të gjitha këto janë objekte debatesh dhe probleme shqetësuese dhe ia vlen të merren masa për zgjidhjen e tyre. Në kushtet kur adoleshentët shqiptarë gjithnjë e më pak frekuentojnë shkollat e mesme, gjithnjë e më pak mësojnë, gjithnjë e më pak respektojnë mësuesit dhe gjithnjë e më shumë pijnë klubeve, duket sikur shqetësimi kryesor i institucioneve të edukimit publik janë vajzat që vënë një shami në kokë, edhe pse ato nuk shquhen për sjellje problematike.

Simboli është një element konkret me tipare të veçanta për të paraqitur në mënyrë të kapshme dhe për të përfaqësuar një ide apo një ndenjë, p.sh. pushka është simbol i luftës, shqiponja është simbol i lirisë, kurse Islami nuk ka simbole dhe nuk mund të shprehet në simbole. Shamia, si detyrim hyjnor për një femër, simbolizon devotshmërinë dhe pastërtinë e saj, por jo Islamin. Islami nuk është fe e një gjinie të vetme. Së dyti, funksioni mbulues i shamisë, si shumë veshje të tjera, është jashtë konceptit të simbolikave. Së treti, shamia nuk është diçka arabe, por një urdhër hyjnor për mbarë njerëzimin në të gjitha besimet hyjnore, për t'i dhënë gruas mbrojtje dhe siguri. Ato gra, të cilat zbatojnë urdhrin kuranor për t'u mbuluar, shfaqin kulturën dhe civilizimin hyjnor dhe jo atë lindor. Gjithnjë, kur është fjala për mbulesën, kritikën lëshohen vetëm në adresë të Islamit, duke i anashkaluar besimet e tjera. Shkaku qëndron në atë se, ky obligim edhe biblik, është i injoruar nga pasueset e saj, me përjashtim të murgeshave.

Ja çfarë lexojmë në Bibël në lidhje me mbulesën:

“... E po ndodhi, që ndonjë grua nuk do ta mbulojë kokën, le të qethet (e le të përjashtohet). A mos është turp për gruan, në qoftë se e qeth ose e rruan kokën? Kjo është arsye e mëtejshme për të mbuluar kokën e saj. ...¹⁰ Prandaj grua duhet të mbajë një shami koke si shenjë varësie për hir të engjëjve (të pranishëm që nuk durojnë



mospërfillje). ...¹³ Gjykoni ju vetë: a ka hije që grua të lutet para Perëndisë me kokë të zbuluar?”¹

Lexues i nderuar, shamia po shfaq paradoksin e demokracive moderne. Në një anë, ata garantojnë të drejtat bazë humane dhe menjëherë në anën tjetër, ata po i cënojnë. Thonë, e drejta e çdo njeri është të mendojë dhe të besojë me vetdëshirë, pa pasur askush të drejtë t'i imponohet. Por fare nuk hezitojnë, pa turp, të ndërhyjnë edhe me sanksione, në përcaktimin e mënyrës së të shprehurit të një mendimi dhe besimi specifik.

Mirëpo, para se të fajësojmë shtetin laik, të fajësojmë vetveten si kontribuesin më të madh në problematikën e (mos) mbajtjes së shamisë. Sikur myslimanet, që të gjitha, nënat, motrat, bashkëshortet dhe bijat tona ta mbanin shaminë, atëherë nuk do të kishte qeveri, as të djathtë e as të majtë, që do të sillte vendimin ligjor për ndalimin e saj në shkollat parauniversitare.

E ç'është më e keqja, myslimania me shami fillimisht po injorohet nga vetë familja e saj, më pas nga fqinjët, nga faqefisi dhe në fund nga shteti. Edhe pse shamia është prezente në disa vende publike, si p.sh. në afërsi të postës në qytetin e Shkodrës sheh Nënë Terezën me shami, në pikat e larta të qyteteve sheh Shën Marinë me shami, pak më andej në treg vëren shumë nëna, bile edhe të atyre ateistëve intelektualë, me shami. Në muzeun kombëtar në të gjitha fotografitë e vjetra si dhe në ekzemplarët e veshjeve tradicionale kombëtare, të të gjitha krahinave dhe besimeve, e gjen shaminë. Shenjtërimi i Nënë Terezës me një shami në kokë, bie ndesh me çshenjtërimin e shamisë së myslimanesh shqiptare. Nëse një femër që zbaton urdhrin hyjnor - mbulesën fetare, i ndalohet shkollimi, për shkak se ajo me atë shami propagandon Islamin në një objekt që është publik, atëherë si do t'i përgjigjen popullit, që arsyeton e gjykon, ata që i kanë shndërruar sheshet e qyteteve të Shqipërisë në simbole të katolicizmit duke ndërtuar përmendore të Gonxhe Bojaxhiut?!

1. Bibla, Dhiata e re, Letra e parë drejtuar Korintasve, 11\ 6-13.



Të rinjtë dhe koha e agimit

Sadik Dana

Cdo besimtar, duhet të ngrihet në kohën e agimit, të vërë kokën në sexhde dhe të adhurojë Zotin e tij. Koha e agimit është dhuntia më e rëndësishme që Allahu u ka dhuruar robërve. Janë momente madhore, në të cilat të gjithë të dashuruarit pas Allahut ngrihen në dimër nga shtretërit e tyre të ngrohtë dhe ia japin shpirin Krijuesit të gjithësisë. Janë momente kur robërit nëpërmjet namazeve, lutjeve, pendimeve, meditimeve dhe dhikrit me lot në sy ndahen nga nefsi i tyre dhe me sinqeritet kërkojnë strehim te Zoti i botëve.

Janë çaste bajrami ku njerëzit me shumë sinqeritet dhe modesti takohen me Zotin e tyre, ndërkohë që njerëzit e pavetëdijshëm dhe indiferentët janë në gjumë. Zgjimët shpirtërore e bëjnë njeriun të ecë përpara.

Frytet hyjnore zbresin nga qielli, sikurse pikat e shiut, duke u shfaqur në zemrat e atyre që e përjetojnë një moment të tillë. E gjithë bota shpirtërore dhe melekët marrin pjesë në këtë përjetim kaq të thellë.

Kush dëshiron ta shfrytëzojë këtë dhuratë shpirtërore, duhet të kryejë obligimet e duhura. Por si të zgjohemi në këto kohë?

Fillimisht, duhet patjetër të rregullojmë jetën tonë, duke e administruar kohën në mënyrë që të mund të zgjohemi herët.

Të mos lodhemi shumë, duke i kushtuar kujdes të tepruar punëve të kësaj bote. Për të pasur një shpirt të fortë dhe shëndet të vijueshëm, duhet të flemë herët. Në këtë mënyrë, mënjanojmë të folurat e panevojshme. Të ushqyerit e lehtë në darkë është i këshillueshëm si nga ana fetare ashtu edhe nga ajo mjekësore. Një stomak i lehtë ndihmon edhe në ngritjen lehtësisht natën. Një ushqim që na rëndon në stomak sjell edhe një peshë të tepërt për zemrën.

Është vënë re se, ata që shoqërohen me salihët (të devotshmit) dhe sadëkët (besnikët) ngrihen lehtësisht për adhurimet e natës. Duke qenë së bashku me ata, që i dorëzohen Allahut, bota e tyre shpirtërore pasqyrohet në zemrat dhe shpirtrat tanë. Gjatë këtij procesi, dashuria për këtë botë humbet, e kështu bëhemi edhe ne pasues të rrugës së tyre.

Ata që ngrihen në kohën e agimit bëhen të lehtë si zogj,

pasi janë zhvilluar shpirtërisht. Për ta është i mjaftueshëm gjumi i pakët. Edhe ushqimi që hanë është i pakët, po kështu edhe bisedat e tyre të panevojshme. Ata që flenë shumë, ankohen përherë për shëndetin, pasi ndjejnë një lloj ngarkese, sikleti dhe përtacie.

Jeta e disa të rinjve është e parregullt dhe pa të ardhme. Çdo gjë që kërkojnë të bëjnë e lënë përgjysmë.

Nëse besimtari është i pamartuar, shkon në shtëpi dhe kalon një kohë të mjaftueshme me prindërit e vet. Ngrihet në kohën e duhur dhe kryen adhurimet e tij. Kur trupit t'i jepet ajo që i takon, shpirti pushon dhe adhurimi kryhet. Gjumi në orët e para të natës është më frytdhënës përse i përket pushimit të trupit. Mirësitë që fiton besimtari, i cili pjesën tjetër të natës e kalon me adhurim, përhapen në çdo moment të ditës dhe nata bëhet mbrojtëse e ditës. Kjo do të thotë se zemra e tij është e mbushur me Nur Hyjnor.

Nëse është tregtar i kushtohet edhe më tregtisë, nëse është nxënës i përkushtohet më shumë shkollës duke arritur rezultate më të mira. Nxënësit për shkak të moshës dhe të statusit të tyre nuk duhet të ngarkohen me adhurime të tepërta shpirtërore. Ata janë më të lehtësuar dhe më të përkushtuar në përgatitjen e tyre për të ardhmen.

Kur njeriu e organizon veten, gjen shumë kohë. Në të kundërt koha i ngushtohet dhe asnjë punë nuk bëhet e plotë. Gjithsecili gjatë ditës merret me impenjimet përkatëse për të qenë i dobishëm për rrethin social. Kush nuk është i vlefshëm dhe i dobishëm për krijesat në këtë botë, nuk do të jetë në botën tjetër i dobishëm as për veten e tij. Kush do Allahun, do edhe gjithësinë. Nëse është i ditur do të ndihmojë me dijen e tij, nëse ka mundësi financiare, do të ndihmojë me to, e nëse ka fizik të fortë, do të ndihmojë me fuqinë e tij.

Të rinjtë duhet të kryejnë edhe adhurimet që u takojnë edhe mësimet të mos i lënë mënjane. Në të njëjtën kohë të vijnë rrugën e shërbimit. Të bëhen të përshtatshëm dhe të pajtueshëm. Të përpiqen të kenë një moral shembullor. Në Islam nuk ka urrejtje dhe zili. Nëse u kushtojmë kujdes këtyre elementeve do të jemi të suksesshëm.

Qëlloni këtu

Dhun-Nun egjiptiani, ilustroi me një parabolë mënyrën përmes së cilës shkëputeste dijen e mbyllur nëpër hieroglifë.

Ishte një statujë, me origjinë të panjohur, e cila në gishtin tregues që e mbante të drejtuar kishte të shkruara këto fjalë: "Qëlloni këtu e do të gjeni një thesar".

Për breza e breza të tërë njerëzit kishin goditur në pikën ku gjendej mbishkrimi, por statuja ishte prej guri të fortë dhe goditjet e gërricnin vetëm në sipërfaqe, teksa kuptimi i mbishkrimit vijonte të mbetej enigmë.

Një ditë, tamam në mesditë, Dhun-Nun, i përhumbur në kundrimin e statujës, vuri re se hija e gishtit të ndehur, hije që kish kaluar pa rënë në sy për shekuj të tërë, sajonte një vijë në dyshtemenë poshtë.

Mbasi e shënjoj pikën e saktë, siguroi veglat e nevojshme e, duke përdorur një levë arriti ta ngrinte pllakën e dyshtemesë. U hap një boshllëk që mundësonte hyrjen në një mjedis të nëndheshëm që përmbante objekte të çuditshme për punime të holla. Duke i vëzhguar, arriti të kuptonte shkencën e përdorur për realizimin e tyre -shkencë e humbur prej shumë kohësh- dhe të vihej në zotërim të atyre thesareve si dhe të tjerave më të zakonshme, që gjendeshin në atë guvë.

* * *

Thuhet se kjo rrëfenjë është transmetuar nga kalifi Ebu-Bekr, vdekur më 634.

Ata që mbërrijnë qëllimin

Imami El-Ghazzali na sjell një episod nga jeta e Isa ibn Merjem, i cili është ruajtur nga tradita.

Një ditë Isai pa një grup njerëzish me pamje të brenqosur, ulur mbi një mur buzë rrugës.

- Cili është shkaku i brenqosjes suaj?- i pyeti ata.

- Është frika nga xhehnemi që na ka katandisur në këtë gjendje, - u përgjigjën ata.

Ai vazhdoi rrugën, e shumë shpejt takoi një tjetër grup njerëzish me pamje të pikëlluar, secili i tkurrur në trishtimin e vet.

- Cili është shkaku i pikëllimit tuaj?- i pyeti ata.

- Është dëshira për parajsën ajo që na ka katandisur kështu - u përgjigjën.

Ai vazhdoi rrugën, deri sa kaloi pranë një grupi të tretë njerëzish që dukej se kishin vuajtur shumë, por që fytyrat u vezullonin nga hareja.

Isai i pyeti:

- Cila është arsyeja e gjendjes suaj?

Ata u përgjigjën:

- Fryma e së Vërtetës. Kemi parë Realitetin dhe kjo na ka bërë t'i harrojmë qëllimet që janë më pak të rëndësishme.

Atëherë Isai tha:

- Këta janë njerëzit që e arrijnë qëllimin. Në Ditën e Gjykimit, do të jenë pikërisht këta që do të gjenden në praninë e Zotit.

* * *

Ata që besojnë se përparimi shpirtëror varet vetëm nga këmbëngulja në çështjet e shpërblimit dhe të ndëshkimit, kanë mbetur shpeshherë të befasuar nga kjo traditë sufi që lidhet me Isain. Për Sufinjtë, një ngulmim i tepruar mbi idenë e fitimit a të humbjes, mund të jetë përfituese vetëm për disa e, gjithsesi, përfaqëson vetëm një pamje të përvojave dhe arritshmërisë së njeriut.

Përktheu: Shpëtim Kelmendi



MES STEREOTIPEVE, DISKRIMINIMIT DHE TË VËRTETËS SË BESIMIT

Suela Dibra (Kaca)

Kur filloj të kujtoj mësimet e para mbi Islamin, më vjen ndërmend imazhi i gjyshes sime duke pëshpëritur sure dhe dua të ndryshme që në atë kohë nuk i kuptoja, por që janë momentet dhe kujtimet e para në mësimin e fesë. Me imazhin e saj, fillova të njihesha më shumë me fenë. Pas disa vitesh mësimi mbi Islamin dhe pas një periudhe reflektimi, më lindi dëshira të mbaja mbulesën Islame.

Ishte viti 1997, kur vendosa të mbulohesha dhe në atë kohë ishin të rralla vajzat mbuluara. Më kujtohen prindërit e mi në përpjekjet e tyre që të më bënin të kuptoja rëndësinë dhe vështirësitë e një vendimi të tillë. Diskutuam shumë dhe jam me fat që, megjithë dilemat dhe pasiguritë e tyre në lidhje me këtë vendim timin, në asnjë moment dhe në asnjë mënyrë nuk u bënë pengesë për mua, por më përkrahën dhe u përpoqën bashkë me mua në përballjet me mentalitetin e kohës. Mbasi ishin vitet e para të rigjallërimit të besimit pas periudhës komuniste, mbase ishin të kuptueshme edhe reagimet e ndryshme të njerëzve rreth çështjes së mbulesës. E them këtë duke pasur parasysh propagandën që bëhej në kohën e komunizmit për çrrënjosjen e çdo bindjeje fetare dhe nga moskuptimi, keqinterpretimi dhe mosnjohja e mirë e fesë, kishe rastin të përballjes me gjykimet e paragjykimet në drejtim të Islamit në përgjithësi dhe veshjes islame në veçanti.

Sot jemi në fillimvitin 2011 dhe me keqardhje mund të them se gjërat nuk kanë ndryshuar për mirë. Si tani, si para 14 vitesh, akoma përballemi me keqkuptime në lidhje me Islamin, myslimanët dhe femrën myslimane në veçanti. Bota myslimane shihet si një univers statik, në të cilin dyert e ndryshimit dhe progresit shoqëror janë mbyllur, për shkak të faktorëve fetarë. Gjithçka interpretohet dhe shpjegohet jo si rezultat i situatave politike ose social-ekonomike, por si pasojë e vetë Islamit. Kjo ndodh, sepse ata gjykojnë vetëm nga përkatësia e tyre fetare. Ndërsa përkatësia e tyre historike, gjeografike dhe sociale lihen mënjanë, qëllimisht.

Kohët e fundit, femra myslimane tek ne dhe në shumë vende të botës është bërë objekt diskutimesh dhe debatesh të ndryshme. Myslimanja e sotme, në sytë e të tjerëve, është një individ që vuan nga shtypja dhe nënshtrimi. Vetëm mbulesa, tërheqja nga bota dhe marginalizimi simbolizojnë myslimanen në sytë e tyre. Përceptimi sipërfaqësor se femra e mbuluar është e shtypur, ndërsa e zbuluara është e lirë, dominon në prezantimin e myslimanës në media.

Ky interpretim është kontradiktor, sepse me gjithë diskriminimin dhe marginalizimin, shumë femra me vullnetin e tyre të lirë zgjedhin Islamin dhe normat e tij. Studimet sociologjike tregojnë se vajzat e mbuluara

kanë arsyet e tyre nga më të ndryshmet, për të cilat pranojnë të jetojnë islamin, e prej këtu edhe të mbulohen. Megjithë këtë realitet krejt të ndryshëm, mbulesa akoma vazhdon të shihet vetëm si një përgjigje ndaj seksualitetit, një mjet shtypjeje dhe një shenjë e superioritetit mashkullor.

Myslimanja e sotme shihet si pasive, viktimë dhe e mbuluar. Shihet si pasive, pasi femra myslimane nuk shihet të ndërmarrë iniciativa të lidhura me punën, apo diçka tjetër që të tërheqë vëmendjen e opinionit mediatik. Ajo rrallë është burim informacioni rreth ngjarjeve kryesore në komunitetin e saj. Më tepër paraqitet si vëzhguese sesa si pjesëmarrëse aktive dhe kjo, jo vetëm për fajin e saj.

Nuk e vë në dyshim se ka shumë femra myslimane, të cilat përpiqen të shkruajnë nëpër editoriale apo në forume të ndryshme, por ato mungojnë në mediat vizive. Femrat myslimane të edukuara shkruajnë, flasin dhe edukojnë breza, por rrallë i shohim të marrin pjesë në panele televizive.

Të gjitha këto epitete të pabaza që shoqërojnë femrën myslimane në sytë e të tjerëve, reflektohen në mohimin e shumë të drejtave të tyre sot edhe në Shqipëri, si në arsimim, punësim, dhe vendim-marrje.

Në këtë mënyrë, myslimania vetëm me veshjen që mban, paraqet një kërcënim të vazhdueshëm për shoqërinë, por të gjithë mund ta kuptojmë se ajo që e dallon të prapambeturën nga femra bashkëkohore nuk është dukja e jashtme, por formimi dhe edukimi.

Historia Islame nuk lë vend për perceptime të tilla. Nëse i hedh një sy asaj, e kupton se pjesëmarrja e femrave në jetën shoqërore dhe politike të Islamit është shumë e rëndësishme. Nuk janë të rralla femrat e njohura, dijetare të fushave të ndryshme nga të cilat merrnin mësim edhe burrat, siç është rasti i juristes Amara bint Er-Rahman dhe shumë femrave të tjera, duke filluar nga Aishja, gruaja e Profetit (a.s.). Pata lexuar para disa kohësh se një numërim konservativ do të nxirrte në pah, së paku 2500 gra juriste me njohuri të jashtëzakoshme, transmetuese hadithesh dhe poete të shkëlqyera përgjatë historisë Islame. Ndërsa diçka të tillë nuk e gjen në kulturat greke dhe ato romake që i paraprijnë qytetërit Islam.


Sot, fatkeqësisht, të pakta janë femrat myslimane të dalluara në fusha të ndryshme. Si mund të kemi shumë të tilla, kur ua mohojmë të drejtën e mësim, të drejtën e studimit dhe të punës?! Mënyra më e mirë për t'i dhënë një mundësi femrës myslimane është të mbështeturit në parimin bazë të pluralizmit: *të kemi respekt për të ndryshmen*. Nuk është e domosdoshme të pëlqehet “mbulesa” për të mbrojtur të drejtat e atyre që e pëlqejnë. Shenja e vërtetë dalluese e një shoqërie të civilizuar është mbrojtja e të drejtave të të tjerëve, jo vetëm kur na pëlqejnë zgjedhjet e tyre, por edhe kur nuk pajtohemi me to. Pluralizmi kulturor bazohet në pranimin e “tjetrit” siç është dhe jo si do të donim të ishte.

Mendoj se mungesa e femrës myslimane në jetën publike vjen edhe si pasojë e shtrembërimeve të mësimave të Islamit nga njerëz të keqinformuar në lidhje me fenë që mendojnë se vendi i femrës duhet të jetë shtëpia, si nënë dhe edukuese e fëmijëve. Nuk mund të përkrahet ky mendim, kur parimet Islame flasin ndryshe. Po përmend një shembull të vetëm: Hazreti Omeri ia kishte besuar mbikëqyrjen e tregut të Medines Shafa bint Abdullahut. Historia islame është e mbushur plot me figura të shquara femrash që u kanë dhënë mësim juristëve në zë. Ato nuk hezituan të diskutonin dhe të debatonin edhe në audienca të ndryshme.

Detyra e femrës së sotme myslimane është që të zbatojë praktikën më të mira të zhvillimit njerëzor, të ruhet nga shtrembërimet e parimeve Islame që bien ndesh me Kuranin dhe traditën profetike dhe të qëndrojë larg tendencave ekstremiste që vijnë si rezultat i injorancës ose keqinterpretimit të burimeve kryesore të Islamit: **“...kur të vendosësh, atëherë mbështetu në Allahun...”** (Ali Imran, 159)

Femra myslimane duhet të ecë në jetë me krenari, duke ditur se kërkesa për dinjitet, demokraci dhe të drejta njerëzore, për pjesëmarrje në çështjet politike dhe shoqërore të vendit është pjesë e traditës islame dhe për këtë ka mjaft evidencë në historinë e fesë së cilës ajo i përket.

Problemet me të cilat ballafaqohet islami dhe femra myslimane në veçanti, nuk do të ndërpriten derisa të zgjahemi dhe të flakim tutje pasivitetin që na ka mbërthyer: **“Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ai ta ndryshojë gjendjen e vet.”** (Er-rad, 11)



Një Ajet

*Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!*

“O bijtë e Ademit, Ne ju dërguam rroba që të mbuloni vendet e turpshme, si edhe për zbulurim; por, petku i devotshmërisë është më i miri...” (A’rafë / 26)

Veprimi i parë që ndërmori shejtani kundër Ademit (a.s.) dhe bashkëshortes së tij Havasë e, për pasojë, kundër gjithë njerëzimit, ishte shfaqja e lakuriqësisë. Pra synimi kryesor i shejtanit në tokë është shfaqja e lakuriqësisë, nëpërmjet së cilës do të arrijë t’u hapë rrugë sjelljeve të ndryshme perverse dhe po në këtë mënyrë do të pengojë përsëri rikthimin në xhenet. Ndaj përpjekjeve të shejtanit për ta futur në kurth njeriun, Allahu e urdhëroi atë të vishej me rroba që mbulojnë lakuriqësinë dhe njëkohësisht e zbukurojnë atë.

Veshja është konsideruar që në fillimet e historisë së njerëzimit si një domosdoshmëri qytetare. Siç shërben për të mbuluar pjesët e turpshme dhe për t’u dukur hijshëm, veshja kryen edhe funksionin e ruajtjes së trupit nga të ftohtit ose të nxehtit. Allahu na informon gjithashtu se petku i devotshmërisë është petku më i hijshëm. Allahu në këtë ajet e ka krahasuar devotshmërinë me një rrobë që mbulon dhe ruan zemrën e besimtarit nga ndotja.

Ekziston një lidhje ndërmjet petkut të trupit dhe petkut të devotshmërisë. Ndërsa njëri shërben për të mbuluar dhe ruajtur trupin, tjetri shërben për të ruajtur zemrën. Të dyja këto mbulesa plotësojnë njëra-tjetrën, sepse petku i devotshmërisë përfshin bindjen ndaj Allahut, dashurinë për të dhe ndjenjën e turpër. Shkurtimisht është ruajtja e vetes nga çdo lloj ndotjeje shpirtërore apo materiale.

Zotërimi i këtyre cilësive shpie në mbulimin e pjesëve të obliguara për t’u mbuluar, kurse ata që njollosin mbulesën e devotshmërisë, sado që të mbulohen, nuk shpëtojnë dot nga kthetrat e shejtanit. Petku, me të cilin ishin mbuluar Ademi dhe Havaja në xhenet, ra vetëm kur këta përdhosën petkun e devotshmërisë. Ademi (a.s.) dhe bashkëshortja e tij, me ngrënien e pemës së ndalur përdhosën petkun e devotshmërisë dhe, për pasojë, iu shfaq lakuriqësia. Por gjithashtu edhe petku i trupit luan rolin e një mburoje për petkun e devocionit. Kjo është arsyeja që janë përmendur paralelisht në ajetin kuranor.

Nga ajeti del qartë që petku i devocionit është më i mirë se petku i veshjes, sepse devotshmëria na mbron nga dënimi i Allahut. Ky ajet është një nga argumentet e Allahut për të kuptuar që ne jemi qenie materiale dhe shpirtërore. Siç shfaqet lakuriqësia materiale, kur heqim rrobat, ndodh edhe zhveshja e vlerave nga mungesa e devotshmërisë.

Një Hadith

*Transmetohet nga Ebu Hurejra se
Pejgamberi (a.s.), ka thënë:*



“Dy grupe nga banorët e xhehenemit akoma nuk i kam parë. Disa njerëz që mbajnë në duar kamxhikë si bishtat e lopëve, me të cilët godasin njerëzit dhe disa femra (që duken si) të veshura dhe (në të vërtetë janë) të zhveshura...”

Muhamedi (a.s.), përkufizon dy grupe njerëzish që kanë qenë të panjohur në kohën e tij, por që janë të pranishëm në kohën tonë. Dijetarët e kanë konsideruar shfaqjen e këtyre dy grupeve ndër shenjat e vogla të kijametit. Pika e përbashkët e këtyre dy grupeve është të mosqenët prej banorëve të xhenetit.

Në grupin e parë futen të gjithë personat që marrin pjesë në goditjen e njerëzve apo që përgatisin ekipe të veçanta për të rrahur njerëzit pa të drejtë, vetëm për të mbrojtur interesat e veta.

Përsa i përket grupit të dytë, “femra të veshura, por të zhveshura”, dijetarët kanë bërë interpretime të ndryshme, duke marrë parasysh kushtet e kohës në të cilën kanë jetuar. Një grup e ka interpretuar si, “megjithëse notojnë në begatitë e Allahut, nuk e falënderojnë atë” apo “të veshura me rroba, por të zhveshura nga petku i dovocionit”. Më vonë u interpretua si “pjesërisht të veshura pjesërisht të zhveshura, që përpiqen të shfaqin bukuritë fizike”. Pastaj u interpretua si, “të veshura, por me rroba të holla që nuk mbulojnë linjat e trupit”. Duke parë realitetin e sotëm, nuk ndihet fare nevoja për interpretim, sepse çdo gjë është shumë e qartë. Dhe ky hadith është një mrekulli, sepse lajmëron në lidhje me diçka që i përkiste së ardhmes.

Megjithatë, imam Tibini (1277) ka bërë një interpretim që është i vlefshëm për të gjitha kohërat. Ai thotë: “Pejgamberi (a.s.), në hadith thekson se gratë janë të veshura, mandej të zbuluara. Pra, Pejgamberi (a.s.), nuk e mohon që janë të veshura, por refuzon mënyrën e veshjes. Sepse qëllimi kryesor i veshjes në islam është mbulimi i pjesëve të turpshme dhe veshja që nuk e përmbush këtë mision nuk quhet mbulim. Për këtë arsye, të gjitha “gratë e veshura, por jo të mbuluara”, përfshihen në këtë hadith.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Nuk do të hyjë në xhenet kush rreh njerëzit pa të drejtë dhe gratë që, megjithëse janë të veshura, në të vërtetë janë të zhveshura.
2. Shfaqja e këtyre dy dukurive është nga shenjat e vogla të kijametit.
3. Për të ndaluar degjenerimin e familjes fillimisht, pastaj të të gjithë shoqërisë, duhen formuar breza me identitet të gjallë fetar.

Toleranca dhe durimi ndaj të paditurve dhe nopranëve

Në perceptimin e njeriut, e mira dhe e keqja, e vërteta dhe e pavërteta, e drejta dhe e shtrembëra, qartësohet në sajë të shembujve të ndryshëm. Miqtë e Hakut, që jetojnë në atmosferën e Kuranit dhe Sunetit, janë për ne tregues konkretë, pra janë një shembull i gjallë në sytë tanë. Gjendjen tonë duhet ta përputhim me gjendjet e tyre, duhet të përpiqemi të mbushemi me energji shpirtërore si ata.

Trashëgimtarët e Pejgamberëve, pra Miqtë e Hakut, janë kulminacione përsosmërie, veprimi dhe udhëzimi, të shtrira në kohë të ndryshme. Për ata që nuk kanë pasur mundësi të shohin Pejgamberin dhe sahabët e tij, janë personalitete të fuqishme për t'u marrë shembull. Këshillat dhe udhëzimet e tyre, që me gjuhën e mëshirës gjallërojnë shpirtin, janë vesa shpirtërore, të ardhura nga burime profetike.

Një tipar dallues i miqve të Hakut është shprehja e

durimit ndaj vuajtjeve dhe ezgjeteve që u sjellin injorantët, nopranët, kabahët e megjithatë, qëndrimi në mesin e njerëzve për t'i udhëzuar ata.

Si në çdo gjë edhe në lidhje me mësimin e këtij virtyti, mund të themi se shkolla më e mirë është personaliteti i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

DURIMI DHE QENDRESA E PEJGAMBERIT

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, që u dërgua si shembull për tërë njerëzimin, kaloi shumë vuajtje dhe mundime. Ai ka thënë: *"...Në rrugën e Allahut jam sprovuar më shumë se askush tjetër me vuajtje e mundime."* (Tirmidhi, Kijamet, 34/2472)

Ai asnjëherë nuk u thye dhe nuk u mërzi nga vuajtjet dhe mundimet që hasi gjatë rrugës për të fituar pëlqimin e Allahut të Lartmadhëruar. Zemra e tij e ndjeshme dhe delikate vetëm këtë kërkonte. Nëse Ai shprehte pëlqimin ndaj tij, për të vuajtjet dhe mundimet që i sillnin gjërat e fundme kishin krejt pak rëndësi. Në një ajet të Kuranit thuhet:

"Mos i dëgjo mohuesit dhe hipokritët! Mos i përfill fyerjet e tyre dhe mbështetu tek Allahu; Allahu mjafton për mbrojtës." (el-Ahzab, 48)

Aftësia që kishte Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, për të përballuar me sukses vuajtjet dhe mundimet që i sillnin njerëzit injorantë, ishte njëra nga cilësitë profetike të paralajmëruara edhe nga librat e shenjtë të shpallur më parë. Njëri nga dijetarët më në zë hebre, Zejd bin Sa'ne, e kishte lexuar këtë të vërtetë. Sa herë që e shihte Pejgamberin, sal-lall-llahu

**“Mos i dëgjo mohuesit
dhe hipokritët! Mos i përfill
fyerjet e tyre dhe mbështetu
tek Allahu; Allahu mjafton
për mbrojtës.”**

(Ahzab, 48)

alejhi ve sel-lem, vërente të gjitha cilësitë e një pejgamberi të paralajmëruar. Një ditë ai e vuri Pejgamberin në provë për të parë nëse ai i falte me të vërtetë ata që silleshin në mënyrë të ashpër dhe injorante me të dhe nëse i rritej toleranca dhe butësia në raport të drejtë me sjelljet kabahe dhe të ulëta që atij i bënin. Pasi vërejti këto vlera të mishëruara tek i Dërguari i Allahut, hyri në fenë islame i bindur tërësisht. (Shih Hakim, III, 700/6547)

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, toleronte jo vetëm sjelljet brutale të jobesimtarëve dhe të hipokritëve, por edhe sjelljet e papjekura të myslimanëve, të cilët akoma nuk e kishin konceptuar politesën, edukatën dhe delikatesën islame. Një beduin e thirri disa herë Pejgamberin në mënyrë të vrazhdë e duke bërtitur, kështu:

- *O Muhamed, o Muhamed!*

Ndërsa Pejgamberi i ktheu disa herë në mënyrë të ngrohtë e njerëzore këtë përgjigje:

- *Urdhëroni, çfarë dëshironi? - duke mos ia lejuar vetes të shkelte asnjëherë rregullat e mirësjelljes.*¹

Një herë tjetër nga shkretëtirat erdhi një beduin dhe prishi abdestin brenda në xhaminë e Resultit. Të gjithë sahabët filluan ta qortonin ashpër, ndërsa Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, u tha:

- *Lëreni në terezinë e vet atë. Aty ku ai prishi abdestin hidhni një kovë ujë. Lehtësoni dhe mos vështirësoni.* (Buhari, Vudu 58, Edeb 80)

Kjo gjendje mëshire e Pejgamberit, sal-lall-llahu

alejhi ve sel-lem, mbolli farën e besimit dhe udhëzimit tek shumë njerëz. Në një ajet kuranor thuhet:

“Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin dhe kërkoji falje Allahut për ata...” (Al-i Imran, 159)

Pejgamberi përballoi çdo vuajtje, madje edhe kur po përjetonte suksesin e kauzës së tij e, kur gjithashtu Allahu i Lartmadhëruar u dha fuqi dhe fitore myslimanëve, ai kurrë nuk mendoi të tërhiqej në vetminë e tij për t’u larguar nga shqetësimet dhe vuajtjet që mund t’i shkaktonin njerëzit.

Një ditë teksa Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ishte ulur në gjunjë e po hante së bashku me sahabët e tij, erdhi një beduin. Ai u habit nga qëndrimi aq delikat dhe me edukatë i Pejgamberit dhe me habi u shpreh:


- Sa i çuditshëm dhe i ndryshëm po më duket ky qëndrimi yt krah për krah me të tjerët!

I Dërguari i Allahut të Lartmadhëruar u shpreh:

- *Allahu i Lartmadhëruar më krijoi mua me moral të lartë e të bukur, e jo inatçi dhe tiran.* (Ebu Davud, Et’ime, 17/3773)

Kështu, Pejgamberi, që me shpirtin e tij të hollë dhe të ndjeshëm u bë shembulli i të gjithë njerëzimit në politesë, edukatë dhe finesë, theksoi faktin se të qenët inatçi dhe tiran nuk ka asnjë lidhje me karakterin e një besimtari të sinqertë.

Xhaxhai i Pejgamberit, Abbasi (r.a.), ndihej keq prej



faktit se nipi i tij i dashur po vuante kaq shumë nga njerëzit me të cilët ai kishte të bënte. Dëshironte që Pejgamberi të ngjitej në një post të lartë, në mënyrë që të evitoheshin një pjesë e këtyre vuajtjeve dhe mundimeve. Ndërsa Pejgamberi, alejhis-salatu ves-selam, i qe shprehur:

- Jo! Unë do të qëndroj në mesin e tyre derisa Allahu i Lartmadhëruar të më marrë afër Tij. Le të më shkelin këmbët, le të më tërheqin rrobat, le të më shqetësojnë me pluhurin që bëjnë për të më marrë frymën! (Ibn-i Sa'd, II, 193; Hejthemi, IX, 21)

Ai u tërhoqi vëmendjen besimtarëve kështu:

"Një mysliman që përfshihet me të tjerët, duke hequr vuajtjet që i shkaktohen nga ata, është më i mirë se besimtari që preferon vetminë për të mos u përballur me mundimet që i nxjerrin të tjerët." (Tirmidhi, Kijamet, 55/2507)

Sa bukur shprehet Mevlana kur thotë:

"Mosikja e hënës nga errësira, pra durimi që shfaq ajo, e shëndrit dhe e shkëlqen atë. Shoqërimi i trëndafilit me gjembin, pra durimi që ai shfaq, i jep atij erë të këndshme e ngjyrë shumë të bukur."

"Durimi dhe përballimi me qetësi e sukses i vuajtjeve dhe mundimeve nga Pejgamberët i bëri ata miq të Hakut dhe në aspektin shpirtëror mbretër të fitoreve dhe suksesit."

"Nëse do të dish ta jetosh bukur durimin, ai do të të bëhet krah, do të fluturosh lartësish të pafund!"



Shiko Hazreti Mustafanë! Durimi atij iu bë Burak, Miraxh, Sidre-i Munteha. Durimi e lartësoi përtej qiejve. Bëri të mundur takimin me Zotin e Tij."

Dobësia që Pejgamberi, alejhis-salatu ves-selam, kishte për umetin e tij, e bënte atë të harronte të gjitha vështirësitë që haste në udhëzimin e tyre. Atë nuk e mërziste asnjë gjë në përpjekjen që ai bënte të shpëtonte umetin, nuk ankohej asnjëherë nga mërzitë që i shkaktonin atij. Ai vazhdimisht lutej duke thënë *"umeti im, umeti im"* duke e braktisur çdo lloj rehatie personale.

TOLERANCA DHE DURIMI I MIQVE TË HAKUT

Edhe trashëgimtarët e Pejgamberëve, miqtë e Hakut, nuk u jepnin rëndësi veprimeve të pamatura të njerëve, duke u përfshirë në çdo lloj mundimi e vështirësie për t'i përmirësuar moralisht ata. Tekefundit, kjo gjendje a nuk është kushti i diturisë së vërtetë?

Ashtu siç është shprehur Ibrahim Hakk nga Erzurumi:

"Të pranosh fatkeqësitë, të shprehësh durim ndaj arrogancës, të tregosh maturi në momente tronditjeje, është veçoria e velive."

"Fillimi i diturisë është butësia, ndërsa fillimi i urtësisë është të kaluarit mirë me njerëzit."

Prandaj themi se të shprehësh mosdurim ndaj vuajtjeve që mund të të japin njerëzit dhe të treguarit intolerant ndaj tyre, lidhet me injorancën dhe mungesën e urtësisë. Ashtu siç janë të edukuar e plot

**“Nuk barazohet e mira
me të keqen! Të keqen ktheje
me të mirë e, atëherë armiku
yt do të të bëhet menjëherë
mik i ngushtë.”**

(Fussilet, 34)

politesë njerëzit e ditur, ashtu janë të ashpër, egoistë dhe të paedukatë të paditurit. Të jesh i painformuar dhe symbyllur ndaj edukatës fetare është injoranca më e madhe. A nuk është edukata njëra nga tiparet dalluese shpirtërore të fesë?! Hazreti Mevlana, në disa vargje të tij shprehet:

“Mendja e pyeti zemrën: ‘Çfarë është imani?’. Zemra u përkul drejt veshit të mendjes dhe i tha: ‘Imani është edep (edukatë)’.”

Ibn Abbasi, (r.a.), kur zbriti ajeti **“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e, atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë.”** (Fussilet, 34), bëri këtë koment:

“Me shprehjen **“të keqen ktheje në të mirë”** synohet durimi në momente nervozizmi dhe të falësh kur të të bëjnë ndonjë të keqe. Kur njerëzit bëjnë këto, atëherë Allahu i Lartmadhëruar i ruan ata, madje edhe armiqtë e tyre do t’i përulen në shenjë respekti e miqësie”. (Buhari, Tefsir, 41/1)

Ndërsa Enes bin Maliku, (r.a.), duke komentuar ajetin **“...e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë.”** (Fussilet, 34) ka thënë:

- Ai është aq njeri i edukuar dhe i kujdesshëm, sa që kur një njeri tjetër i thotë ndonjë fjalë të keqe, ai i thotë: “Nëse thua të vërtetën Allahu më faltë, e nëse gënjen atëherë të faltë ty!”

Allahu i Lartmadhëruar, në Kuran ka thënë:

**“Robërit e të Gjithmëshirshmit janë ata që ecin
thjesht nëpër tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë**

me fjalë, ata përgjigjen: “Paqe qoftë!”” (el-Furkan, 63)

Miqtë e Allahut nuk u japin shumë rëndësi fjalëve të injorantëve, prandaj nuk hyjnë fare në debate me ta. E dinë se debati mund t’u zgjojë të keqen dhe inatin atyre e kështu situata mund të përkeqësohet edhe më.

Në lidhje me këtë temë Hazreti Aliu na këshillon:

- *Mos mendo t’i kthesh xhevap një fjale të thënë me injorancë e pavetëdije!...Sepse personi që e ka thënë atë fjalë a shprehje ka edhe shumë fjalë a shprehje të ngjashme me të. Menjëherë, pas xhevapit tënd, do të të thotë një tjetër. Mos bëj kurrë shaka me injorantët!..Prej se ata kanë gjuhën me zehër, e ta helmojnë zemrën.*

Hazreti Mevlana shprehet:

- *Pranë xhahilëve hesht si një libër!*

- *Personi me moral të mirë është ai që duron thashethemet e njerëzve, ai që sillet si i verbër dhe i shurdhër ndaj të keqes së njerëzve.*

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na ka informuar për moralin e bukur të njerit prej miqve të Allahut, duke u thënë një ditë sahabëve:

- *A nuk mundet njëri prej jush të jetë si Ebu Damdam?*

Sahabët të çuditur, pyetën:

- Kush është Ebu Damdam o i Dërguari i Allahut?

Pejgamberi iu përgjigj:

-Njëri prej pjesëtarëve të umeteve që kanë ardhur para jush. Ai thoshte: "Unë ia bëj hallall çdo njeriu që më ka ofenduar dhe që më ka përgojuar." (Ebû Davûd, Edeb, 36/4887)

Sa horizont madhështor shpirtëror... Dashuria e pafundme për Allahun e Lartmadhëruar sjell tek njeriu mëshirë, dhembshuri, falje dhe tolerancë. Miqtë e Hakut nuk dëshirojnë të bëhen shkak që njerëzit në botën tjetër të përjetojnë vështirësi. Ata shpresojnë që të gjithë njerëzit, si krijesa të të njëjtit Zot, të arrijnë Mëshirën Hyjnore.

Imam Gazaliu, për të treguar vlerën e madhe që ka përfshirja në mërzitë dhe hallet e njerëzve tregon:

Një dijetar kishte shkruar 360 vepra në lidhje me diturinë. Ai mendonte se kështu ishte lartësuar shpirtërisht dhe se ishte bërë mik i Hakut. Allahu i Lartmadhëruar i shpalli këtë mesazh pejgamberit të asaj kohe:

-Thuaji filanit që edhe pse ai ka bërë shumë vepra të mira, Unë asnjërin prej tyre nuk ia kam pranuar!

Pas kësaj, ky njeri u tërhoq në një shpellë. Atje, i vetmuar, i falej ditë e natë vetëm Zotit. Kështu ai mendonte me vete se tani ia kishte arritur qëllimit për të fituar kënaqësinë e Allahut të Lartmadhëruar. Sërisht pejgamberit të kohës, Allahu i Lartmadhëruar i shpalli këtë mesazh:

-Thuaji atij: "Pa hyrë në mesin e njerëzve dhe pa duruar vështirësitë dhe mërzitë e tyre, nuk do të arrish të fitosh kënaqësinë Time".

**"Betohem në Zotin
Fuqiplotë, se ai
që nuk ka durim,
edhe nëse hyn në vrimën
e miut, nuk do të shpëtojë
nga kthetrat e maces."**

Me ta dëgjuar këtë, personi në fjalë doli në çarshi dhe u përfshi në mesin e njerëzve. Ecte, ulej, hante dhe pinte me ta.

Atëherë Allahu i shpalli pejgamberit të Tij:

- Lajmëroje atë besimtar. Tashti ai arriti të fitojë kënaqësinë Time të plotë. (Ihja, II, 610-611)

Në tasavvuf, edhe pse është parë si i përshtatshëm për përsosjen shpirtërore të njeriut asketizimi periudhor, asnjëherë nuk është këshilluar dhe preferuar, madje është ndaluar asketizmi apo murgëria si stil i vazhdueshëm jete. Duke qenë në hallk, të jesh i aftë të vazhdosh robërinë ndaj Hakut, thënë ndryshe në formë parimi sufi **"Të jesh së jashtmi në mesin e hallkut e së brendshmi i shkrirë tërësisht në qenien e Hakut"**. Në një formë tjetër kjo mund të shprehet edhe **"Njësia në shumësi"**, pra që në mesin e kallaballëkut të jesh me të Vetmin e me më të Madhin. Padyshim, kjo gradë tregon edhe nivelin shumë të lartë të robërisë së besimtarit ndaj Allahut. Është bërë shumë e njohur shprehja **"Dora në qar e zemra në Jar"** (tek i Dashuri, në rastin konkret tek Zoti), e cila tregon më së miri se të qenët në mesin e njerëzve nuk është pengesë që njeriu të jetë i murgëruar shpirtërisht tek Krijuesi i tij.

Poeti i madh Mevlana shprehet:

- Asnjë qoshe e dynjasë nuk është pa kurthe e pa pasione. Nuk ka asnjë shpëtim, qetësi e rehati tjetër, veçse të gjeturit e Hakut në zemër, të mbështeturit tek Ai dhe të jetuarit shpirtërisht së bashku me Të.

- Betohem në Zotin Fuqiplotë, se ai që nuk ka durim,



edhe nëse hyn në vrimën e miut, nuk do të shpëtojë nga kthetrat e maces.

Ja një tregim i Muhamed Ikbali:

Një kaproll i paditur po i qahej një kaprolli të urtë:

- Kam vendosur, ditët që më kanë mbetur, t'i jetoj në zonën më të sigurtë të botës, aty ku nuk lejohet gjuetia, pra në Qabe, në zonën e Haremit. Në fusha, gjuetarët na kanë ngritur pusi e kurthe për të na zënë. Tashmë e kam të nevojshme të ndihem i shpëtuar nga çdo kurth gjuetarësh. Dëshiroj të bëj një jetë krejt të qetë...

Kaprolli me shumë përvojë iu drejtua bashkëbiseduesit:

- O miku im i zgjuar! Nëse kërkon të jetosh, mos i ik rrezikut. Mprehe veten me rrezikun. Bëhu më i mprehtë se shpata. Niveli i besimit shihet përballë vështirësive të jetës. Vështirësitë të vënë në provë forcën tënde. Ato të tregojnë se çfarë takati ka shpirti e trupi yt.

Një cilësi tjetër e miqve të Hakut është edhe prirja e tyre e natyrshme për të zgjedhur të jenë të dhunuar e jo dhunues, në raste kur janë të imponuar nga rrethana të caktuara të zgjedhin njërën nga të dyja.

Kur Sa'd Bin Vekkasi i bëri këtë pyetje të Dërguarit të Allahut:

- O Resulullah! Nëse në kohë fitnesh (ngatërresash, përçarjesh e intrigash), dikush hyn në shtëpinë time dhe më kërcënon me vrasje çfarë më këshillon të bëj?"

Ai iu përgjigj:

-Bëj ashtu siç bëri djali i Ademit (Habili). (Tirmidhi, Fiten, 29/2194)

Me fjalë të tjera kjo veçori mund të shprehet kështu **"Të durosh shqetësimet, problemet dhe fatkeqësitë që mund të të vijnë nga njerëzit, por ama vetëm për hatër të Allahut"**.

Sa domethënës është rasti i njërit prej miqve të Hakut, Hazreti Maruf-i Kerhit:

Hazreti Maruf-i Kerhi mori në shtëpinë e tij një të sëmurë, që po shkonte drejt vdekjes, për t'i bërë hyzmet. I sëmuri, nga dhembjet e mëdha që kishte, nuk flinte asnjë moment. Thërriste dhe bërtiste aq shumë, sa nuk linte të flinte askënd. Sëmundja i rëndohej dita-ditës e, bashkë me të, rëndohej edhe i sëmuri. Përditë e më tepër ai bëhej edhe më i padurueshëm. Pjesëtarët e familjes në fjalë filluan të largoheshin me radhë e ta shtynin përkohësisht jetën diku tjetër. Në shtëpi mbetën burrë e grua, të vetëm. Hazreti Maruf-i Kerhi nuk flinte as natën për t'ia përm-bushur sa më mirë të gjitha nevojat të sëmurit. Mirëpo një ditë, prej pagjumësisë së theksuar, ai, në mënyrë të pavetëdijshme, kotet pak. Pasi i sëmuri mosmirënjohës e pa tek dremiste Maruf-i Kerhin, të cilit i ishte aq borxhli, i tha në mënyrë arrogante:

- Çfarë besimtari qenke ti! Njerëzit si ti kështu janë në fakt! Kanë shumë emër e nam tek njerëzit, por në të vërtetë janë hipokritë. Urdhërojnë të tjerët për devotshmëri, ndërsa për vete nuk bëjnë asgjë. Si ka mundësi që ti fle, kur e



shih që unë nuk vë gjumë në sy për asnjë minutë? E si mundet një njeri që e mbush mirë barkun e që, gjithashtu fle, t'ia dijë hallin të sëmurit!..

Maruf-i Kerhi sërish i duroi edhe këto fjalë që dëgjoi. Gruaja e tij, së cilës i kishte ikur durimi tashmë, i tha që ta largonte nga shtëpia këtë të sëmure kaq mosmirënjohës. Maruf-i Kerhi, duke buzëqeshur iu përgjigj:

- O e dashur! Pse u mërzite ti nga fjalët e të sëmurit? Nëse ai bërtiti, më bërtiti mua. Nëse ai u bë i paedukatë, u bë ndaj meje. Fjalët e tij të rënda, mua më duken të këndshme. A e shih se sa në hall të madh është ai? Nuk ka vënë asnjë minutë gjumë në sy. Ti duhet të dish mirë se marifeti i vërtetë është të tregohesh i mëshirshëm dhe i dhembshur ndaj këtyre njerëzve, duke duruar çdo ezgjet dhe vështirësi që të nxjerrin...

Shejh Saadiu, në veprën e tij të famshme, *Gjylistani dhe Bostani* ka dhënë këtë këshillë:

"Një zemër e mbushur me dashuri, është falëse. Nëse ti je i thatë dhe përbëhesh vetëm nga forma, atëherë së bashku me trupin tënd do të të vdesë edhe emri. Por në qoftë se je bujar dhe u shërbën të tjerëve, do të vazhdojë të jetosh aq sa ke sakrifikuar dhe aq sa ke hyrë në zemrën e njerëzve..."

T'i marrësh lehtë vështirësitë dhe mërzitë që të sjellin të tjerët, t'i durosh dhe t'i përballosh me gjakftohtësi ato, është në interesin shpirtëror të njerëzve të urtë, të cilët arrijnë ta shohin krijimin prej syrit të Krijuesit. Ata që përballë situatave të papëlqyeshme nevrikosen



dhe humbasin toruan, si njerëzit e masave, edhe në qoftë se kanë mbrojtur një të drejtë të tyre, kanë treguar se nuk janë të aftë të zbatojnë parimin e faljes, tolerancës dhe durimit e, kështu kanë humbur mundësinë e përfitimit shpirtëror dhe urtësimin nga sekretet e të sprovuarit nga Allahu i Lartmadhëruar.

Falja, toleranca dhe durimi që u shfaqet krijesave të Allahut të Lartmadhëruar, kanë një vlerë të jashtëzakonshme për të fituar mëshirën, kënaqësinë dhe dashurinë e Krijuesit. Në tasavvuf, tiparet e mësipërme konsiderohen si gjendje shumë të rëndësishme dhe një pasuri e çmueshme. Hazreti Mevlana ka thënë:

"Durimi ndaj të këqinjve për besimtarin është shkak për t'u rritur në grada shpirtërore. Në atë shpirt që ka etje për Hakun mbin e gjallon durimi."

Kjo mënyrë e të sjellurit shpesh është bërë shkak edhe për përmirësimin e njerëzve të paedukuar. Mirëpo, nëse ata nuk përmirësohen, atëherë gjendja e tyre do të përkeqësohet si në aspektin shpirtëror, ashtu edhe në atë material. Asnjëherë nuk duhet harruar se hakun e njerëzve vepërmirë, pra hakun e të dashurve të Zotit, e merr vetë Ai, i Cili i do ata. Kjo ndodhi është shumë interesante:

Një ditë Ibrahim Hakk, që i bënte hyzmet Ismail Fakirullahit, shkon tek një çezmë për të mbushur ujë. Tamam kur po mbushte shtambën me ujë, ia beh një kalorës, i cili, duke bërtitur i tha:

-Hiqmu sysh ore fëmijë i keq!

Ai e nxiti kalin të shkonte tek çezma. Kur Ibrahim po përpiqej të merrte shtambën për t'u larguar, ka-

lorësi i ra kalit me mamuze dhe e zuri fëmijën në një qoshe. Ibrahim Hakk, duke dashur të mbronte veten nga rreziku, lëshoi në mënyrë të pavetëdijshme shtambën nga duart, por ndërkohë, kali shkelmoi shtambën dhe e theu. Ibrahim Hakk erdhi me vrap duke qarë tek mjeshtri i tij dhe ia shpjegoi se çfarë kishte ndodhur. Mësuesi e pyeti:

- A i the gjë kalorësit?

- Jo, asnjë gjë nuk munda t'i them – iu përgjigj nxënësi.

Mjeshtëri e urdhëroi atë:

- Shko menjëherë tek ai dhe thuaja dy-tri fjalë!

Ibrahim Hakk shkoi tek çezma dhe aty gjeti kalorësin tek po kashaiste kalin e tij. Mirëpo nga edukata që kishte marrë, nuk arriti t'i thoshte asgjë. Kur u kthye tek mësuesi i tij, Fakirullahi e pyeti:

- A munde t'i thoshe gjë apo jo?

-Nuk munda t'i thosha gjë. E bëra nijet, por goja nuk m'i nxori dot ato fjalë! - u përgjigj Ibrahim.

Mjeshtri, kësaj here duke bërë titur, i tha nxënësit të tij:

- Shko vrap tek ai njeri dhe thuaj diçka, se përndryshe do të ketë përfundim shumë të keq!

Kësaj here Ibrahim vrapoi i vendosur drejt kalorësit. Kur ç'të shihte! Burri që i kishte thyer shtambën atij, pra kalorësi, qëndronte i pajetë në tokë nga shkelmimi që i kishte bërë kali. Me vrap u kthye tek mjeshtri i tij dhe ia shpjegoi atë çfarë kishte parë. Hazreti Fakirullahu pikëllohet dhe thotë:

- Vaj medet! Një shtambë u bë shkak të vdesë një njeri.

Të pranishmit e tjerë nuk kuptuan asgjë nga këto fjalë, prandaj kërkuan sqarim. Atëherë miku i Hakut, Fakirullahu tha:

-Kalorësi e dhunoi Ibrahim Hakkun. I dhunuari nuk lëshoi asnjë fjalë, prandaj çështja i ka kaluar menjëherë Allahut të Lartmadhëruar. E kështu, Ai e dënoi duke u hakmarrë në emër të të dhunuarit. Sikur Ibrahim t'i thoshte diçka, atëherë do të mbyllej kjo çështje, sepse do të ndaheshin hesapet nëpërmjet fjalëve. Mirëpo Ibrahim preferoi heshtjen e plotë, duke u pozicionuar krejtësisht në rolin e të dhunuarit. Unë

u përpoqa që situata të mos mbërrinte deri këtu, por nuk pata sukses.

*Arifët, që e dinë mirë këtë sekret hyjnor, për të mos u bërë sebeb që të tjerët të dënohen nga Fuqiploti, reagojnë përballë padrejtësive, aq sa të mos bëhen shkak për manifestimin e cilësisë *Xhelal* të Zotit.*

Së fundi, besimtarët e pjekur përpiqen t'i kalojnë me sukses, durim e tolerancë vështirësitë dhe mundimet që duket sikur vijnë nga njerëzit, por që në fakt vijnë si sprovë nga Allahu i Lartmadhëruar. Poeti i shquar Mevlana, ka thënë:

"Mali që ka në thellësinë e tij një meneral me vlerë, bëhet shkret nga goditjet që merr gjatë gërmimeve."

Pema që ka fruta gjuhet. Ashtu siç duhet të jetë e përgatitur për t'u gjuajtur me gurë pema me fruta, ashtu edhe besimtarët e pjekur duhet të jenë të përgatitur për vështirësitë dhe pengesat që do t'u bëjnë injorantët. Për hir të Hakut, të durosh e t'u rezistosh padrejtësive dhe vështirësive që do të të bëjnë njerëzit është një vetëdije e lartë besimi.

Allahu u dhuroftë shpirt-rave tanë shikim të thellë, finesë dhe urtësi! Na ruajtë nga ngacmimet, veprimet kabahe të njerëzve të paditur e nopran si dhe nga mungesa e tyre e maturisë. Na dhëntë aftësinë të jetojmë me mendje të shëndoshë dhe na bëftë të mbërrijmë tek Ai me zemër të pastër!

Amin...

Referenca: 1) Shih Muslim, Nudhur, 8; Ebu Davud, Ejman, 21/3316; Tirmidhi, Zuhd, 50; Ahmed, IV, 239.

Ma. sci. Flamur Sofiu

Transplantimi, mbjellja e organeve të trupit, obduksioni dhe dhënia e gjakut

HYRJE

Është e natyrshme që sheriatu islam t'i përgjigjet çdo kërkesë të kohës. Mendoj se edhe transplantimi dhe mbjellja e organeve është një nga çështjet që duhen shpjeguar sipas sheriatit. Për trajtimin në mënyrë të normuar të kësaj çështjeje nuk kemi tekste (ajete dhe hadithe), pasi është e fusha e ixhtihadit (përpjekje shkencore e juristëve myslimanë), e angazhuar që të japë zgjidhje.

Pa dyshim, një problematikë kaq e ndjeshme kërkon një studim të hollësishëm si në aspektin mjekësor ashtu edhe në atë fetar.

Në parim, dijetarët myslimanë ndahen në dy mendime rreth kësaj çështjeje: disa mendojnë se nuk lejohet, ndërsa të tjerët mendojnë se lejohet, duke plotësuar disa kushte. Para se të hyjmë në shpjegimin e kësaj problematike dua të përcaktoj pikat që do të shtjellohen:

1. Shpjegimi i rëndësisë së transplantimit të organeve si problematikë që kërkon zgjidhje nga jurisprudenca islame.
2. Norma e sheriatit për transplantimin dhe mbjelljen e organeve.
3. Shpjegimet juridike (fetvat) që jepen për çështjen e transplantimit të organeve.
4. Vendimet që kanë marrë këshillat e akademive të Fikhut rreth transplantimit të organeve.

Shpjegimi i rëndësisë së transplantimit të organeve si problematikë që kërkon zgjidhje nga jurisprudenca islame.

Çështja e transplantimit të organeve prej një njeriu të gjallë apo prej një të vdekuri, konsiderohet si një tematikë shumë e rëndësishme e mjekësisë dhe, në të njëjtën kohë, kërkon që juristët myslimanë të mblidhen dhe të angazhohen në shpjegimin e normës fetare islame për këtë çështje.

Kjo teknikë po vjen duke u përhapur gjithnjë e më shumë, duke u realizuar thuajse në çdo kohë dhe rast, si p.sh. transplantimi i kornes së syrit; marrja e gjakut, transplantimi i re-tinës së syrit, transplantimi i zemrës, i veshkave etj.

Të gjitha këto i nxisin juristët myslimanë që ta studiojnë vazhdimisht këtë çështje në mënyrë sa më të hollësishme, me qëllim që të japin një shpjegim juridik islam. Për këtë janë bashkuar akademi juridike islame. Po ashtu shohim se ka edhe studime individuale për t'iu përgjigjur kësaj çështjeje.

NORMA E SHERIATIT PËR TRANSPLANTIMIN DHE MBJELLJEN E ORGANEVE

Mendimi i parë:

Juristët myslimanë, që mendojnë se nuk lejohet të zbatohet fenomeni i transplantimit të organeve, mbështeten në shumë argumente, por ne po përmendim disa prej tyre:

1. Rregulla e shariatit: *“Dëmi nuk eliminohet me dëm”*. Me këtë argumentojnë se, kur personi i dhuron tjetrit ndonjë organ, ai dëmton veten. Atëherë një shfrytëzim i tillë i organit nuk lejohet kurrësi, sepse trupi dhe shëndeti i tij janë të mbrojtur dhe pronë e Krijuesit të Madhërisë.

2. Mbështetja në hadithin e të Dërguarit (s.a.v.s.): *“E ka mallkuar Allahu atë (gruan), e cila i përdor organet e tjetrit (përikat) dhe atë që e kërkon një veprim të tillë”*. Duke u bazuar në këtë thënie të të Dërguarit (s.a.v.s.), këta dijetarë shkojnë edhe me larg dhe mendojnë se nuk lejohet transplantimi edhe nëse nga ky veprim nuk ka dëm dhuruesi.

3. Dijetarët që e ndalojnë transplantimin e organeve mendojnë se një veprim i tillë konsiderohet një lloj masakre dhe krim i hapur.

4. Po ashtu mbështeten në hadithin e të Dërguarit (s.a.v.s.) *“Thyerja e ashtit të të vdekurit është një lloj sikuri t'i thyhej atij kur ishte gjallë”*. Ky hadith, i cili ndalon t'i thyhen eshtrat të vdekurit, nuk lejon këputjen e ndonjë gjymtyre nga njeriu i gjallë.

5. Njeriu, sipas islamit, nuk ka të drejtë juridike e as morale të administrojë atë që nuk është pronë e tij. Gjymtyrët dhe çdo pjesë e trupit të njeriut janë pronë e Krijuesit.

Mendimi i dytë:

Një pjesë e madhe e dijetarëve nuk e ndalojnë transplantimin e organeve, por, edhe pse e lejojnë, ata përcaktojnë kushte dhe parime që duhen respektuar. Mendimin e tyre edhe këta e mbështesin në fakte dhe rregulla juridike islame. Si fakte dhe argumente të tyre do të përmendim:

1. Domosdoshmëria e ruajtjes së jetës së njeriut dhe minimimi i çdo gjëje që e dëmton dhe shkatërron atë. Allahu i Lartësuar për këtë thotë: *“...kush vret ndokënd, që s'ka vrasë njeri ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një*

*jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve....”*¹. Pra, duke u nisur nga parimi që, nëse bëhesh shkaktar që të jetë i gjallë dikush, atëherë lejohet transplantimi i ndonjë organi prej njeriut tek tjetri, por me kusht që dhënësi i organit të mos dëmtohet apo të ketë pengesa në jetën e tij.

2. Sheriati islam ka nxitur dhe vazhdon të nxisë besimtarët që të kërkojnë shërim nga çdo sëmundje dhe është obligim për besimtarët që të kërkojnë dhe studiojnë ilaçin e çdo sëmundjeje. I Dërguari (s.a.v.s.), ka thënë: *“Shërohuni, o ju robërit e Allahut, se Allahu i Lartësuar nuk ka sjellë sëmundje që s'ua ka përcaktuar ilaçin, përveç pleqërisë”*².

3. Prej parimeve dhe synimeve të shariatit është edhe ruajtja e shoqërisë njerëzore nga çdo e keqe dhe sjellja e lumturisë në mesin e saj, si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër. Dhe për ta mbrojtur shoqërinë, duhen realizuar anët e domosdoshme të saj. Ndaj, duke u bazuar në këto parime, lejohet transplantimi i organeve, me kusht që të mos dëmtohet asnjëra palë.

SHPJEGIMET JURIDIKE (FETVAT) QË JEPEN PËR ÇËSHTJEN E TRANSPLANTIMIT TË ORGANEVE

Prej fetvave të para që janë dhënë për këtë çështje është fetvaja e dijetarit Hasen Memunit, më 4 prill 1959, me nr: 1087, ku lejohet transplantimi i syve të të vdekurve tek të gjallët, por kushtëzohet që të jetë marrë leje prej të vdekurve apo të merret leje edhe prej anëtarëve të familjes³.

Me datën 15 Muharrem 1400 (05.12.1979), myftiu Xhadel Hak Alij jep fetva se lejohet transplantimi i organeve, por duke iu përmbajtur disa kushtëzimeve. Fetvaja nr. 1323.

Në vitin 1966 dijetari Ahmed Hurejdi jep fetva se lejohet transplantimi i korneas së syrit nga i vdekuri.

Në vitin 1973 dijetari Muhamed Hatir jep fetva se lejohet marrja e lëkurës së të vdekurit për të shëruar djegien që ka pësuar i gjalli. Fetvaja nr. 1069.

Në vitin 1987 dijetari i mirënjohur prof.dr. Muhamed Seid Ramadan el-Buti, në komisionin e fetvasë në Xhidde, sjell studimin e tij të emëruar: *“Dobia që ka njeriu prej organeve të njeriut tjetër, qoftë nga i gjalli apo nga i vdekuri”*. Ky është i mendimit se lejohet transplantimi i organeve, me kusht që dhuruesi të mos ketë dëme dhe pasoja. Po ashtu, ky dijetar konsideron të lejuar transplantimin e organeve nga të vdekurit dhe nga ata që janë të dënuar me vdekje, por me kusht që të merret leja dhe pëlqimi nga të afërmit e të vdekurit apo të të ekzekutuarit.

1. El-Maide: 32

2. Transmeton Ebu Davudi, Tirmidhiu, Nesaiju, Ibn Maxhe, Ahmedi, Ibn Hibani dhe el-Hakimi.

3. Shiko: Rveista “El-Muxhmiu” nr. 4, 1/150



VENDIMET QË KANË MARRË KËSHILLAT E AKADEMIVE TË FIKHUT RRETH TRANSPLANTIMIT TË ORGANEVE

Fetvaja që dha komisioni i fetvave në Mbretërinë e Jordanisë Hashimite më datën 18.05. 1977, pasi analizoi tematikën e transplantimit të organeve, në mënyrë unanime, solli këtë shpjegim juridik:

Transplantimi i organeve është një çështje që nuk ka qenë prezent në kohën e të Dërguarit (s.a.v.s), dhe as në gjeneratën më të mirë të umetit (selefi salihut), ndaj pikërisht për këtë, nuk ka ndonjë normë të caktuar për këtë çështje dhe nuk ka ndonjë tekst (ajet apo hadith) që lejon apo ndalon transplantimin e organeve nga një person tek tjetri. Qëndrimi ndaj këtij fenomeni merret duke u bazuar në kuptimin e përgjithshëm të rregullave dhe burimeve të shariatit.

Komisioni i fetvave në Mbretërinë e Jordanisë Hashimite mendon se lejohet transplantimi i organeve dhe dhënia e gjakut. Këtë e argumenton me këto fakte:

1. Ruajtja dhe mbrojtja e pesë interesave vitale është obligim i prerë sipas shariatit e prej këtyre pesë interesave vitale është edhe ruajtja e jetës së njeriut. Kjo bëhet duke i shpëtuar ndonjë organ nëpërmjet transplantimit nga i gjalli apo i vdekuri.

2. Mbështetja në shpirtin e shariatit islam dhe në rregullat e përgjithshme si: “Nevoja e jashtëzakonshme e konsideron të ndaluarën të lejuar”, “Vështirësia kërkon lehtësim”, “Kur

ngushtohen rrethanat, kërkohet lehtësim”.

3. Mbështetja në shkrimet e juristëve të hershëm myslimanë dhe në ata të mëvonshmit që kanë lejuar prerjen e trupit të të vdekurit në funksion të njohjes apo të zhdukjes së shkaqeve të vdekjes, veprim që është në të mirën e përgjithshme të njerëzimit. Dijetarët hanefi, maliki, shafii dhe hanbeli, kanë lejuar që t’i hapet barku femrës së vdekur me qëllim që të shpëtohet foshnja, apo të vdekurit, nëse ai ka gëlltitur ndonjë pasuri me aq vlerë, sa që vjedhësi do të dënohej me amputim të dorës, etj. Prandaj duke u bazuar në këto shpjegime të juristëve na bëhet e qartë se është më se e lejueshme të bëhet transplantimi i organeve.

Ky komision, pasi ofron shpjegimet e juristëve myslimanë rreth kësaj çështjeje, bën të qartë se në lejin e transplantimit të organeve duhen pasur parasysh këto kushte:

1. Të ketë aprovimin me shkrim nga dhuruesi i organit e, më pas, miratimin e njërit prej prindërve pas vdekjes së tij, apo të merret leje nga prijësi i myslimanëve, nëse të vdekurit nuk i dihet prejardhja.

2. Ai që merr organin të ketë nevojë për organin e tjetrit dhe që marrësi të shpëtojë jetën apo ndonjë pjesë të trupit. Kjo duhet të bëhet nga një komision i mjekëve të besueshëm myslimanë.

3. Ai që dhuron organin të mos ketë pasoja apo rrezik për jetë e, nëse ka rrezik, nuk lejohet transplantimi i organit edhe nëse dhuruesi pranon.

4. Transplantimi të mos deformojë trupin e dhuruesit.

5. Nuk lejohet të bëhet transplantimi me qëllim fitimi apo përfitimi material.

Në fund, komisioni i fetvave tërheq vërejtjen që të kihet kujdes në transplantimin e organeve në mënyrë që të aplikohet vetëm në raste të domosdoshme dhe se mjekët që bartin këtë përgjegjësi të kenë frikën e Allahut të Lartësuar.

Këshilli i Akademisë Islamike të Fikhut, në mbledhjen e tetë të radhës, të mbajtur në ndërtesën e Ligës së Botës Islame në Meke, nga data 19 deri më 28 janar 1985, shqyrtoi temën lidhur me transplantimin e organeve. Tema u shqyr-tua në bazë të kërkesës së paraqitur në Akademinë e Fikhut nga zyra e Ligës së Botës Islame në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ndërsa këshilli bëri prezantimin e studimit mbi këtë temë, të cilën e paraqiti profesori i nderuar, shejhu Abdullah bin Abdurrahman el-Bessam, bëri gjithashtu prezantimin e kundërshtimeve mes fukahave të kësaj kohe lidhur me transplantimin e organeve si dhe argumentimet e çdonjërës palë me argumente të shariatit që ata i panë sipas opinioneve të tyre.

Pas debateve të gjera, këshilli i konsideroi më me peshë ar-

gumentet e atyre që ishin pro lejimit të transplantimit, duke ardhur në përfundimet e mëposhtme:

Së pari, marrja e organit nga trupi i personit të gjallë dhe vendosja e tij në trupin e një personi tjetër, për shpëtimin e jetës apo për të kthyer funksionimin e organeve vitale të tij, është një veprim i lejuar, i cili nuk bie në kundërshtim me vlerën njerëzore të atij që i është marrë organi, siç është edhe një dobi dhe ndihmë e madhe ndaj personit tjetër. Pra ky është një veprim i lejuar dhe i lavdëruar nëse i plotëson kushtet vijuese:

1. Marrja e organit nga dhuruesi të mos i cënojë atij jetën e zakonshme, sepse rregulli i sheriatit thotë: *“dëmi nuk bën të largohet me një dëm, i cili është në masë të tij dhe as me dëmin që është më i madh se ai”*, dhe se dhënia e organit në këtë formë është shkatërrim i vetes dhe kjo është e ndaluar, sipas Sheriatit.

2. Dhurimi i organit të jetë i vullnetshëm, pa detyrim me dhunë.

3. Transplantimi i organit të jetë mjeti i vetëm mjekësor i mundshëm për shërimin e të sëmurit, i cili është në gjendje kritike.

4. Operimi i marrjes dhe vendosjes së organit të jetë i realizuar me sukses.

Së dyti, transplantimi me mënyrën më të preferuar, sipas Sheriatit konsiderohet i lejuar në këto raste:

1. Marrja e organit nga një person i vdekur për shpëtimin e jetës së një personi të gjallë, me kusht që personi nga i cili është marrë ai organ, të jetë i moshës madhore dhe të ketë dhënë lejen për këtë gjatë jetës së tij.

2. Organi të merret nga një kafshë që i hahet mishi, apo nga një kafshë tjetër në raste të domosdoshme dhe vendosja e tij tek njeriu.

3. Marrja e një pjese të trupit të njeriut për ta vendosur në një vend tjetër të një personi, si rasti kur merret një pjesë e lëkurës apo e ashtit për ta vendosur në një pjesë tjetër të trupit.

4. Vendosja e një cope metali apo materiali tjetër në trupin e njeriut për mjekimin e gjendjes së tij, siç janë nyjet, kanalet e zemrës, etj.

Të gjitha këto raste këshilli i konsideron të lejuara, sipas Sheriatit, me kushtet e mëparshme.⁴

OBDUKSIONI

Dijetarët myslimanë e lejojnë obduksionin e kufomës duke u bazuar në rregullën e sheriatit: “Nevoja e jashtëzakonshme

4. Nga libri Fikhun-nevazil - diraseh te'silijeh tatbikijeh - i autorit Muh - med bin Husejn el- Xhizani

e lejon të ndaluarën”, në këto raste:

1. Kur është nevoja për të zgjidhur ndonjë shpjegim të domosdoshëm, d.m.th. kur ndodh që dikush të ketë vdekur apo të jetë mbytur në rrethana të paqarta dhe se ekziston bindja që me anë të mjekësisë ligjore, duke u bërë obduksioni, do të arrihet të kuptohet arsyeja dhe shkaku i vdekjes së të vdekurit apo të të mbyturit. Këtë qëndrim dijetarët e mbështesin në analogjinë e shëndoshë në disa çështje, si p.sh. nëse vërtetohet se fëmija që gjendet në barkun e nënës së vdekur është ende i gjallë, lejohet t'i hapet barku vetëm e vetëm të shpëtojë fëmija. Ndaj, duke bërë analogji me këtë rast, dijetarët lejojnë edhe obduksionin e kufomës.

2. Kur shihet se është më së e nevojshme për të studiuar çështje të mjekësisë dhe ky veprim bie në kategorinë e farzi kifaje, lejohet të bëhet obduksioni me qëllim mësimi dhe studimi. Obduksioni për shkak të mësimit mund të ndodhë pasi të sigurohen këto veprime:

- Të merret pëlqimi nga ana e të afërmeve të kufomës

- Nëse i vdekuri nuk ka pasardhës, duhet të japë leje organi kompetent i shtetit.

DHËNIA E GJAKUT

Në raste të jashtëzakonshme lejohet dhënia e gjakut, por kushtëzohet që jeta dhe shëndeti i dhënësit të gjakut të mos ketë pasoja dhe rrezik për shëndetin e tij; po ashtu, nuk lejohet që dhënia e gjakut të bëhet me pagesë.

Shënim: Të gjithë dijetarët janë të një mendjeje se nuk lejohet shitja e organeve dhe e gjakut. Ai që është në gjendje të vdekjes klinike konsiderohet i gjallë dhe ndalohej në mënyrë të prerë që të merret ndonjë organ prej tij.

PËRFUNDIM

U bë shumë e qartë se çështja e transplantimit të organeve, obduksioni dhe dhënia e gjakut nuk kanë qenë të njohura në kohën e të Dërguarit (s.a.v.s.), ndaj edhe për këto çështje nuk ka tekste (ajete dhe hadithe).

Dijetarët myslimanë ndajnë dy mendime rreth transplantimit të organeve: disa mendojnë se nuk lejohet transplantimi dhe sjellin faktet dhe argumentet në të cilat e mbështesin mendimin e tyre. Ndërsa të tjerët janë të mendimit se lejohet transplantimi i organeve, por vendosin disa kushte dhe sjellin argumentet dhe faktet e tyre.

Si përfundim, mund të thuhet se transplantimi i organeve mund të aplikohet vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe kurrsesi nuk lejohet të merret pagë për dhurimin e ndonjë organi. Veç kësaj, ai mund të bëhet vetëm me pëlqimin e dhuruesit.



Me shami të bardhë

Vehap S. Kola

Nëna ime është grua që jeton më shumë me mua, dhe e vetmja me të cilën unë s'dua të ndahem asnjëherë. Me këtë dashuri e kremtoj çdo mëngjes përjetësinë, kur dal nga shtëpia për të siguruar jetesën e përditshme të familjes sime dhe ajo më përcjell me bekime e druajtje dhe, në një gjest gati ritual, zgjidh e lidh shaminë e saj të bardhë dëborë. Po ju betohem me gjithë shpirt, nga të gjitha gratë që mbajnë një shami mbi kokë, nëna ime e lidh shaminë në një mënyrë krejt të ndryshme. Nëse ndodh që ajo të largohet nga kjo jetë dhe të më lërë mua në krahët e saj, unë do ta kujtoj gjithmonë këtë ritual të pandërgjegjshëm të mëngjesit.

Sa herë që hapet debat mbi statusin social e juridik të grave që mbajnë shami mbi kokë, mendoj për nënën time. Dhe pyes: po sikur nëna ime të ishte 45 vjeçe (ju garantoj se do të mbante shami gjithsesi, duke e njohur ndjesinë e saj të turpit nga zbulimi i kokës), të ishte shkolluar në Institutin e Lartë të Shkodrës (kështu quhej Universiteti i Shkodrës, ku shkolloheshin studentët nga veriu i vendit), dhe të aplikonte për një vend pune në shkollën ku unë u shkollova, a do të refuzohej ajo vetëm se mbante shami mbi kokë dhe mantel të gjatë deri në fund të këmbëve? Nuk dua të hap diskutime mbi ndikimin e feve monoteiste në formimin e identitetit të individit shqiptar, por guri që hidhet në liqenin e qetë të fesë islame, sa herë përgojohet pamja e grave tona, turbullon gjer në fund përcaktimin tonë shoqëror si një komunitet njerëzish të lirë dhe të barabartë përballë të drejtave dhe përgjegjësisë qytetare.

Botëkuptimi prej nga lindin edhe nismat ligjore për të “zhveshur” shkollimin laik nga “ndikimet fetare”, në fakt injoron kulturën e popullit shqiptar dhe pozicionohet në anën e antikulturës dhe antivlerave, duke mos merituar as edhe më të voglën tundje të kokës në shenjë miratimi për zgjedhjet e tij. Gratë shqiptare në të gjitha qytetet dhe fshatrat e banuara prej shqiptarëve në Ballkan, pa dalluar se cilës fe i përkisnin, historikisht e mbulonin kokën. Nëse zyrtarët shtetërorë përveshin duart për t'i hyrë punës që të bëjnë dallimin midis mënyrës tradicionale të mbajtjes së shamisë dhe asaj misionare të shfaqjes së simboleve fetare në institucione publike, atëherë unë (dhe mendoj se nuk jam aspak vetëm në këtë ndjesi) ndjej neveri për banalitetin e kauzës së tyre. Për çfarë i kemi zgjedhur ne këta njerëz? A është ky njëri prej

shqetësimeve dhe pyetjeve për të cilat njerëzit në Shqipëri (apo edhe Kosovë) presin përgjigje? Njëmend pyes, i është ankuar kush ndokujt prej tyre për “nevojën e ngutshme” të përmirësimit të mirëqenies së popullit dhe “emancipimit të sistemit arsimor” përmes “zhveshjes” nga simbolet fetare? A është sfidë e administratës shtetërore prania e grave “misionare” me shami, të cilat jo vetëm nuk përkushtohen ndaj detyrës së tyre ligjore të shërbimit civil, por e kanë shndërruar administratën shtetërore dhe institucionet arsimore në tribuna të propagandës fetare? A ka ngecur rrota e karrocës së Ministrisë së Arsimit që endet për reformën e pandalshme në arsim, në zgjidhjen e këtij “ngërçi”? Ka aq shumë pyetje për të drejtuar, të cilave Ministria e Arsimit nuk u ka dhënë asnjë përgjigje, ose i ka keqadresuar, sa që ajo s'do të kishte aspak kohë të lirë të mendonte për të kështuquajturat “sfida të arsimit laik”.

Është hera e dytë që nëna ime shtrëngohet dhe vihet përpara përgjegjësisë për shkak se mbi kokën e saj, ajo mban një shami (të bardhë). Për herë të parë, në vitin 1967, komunistët sollën në vendlindjen time, një orientim sipas të cilit gratë duhej të hidhnin në tokë shamitë dhe të shkurtonin fustanet, për të shpëtuar nga mendësitë primitive dhe prapambetjet me origjinë fetare e t'i bashkoheshin revolucionit kulturor. Atëherë një poet dhe intelektual nga vendlindja ime u ngrit dhe e kundërshtoi këtë nismë dhe pas një kalvari 20 vjeçar në Spaç e Burrel, përfundoi në litar në vitin 1988. Kjo është hera e dytë. Por nëna ime nuk pranoi asnjëherë të hidhte përdhe shaminë që mban mbi kokë. Ajo sot më ngjan me Gjalicën, që është një mal i lartë ku çdo ditë perëndonte die-lli im i fëmijërisë dhe që mbante gjatë gjithë vitit një kapelë të bardhë dëbore. Gjalica nuk ka pranuar asnjëherë të përbaltë dëborën e saj dhe nëna ime, ashtu si Gjalica, nuk do të pranojë asnjëherë të përbaltë shaminë e saj të bardhë, edhe pse flokët e saj dallojnë pak nga ngjyra e bardhë e shamisë. Në fakt, ajo që nuk merret parasysh, fatkeqësisht, kur mendohet ndaj mënyrës së veshjes së gruas myslimane, është prania e pandërprerë e kësaj tradite në vetë kulturën shqiptare dhe në thelbin e identitetit të gruas shqiptare edhe gjatë viteve të vështira të diktaturës komuniste.

Mjeshtri në pikën e vdekjes

Në pikën e vdekjes, teksa ishte gati ta lëshonte shpirtin prej buzëve të tij, një mjeshtër shqiptoi këto fjalë të mrekullueshme: "Oh, sa do të kisha dëshiruar që shpirti im të shqyhej dhe zemra ime të hapej dhe t'u ofrohej të gjithëve, derisa ndokush të mund të zbulonte vuajtjet e mia të hidhura e të kuptonte se ai që dëshiron të depërtojë në sekrete nuk mund të adhurojë idhuj, duke qenë se është e pamundur të bëhet hile!"

Në fakt vetëm ky do të thotë shërbim i vërtetë, ndërsa gjithçka tjetër nuk është më shumë se kotësi. Të shërbesh ose të mos jesh, do të thotë të përunjesh vetveten. Por ti kërkon të bëhesh i ngjashëm me Zotin, jo shërbëtori i tij! E kur vallë do ta gjesh forcën për t'u përunjur? Përkulu, bëhu shërbëtor i përunjur, nëse do të jetosh me të vërtetë! Dhe si shërbëtor ji gjithnjë i druajtur, madje druajtja duhet të jetë objekti i vetëm i ambicjes sate. Shërbëtori që kalon përgjatë rrugës pa druajtje, do të dëbohet nga oborri i Mbretit. Alkova e Tij është e ndaluar për shërbëtorin që nuk e njeh druajtjen, por do të jetë shpërblimi i duhur për atë që është i druajtur.

Një shërbëtor që i mungon druajtja

Mbreti i dhuroi njërit prej shërbëtorëve të vet një tunikë të mrekullueshme. Ky e veshi dhe doli nga pallati. Pluhuri i rrugës ia mbuloi fytyrën dhe ai e fshiu me mëngën e tunikës. Një ziliqar shkoi dhe i kallëzoi mbretit: "Zotëri. Ai shërbëtor e ka fshirë fytyrën me tunikën që ti i ke dhuruar". Sovrani e shkarkoi menjëherë atë shërbëtor, duke e dënuar fatkeqin me torturë. Dije pra, se kush nuk e njeh drojën në oborrin e Mbretit, nuk do të ketë kurrfarë vlere.

Mbulesa është besim, jo simbol

Të nderuar lexues! Të gjithë jemi dëshmitarë se çfarë po thuhet rreth njërit prej parimeve të Islamit, rreth njëres prej farzeve të Islamit, që është shamia.

Dijetarët myslimanë janë të një mendimi se mbulesa është obligim fetar, urdhëruar nga Allahu (xh.sh.) dhe i Dërguari i Tij.

Historikisht, mbulesa daton që nga njeriu i parë, Ademi (a.s.) dhe bashkëshortja e tij Havaja, pasi Allahu (xh.sh.), u dha atyre mundësinë që të viseshin dhe i udhëzoi se si duhej të mbulohehin. Pastaj, është e pamohueshme se edhe tek ithtarët e Librit (të krishterët dhe çifutët) ka ekzistuar mbulesa si dispozitë fetare. Këtë e dëshmojnë shumë citate nga Dhjata e Vjetër dhe e Reja.

Aplikimi i gjithçkaje që Allahu e ka bërë të detyrueshme, është në dobi të njeriut dhe të shoqërisë brenda së cilës ai jeton. Vlen edhe e kundërta e asaj që sapo thamë. Aplikimi i gjithçkaje që Allahu e ka shpallur si të ndaluar, është i dëmshëm për njeriun dhe rrethin e tij.

Mbulesa është urdhri i Allahu (xh.sh.), që duhet të zbatohet domosdoshmërisht. Allahu i madhëruar ka thënë: **“Thuaju besimtareve të ulin shikimet e tyre,** (nga e ndaluara), **ta ruajnë nderin e tyre** (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme) **dhe të mos i shfaqin stolitë**

e tyre, me përjashtim të atyreve që janë të dukshme. Le t’i mbulojnë kraharoret me mbulesat e tyre...” (Nur, 31)

Mbulesa është shenjë e përkushtimit (nënshtrimit) ndaj Allahut (xh.sh.). Në Kuran thuhet: **“Kur Allahu ose i dërguari i Tij kanë vendosur për një çështje, nuk i takon** (nuk i lejohet) **asnjë besimtari dhe asnjë besimtareje që në atë çështje të kërkojnë ndonjë zgjidhje tjetër. E kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai ka për të humbur.”** (Ahzab, 36)

Mbulesa është besim. Në një ajet kuranor thuhet: **“O Pejgamber! Thuaju grave dhe vajzave tuaja, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesat e tyre (të kokës) përreth trupit.”** (Ahzab, 59)

Allahu nuk u është drejtuar me urdhërin e Tij për mbulesë jobesimtareve, por besimtareve. Ai ka thënë: **“Dhe thuaju besimtareve...”** dhe gjithashtu ka thënë: **“dhe grave të besimtarëve...”**

Një ditë, tek nëna e besimtarëve, Aishja (r.a.), hynë disa gra nga fisi Benu Temin me rroba të holla dhe të tejdukshme. Ajo iu drejtua atyre duke u thënë: “Nëse jeni besimtare, kjo nuk është veshja e besimtareve, e nëse nuk jeni besimtare, atëherë kënaquni me atë veshje.” (Mealim Es-sunen 4.376)

Disa nga kushtet që duhet të plotësojë veshja e fem-



“Çdo fe ka moralin e vet, ndërsa morali i Islamit është turpi.”

~ Muhamedi (a.s.) ~

rës myslimane janë:

1) Mbulimi i të gjithë trupit përveç fytyrës dhe duarve deri në kyçe.

2) Të mos i përngjajë veshjes së burrave. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“Nuk është prej nesh gruaja që u përngjan burrave, dhe burri që u përngjan grave.”*

3) Të mos jetë e tejdukshme. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“Dy grupe nga banorët e Xhehenemit ende s'i kam parë. Njëri prej tyre është grupi i grave të veshura si të zhveshura. Ato nuk do të hyjnë në xhenet dhe as do t'ia ndjenë erën atij.”* (Muslimi)

I Dërguari i Allahut i ka cilësuar këto gra të veshura si të zhveshura, sepse ato veshin rroba, por përsëri janë të zhveshura, sepse veshja e tyre nuk e kryen funksionin e të mbuluarit, ajo është e hollë dhe e tejdukshme. Ky është një paralajmërim që vlen edhe për kohën tonë.

Në lidhje me mbulesën duhen pasur parasysh këto tri çështje.

1. Nijeti (qëllimi). Veshja e Hixhabit është përmbushje e një prej urdhrave të Allahut. Hixhabi duhet të vishet vetëm me qëllimin e përmbushjes së urdhrit të Allahut duke kërkuar kënaqësinë e Tij.

2. Dituria. Buhari, dijetari i madh i Hadithit, ka thënë: *“Dituria duhet t'i paraprijë çdo veprimi apo*

thënieje”. Prandaj motra myslimane duhet të kërkojë dituri për çështjen e Hixhabit në Kuran, në Sunetin e Profetit dhe në literaturën islame, në mënyrë që të jetë sa më e qartë dhe e sigurtë në vetvete.

3. Dashuria. Një nga shenjat e besimit të vërtetë është të bërit e çdo adhurimi me dashuri.

Mbulesë, në kuptimin e saj të përgjithshëm, do të thotë kultivim i vlerave fetare dhe morale. Ajo njëkohësisht është stimulim i ndershmërisë dhe pengesë kundër të këqijave dhe të të shëmtuarave në veprat e njerëzve.

Gjëja më e madhe dhe më e shtrenjtë që zotëron gruaja është turpi, i cili arrin kulmin kur ajo vesh hixhabin. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“Çdo fe ka moralin e vet, kurse morali i Islamit është turpi”, “Turpi është prej imanit, ndërsa imani (të shpien) në Xhenet”, “Turpi dhe imani janë të pandarë. Nëse njëri zhduket, zhduket edhe tjetri.”*

Aishja (r.a.), tregon: *“Kam hyrë disa herë e pambuluar në shtëpinë ku është varrosur i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe babai im (Ebu Bekri r.a.) duke menduar se aty ishin të varrosur burri dhe babai im. Por kur aty u varros edhe Omeri, (r.a.), nuk kam hyrë brenda e pambuluar, sepse më vinte turp nga varri i Omerit (r.a.)”* (Hakimi, Hadithi është sahih sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit).

Sindikoi Islami në shkencë

Maksud Aftab

Gjatë Mesjetës bota islame kishte një ndikim shumë të rëndësishëm në Europë, i cili si rrjedhim hapi rrugën për epokën e Rilindjes dhe Revolucionit Shkencor. Në periudhën e Mesjetës Islami dhe myslimanët ndikuan në Europë me mënyra nga më të ndryshmet. Një nga mënyrat më të rëndësishme të këtij subjekti ishte shkenca.

Që me lindjen e Islamit, myslimanët kanë bërë hapa të shkëlqyera në fushën e shkencës. Qytetet si Bagdadi, Damasku, Kajro dhe Kordoba ishin qendrat e civilizimit. Këto qytete po lulëzonin dhe shkencëtarët myslimanë bënë progrese të mëdha në zbatimin e shkencës dhe të teknologjisë teorike. Mirëpo në Europë situata ishte shumë më e ndryshme. Europa ishte në periudhën e saj të errët. Ajo nuk kishte infrastrukturë ose një qeveri qendrore. Për myslimanët, Europa ishte e prapambetur, e paorganizuar, që nuk kishte asnjë rëndësi strategjike dhe ishte para së gjithash e pavend. Duke marrë parasysh periudhën e kohës kjo ishte e vërtetë. Sidoqoftë, kisha katolike (e cila në këtë kohë ishte institucioni më i fortë në Europë), e bindi në mënyrë të suksesshme Europën e krishterë se myslimanët ishin jobesimtarë. Kjo bëri që europianët të mendojnë se myslimanët ishin më të ulët me kulturë se Europa dhe në këtë mënyrë Europa ishte e paaftë që të përfitonte nga zbulimet e reja shkencore të bëra në vendet islame përpara vitit 1100. Duke

bërë këtë, Europa e mbajti veten e saj në periudhën e errësirës, ndërkajq që nga Kina deri në Spanjë civilizimi islam përparoi. Gjatë kryqëzatave kontakti mes myslimanëve dhe të krishterëve ishte i kufizuar dhe nuk ishte transmetuar shumë dituri. Siç e ka shpjeguar A. Lewis, “Kryqtarët ishin njerëz të luftës, jo njerëz të diturisë”. Shkëmbimi i vërtetë i ideve, i cili udhëhoqi në revolucionin shkencor dhe në epokën e Rilindjes ngjau në Spanjën myslimane.

Kordoba ishte kryeqyteti i Spanjës myslimane. Shpejt ajo u bë qendra e të gjitha njohurive dhe e mësimin për tërë Europën. Dijetarët dhe studentët nga pjesë të ndryshme të botës dhe të Europës vinin në Kordoba për të studiuar. Kontrasti në aktivitetin intelektual vërtetohet shumë qartë vetëm me një shembull: “Në shekullin e nëntë, biblioteka e manastirit të St. Gallit, që ishte më e madhja në Europë, mburrej me 36 vëllime. Në të njëjtën kohë, biblioteka e Kordobës përmbante më shumë se 500.000 vëllime!”

Ideja e universitetit ishte një koncept i huazuar nga myslimanët. Universitetet e para u shfaqën në botën islame nga fundi i shekullit 600 dhe fillimi i shekullit 700. Në Europë, disa prej universiteteve të hershme janë ato nën sundimin e Universitetit të Parisit dhe të Oksfordit, të cilët janë themeluar rreth shekullit XIII.

Këto universitete të hershme europiane janë theme-luar gjithashtu të njëjta me ato islamet dhe historianët e drejtë i kanë zbuluar ato në sistemin islam. Organi-zimi i brendshëm i këtyre universiteteve europiane ishte shumë i ngjashëm me ato islame, për shembull, ideja e diplomimit (Sahib) dhe e studentit (mutafak-kih) është përfutur direkt nga termat islame.

Në fushën e matematikës, numri zero (0) dhe sistemi dhjetor ishin futur në Europë nga myslimanët, të cilët u bënë bazat e revolucionit shkencor. Numrat arabe të sjellura gjithashtu në Europë i bënë më të lehta de-tyrat matematikore, dhe problemet që kërkonin ditë për t'u zgjidhur tani mund të zgjidheshin brenda disa minutash. Veprat e Al-Kharizmit (Algorismus) ishin përkthyer në latinisht. Algorismus, nga i cili rrjedh termi matematikor "algorizmi", shkroi Sindhind-in, një përmbledhje e tabelave astronomike. Ç'është më e rëndësishmja, shkroi veprën bazë për algjebren dhe gjeti metoda për përdorimin e problemeve të vështira matematikore, si rrënjët katrore dhe thyesat e përbë-ra. Ai udhëhoqi eksperimente të shumta, mati lartësi-në e atmosferës së tokës dhe zbuloi parimet e lenteve zmadhuese. Shumë prej librave të tij u përkthyen në gjuhët europiane. Vepra trigonometrike e Alkirma-nit të Toledos, përkthyer në latinisht (nga e cila ne marrim funksionet e sinusit dhe të kosinusit), është më përpara se ajo e diturive greke të gjeometrisë së Euklidit. Së bashku me matematikën edhe shumica e njohurive të tjera në fushën e shkencës së fizikës u transportuan.

Kontributet islame në shkencë tashmë po përkthe-heshin dhe po transferoheshin me të shpejtë nga Spanja në pjesën tjetër të Europës. Punimet e Ibnul Hairhamit mbi Optikën (në të cilat ai merret me 50 pyetje mbi Optikën, të shtëna në dorën e dijetarëve myslimanë prej Frankëve), ishin përkthyer tërësisht. Myslimanët zbuluan parimin e lavjerrësit, i cili përdorej për matjen e kohës. Shumë nga parimet e Isak Njutonit e kishin burimin nga kontributet e mëpar-shme të shkencës islame. Në fushën e kimisë shumë punime islame ishin përkthyer në gjuhën latine. Një nga fushat e studimeve të kësaj disipline ishte alkimia. Myslimanët me zbulimin e elementeve të ndryshëm, zhvilluan një arsyetim të mirë të formimit fizik të lë-



ndës. Xhabir ibn-Hajjam (Xheber) ishte kimisti udhë-heqës në botën islame dhe shumë dijetarë e lidhin me të hyrjen e "metodave shkencore". Një numër i madh i termave të përdorura në kimi si alkooli, (a) lembiku, alkali dhe eliksiri janë me origjinë islame.

Mjekësia ishte një shkencë çelës e zbuluar nga mys-limanët. Al-Razi është njëri nga doktorët dhe shkrim-tarët më të famshëm të historisë islame. Çdo qytet i madh kishte një spital. Spitali i Kajros kishte më shu-më se 8000 shtretër, me salla të ndara për ata me tem-peraturë, me oftalmi, dizanteri dhe raste kirurgjike. Ai zbuloi origjinën e sëmundjes së lisë dhe tregoi se një njeri mund ta fitojë atë vetëm një herë në jetën e tij, prandaj tregoi ekzistencën e sistemit imunitar dhe se si funksionon ai. Doktorët myslimanë ishin gjithash-tu të vetëdijshëm për cilësitë ngjitëse të sëmundjeve. Me qindra punime mjekësore ishin përkthyer në la-tinisht.

E gjithë kjo dituri e transmetuar nga myslimanët tek europeanët ishte materiali i gjallë jetësor për re-volucionin shkencor. Myslimanët jo vetëm që kaluan nëpër veprat klasike greke, por gjithashtu përhapën teori shkencore të reja, pa të cilat Rilindja Europiane nuk do të kishte ndodhur. Në këtë mënyrë, megjithë-se shumë prej kontributeve islame mbetën të papra-nueshme, ato luajtën një rol përbërës në transformi-min europian.

Marrë nga *The Islamic Herald*, Mars 1995

Përktheu nga gjuha angleze:

Ermal Bega

Farabiu

(259-339 H / 870-950)

Fas Kindiut, i cili hodhi themelet e filozofisë islame, në skenën e historisë së mendimit u shfaq Ebu Nasr Farabiu (259-339 h. / 870-950), që i forcoi bazat dhe strukturën e saj. Arabët e quajtën Mjeshtri i dytë, duke konsideruar Aristotelin si Mjeshtrë të parë.

Farabiu lindi në fshatin Vasixh, jo larg Farabit. Me prejardhje qe turk, prandaj përkrah gjuhës turke dhe persiane, ai mësoi edhe arabishten. Studioi dituritë fetare dhe të sheriatit, për të kaluar më pas në studimin e diturive të tjera, veçanërisht matematikës dhe filozofisë. Në Bagdad qëndroi rreth njëzet vjet duke studiuar me këmbëngulje logjikën. Që në këtë kohë u shqua në planin e logjikës dhe qe i pari që e inkadroi logjikën në kulturën arabe.

Hyri në pallatin e Sejfudevle Hemedanit në Halep, ku u takua me shumë poetë, linguistë, juristë dhe shkencëtarë. Shteti i Sejfudevles mburrej me të, ashtu si mburrej shteti i Mutesimit me Kindiun. Një kohë jetoi në Damask, ku vizitonte kopshtet e këtij qyteti, i shoqëruar me librat, në mesin e shatërvanëve dhe kopshteve të gufara. Vdiq në Damask në vitin 950.

Farabiu nuk la aq shumë libra si Kindiu dhe Ibn Sinai. Shumica e librave të tij i kushtohen logjikës, e cila na detyron të hulumtojmë deri te njohja. Veprat më të rëndësishme që shkroi titullohen “Ihsau’l-ulum” (Klasifikimi i diturive), “Medinetu’l-fadila” (Qyteti i virtyt-



shëm) dhe “Musika’l-kebir” (Libri i madh i muzikës). Këto tri vepra tregojnë qartë se Farabiu ishte një filozof humanist. Ai ia kushtoi kujdesin hulumtues më të madh njeriut, moralit dhe jetës së tij intelektuale, shoqërore dhe krijuese.

Vepra e tij “Ihsau’l-ulum” u përkthye në gjuhën latine dhe ndikoi në filozofinë perëndimore mesjetare. Farabiu i shtoi klasifikimit të njohur, në pajtim me atë të Aristotelit, shkencat mbi gjuhën, siç është, gramatika, pastaj shkencat fetare dhe të sheriatit.

Klasifikimi i Farabiut lehtësonte dallimin e ngjashmërive mes diturive. Për shembull, gramatika numërohej në thelb të hulumtimeve gjuhësore, por ajo ka ngjashmëri edhe me dituritë gjeometrike dhe mekanike. Kjo vlen edhe për logjikën. Farabiu ndjek Aristotelin, kur e kupton logjikën si mjet të diturive, jo si shkencë, siç e konsideronin stoikët. Prandaj Farabiu e përcakton logjikën si vegël (organon), mjet dhe shkathtësi, e cila “ofron ligjet, respektimi i të cilave mund ta ndreqë mënyrën e mendimit dhe ta orientojë njeriun në rrugën e së vërtetës.” Ligjet e logjikës janë rregulla që hulumtoj-

në qartësinë e të kuptuarës, ashtu sikurse përmasat, vëllimi dhe masat maten me madhësi.

Farabiu vërejti dallime themelore mes metodave të filozofëve dhe u përpoq të vërë harmoni mes tyre, në librin e vet "El-Xhemu bejne'r-rea'l-hakimejni", ku ai i thjeshtëson problemet kundërthënëse që preokuponin frymën e filozofisë islame.

Farabiu e njohu filozofinë greke autentikisht dhe besnikërisht. Mbase edhe gjuhën greke. Enciklopedisti i njohur mysliman Ibn Hallikani ka cekur se Farabiu ka qenë poliglot. d.m.th. njohës i shtatëdhjetë gjuhëve.

Sipas Farabiut, filozofia është dituri mbi çdo gjë ekzistuese. Filozofia, pra, është dituri që "zbulon fushat e diturive të metafizikës, fizikës, logjikës, matematikës dhe politikës. Nuk ekziston asgjë nga gjërat ekzistuese të botës me të cilën nuk merret, nuk vë cak dhe nuk ofron dituri filozofia."

Farabiu u mbështet edhe në aspektin sufist, duke ia parashtruar problemet filozofike më shumë simbolikës se sa eksplikimit.

Farabiu ishte i aftë të harmonizonte dy nocione që kanë të bëjnë me Zotin, nocionet Ekzistues dhe atributin e Tij të Njëshmërisë.

Vepra e Farabiut "Musika" luajti rol të madh në kulturën islame dhe evropiane në mesjetë. Farabiu ishte i pari që e vuri muzikën si shkencë të bazuar në rregulla teorike. Literatura islame gjithashtu përmend se ai ka qenë njohës i muzikës dhe se në bazë të valleve muzikore ka nxitur publikun të qeshë apo të qajë.

Tërësia e pikëpamjeve të tij mbi reformën e shtetit ka të bëjë me atë se ajo duhet të zërë fill, nga njëra anë në vlerat etike dhe, nga ana tjetër, në shkathtësi. Sipas Farabiut ekzistojnë tri lloje vlerash: spekulative, intelektuale dhe morale. Në veprën e vet Tahsilu's-seadeti (Arritja e lumturisë) ai shkruante se "Ekzistojnë tri lloje vlerash që, kur konkretizohen në mesin e popujve, përcaktohet edhe fati i tyre në këtë botë, që janë: vlerat spekulative, morale dhe shkathtësitë praktike."

Vlerat spekulative janë dituri të ndryshme që kanë për qëllim njohjen e gjërave që ekzistojnë. Ato mund të jenë dy llojesh. Lloji i parë janë natyrore dhe të fry-

mëzuara, kurse lloji i dytë arrihen me spekulim, ekzaminim, deduktim, mësim dhe studim. Janë tri shkenca: metafizika, fizika dhe matematika.

Vlerat intelektuale shërbejnë për arritjen e synimeve që njeriu para së gjithash i mendon dhe pastaj synon realizmin e tyre.

Sa më të dobishme dhe qëllimmira të jenë synimet, po aq të dobishme dhe qëllimmira do të jenë edhe mjetet. Rruga e sendërtimit të tyre është pikërisht ajo që është e dobishme dhe e bukur, kurse më e dobishmja dhe më e bukura në mendime dhe në shkathtësitë praktike, ku zë fill kultura e popujve, është fitimi i vlerave morale, përsosmëria morale.

Ndikimi i tij në Evropë ka qenë shumë i madh e posaçërisht në filozofinë e mesjetës, për shkak se një koleksion i traktateve të tij është botuar në gjuhën latine në Paris, në vitin 1838.

Një ndër teoritë filozofike që kanë ndikuar më tepër në filozofinë evropiane të mesjetës ka qenë teoria e dallimit në mes ekzistencës dhe esencës, gjë që haset te filozofi gjerman, teologu, matematikani, historiani, juristi, politikani Gottfried Wilhelm Leibniz (1646-1716), i cili pohonte se Zoti i ka krijuar monadat (që janë substanca të thjeshta të pavarura mes vete), por në të njëjtën kohë, Zoti e ka rregulluar sistemin hierarkik të lëvizjes së tyre, për shkak se nuk ndikojnë njëra në tjetrën.

Kjo teori ka ndikuar edhe në filozofinë e teologut Anselmo i Cunterbury (1033-1109) për formimin e teorisë së argumentimit ontologjik mbi ekzistencën e Zotit, ku thotë se ekzistenca e Zotit është e domosdoshme vetvetiu dhe se nuk ka nevojë ta argumentojë ekzistencën e tij.

Alberti i madh pati shfrytëzuar veprat e Farabiut gjatë elaborimit të filozofisë së Aristotelit.

Murgu francez dominikan Vincent de Beauvais (ka vdekur në vitin 1264), ka përmbledhur disa pjesë nga traktatet e Farabiut në veprat e tij.

Ndikimi i Farabiut në Francë ka qenë më i fuqishëm, për shkak se murgjit e shkollës Sharter, ashtu siç ka vepruar Farabiu, janë orvatur që nga shekulli XII, ta harmonizojnë filozofinë e Platonit dhe të Aristotelit.

90 vjet pas kongresit të Prishtës, në Skrapar

Hershëmëria e Prishtës daton me kalanë e saj që nga koha e ilirëve, duke u bërë qendra më e rëndësishme qytetare e luginës së mesme të Apsit në gjysmën e dytë të shekullit të 4-t para erës së re. U shkatërrua gjatë luftimeve iliro-romake dhe u ripopullua vetëm në periudhën e vonë antike, në shekujt IV-VI të erës sonë. Gjatë sundimit osman ajo përmendet në dy regjistrimet e skajshme të kryera ndër shekuj: në regjistrin osman të vitit 1431, si fshat me 18 banesa (hane) dhe në vjetarin (sallname) e Janinës të vitit 1895, si fshat që varej nga kazaja e Beratit dhe ndahej në Prishtën Myslimane me 37 banesa, me afërsisht 220 banorë dhe në Prishtën e krishterë me 74 banesa, me afërsisht 376 banorë.

Procesi i islamizimit duhet të jetë kryer shumë herët, po të kemi parasysh faktin që në regjistrat e jeniçerëve dhe urdhrat e sulltanit përmenden shpesh banorët dhe popullsia e Skraparit. Përveç se bënë karrierë në ushtri, administratë dhe kulturë, banorët e këtyre trevave ishin edhe zanatlinj dhe ustallarë me emër. Kështu në një ferman të datës 6 prill 1720, Sulltani urdhëronte të dërgoheshin në Nish rreth 200 ustallarë dhe punues guri nga Skrapari për të kryer punimet arkitekturore në këtë qytet të rëndësishëm të perandorisë.

Nëpërmjet dervishëve shëtitës që përhapnin mësimet e përshpirtshme, por edhe nëpërmjet jeniçerëve që, pasi kishin kryer karrierën ushtarake, ktheheshin për të mbyllur vitet e jetës në fshatrat nga e kishin origjinën, përçohej dhe plazmohej kultura e lartë dhe përshpirtshmëria të konsoliduara në qendrën e perandorisë, Stamboll. Kështu u përhap dhe u zhvillua besimi islam dhe bektashizmi në këto treva. Deri para asgjësimit të jeniçerëve dhe përndjekjes së bektashinjve, këta të fundit qenë të përhapur në të gjithë hapësirën ballkanike.

Prishta që teqeja me pasurinë më të madhe vakëf në Shqipëri, duke pasur nën zotërim Sukën dhe tri çifligje të tjera të mëdha. Hasluck e cilëson baba Tahirin si theme-

lues të kësaj teqeje, rreth vitit 1800, ndërsa në vjetarin osman të vitit 1892, përmendet vetëm që baba Tahiri është varrosur në këtë teqe dhe është një figurë e kujtuar vetëm për mirë nga populli i kësaj ane. Unë ndaj mendimin e shprehur se kjo teqe ka një histori shumë më të hershme dhe të larmishme, e cila do të konkretizohet pas hulumtimeve dhe qëmtimeve të mëtejshme nëpër burimet arkivore nga studiues të ndryshëm.

Të ardhurat e mbara të kësaj teqeje lakmoheshin nga nëpunësit e shtetit, të cilët kërkonin që t'i përvetësonin ato për arsye personale. Kështu në një dokument të datës 3 gusht 1895 të ardhur në zyrën e protokollit të meshihatit në Stamboll shkruhet se “me vdekjen një vit më parë të baba Xhaferit, meqë ai nuk ka lënë pasardhës të vetin, nëpunësit civilë të kazasë së Përmetit po përvetësonin pa të drejtë pronat e luajtshme dhe të paluajtshme që baba Xhaferi dhe të parët e tij ia kishin dhuruar kësaj teqeje dhe lutej që të vihej drejtësia në vend”.

Në fillim të vitit 1920, pas Kongresit të Lushnjës, në Shqipëri u krijua një situatë e favorshme për riorganizimin e bektashinjve. Në nenin 2, të miratuar në statutin e këtij kongresi, merreshin në mbrojtje besimet fetare dhe theksohej se “Shqipëria njeh dhe mbron njëlloj synizmin, bektashizmin, ortodoksinë e katolicizmin”. Duke përfituar nga kjo dispozitë, Ahmet Turani dhe Hysen Prishta, të mbështetur edhe nga intelektualët shqiptarë, i paraqitën qeverisë së re demokratike më 13.07.1920 një program, ku kërkohej leja për thirrjen e një kongresi bektashian me motivacion “për një reformë morale bektashiane”, siç citohej nga Kryeministri Iliaz Vrioni, në shkresën e datës 23.12.1920.

Në program sqaroheshin data kur do të mblidheshin baballarët, vendi ku do të mblidheshin, teqeja e Prishtës, realizimi i kongresit vetëm nëse merrte pjesë edhe përfaqësuesi i shtetit dhe mospjesëmarrja e asnjë individi tjetër që nuk ishte llogaritur për tu thirrur.

Mund të thuhet se, po të mos ishin faktorët që ndikonin negativisht në rrjedhën e ngjarjeve në tri dekadat e para të shekullit XX, shqiptarët do të kishin bërë shumë më përpara dhe do të kishin ngritur institucione të fuqishme zyrtare dhe private, pasi ata kishin qenë pjesë e konsiderueshme e administratës së lartë perandorake osmane, duke mbajtur për një kohë të gjatë poste të rëndësishme ushtarake, administrative dhe fetare në këtë perandori. Dokumentet në lidhje me këtë ngjarje të rëndësishme, që kanë arritur të evidentohen brenda arkivit shqiptar, qoftë edhe të grupuara brenda fondit të komunitetit bektashian, janë të pakta dhe nuk përligjin bazën dokumentare që duhet të ketë shoqëruar organizimin e një ngjarjeje kaq të rëndësishme. Vetëm pjesëmarrja e baballarëve që gjenden në aktin e hartuar në përmbyllje të këtij kongresi, na lejon të hamendësojmë që baza materiale e krijuar në këtë rast duhet të jetë shumë më e plotë, por duhet një punë e madhe qëmtuese për të nxjerrë në dritë të gjitha momentet dhe përgatitjet që i paraprinë, që shoqëruan dhe pasuan këtë eveniment jo vetëm me vlerë organizative, por mbarë kombëtare. Njihet interesimi i intelektualëve shqiptarë të asaj kohe si Ferid Vokopola, Jashar Erebara, Mit'hat Frashëri dhe të tjera figura të këtij kalibri, të cilët u interesuan për zhvillimin e bashkësive fetare myslimane në Shqipëri.

Gjithashtu kemi arsye të besojmë se një pjesë e këtij dokumentacioni ka qenë hartuar në gjuhën osmane. Po të kemi parasysh faktin që shumë intelektualë shqiptarë të asaj kohe, përveç atyre që përmenda më parë, por edhe Kadri Prishtina, Hysni Curri, Hasan Prishtina, Mit'hat Frashëri e shumë të tjerë e kanë mbajtur letërkëmbimin në gjuhën osmane mes njëri-tjetrit. Për fat të keq shumë dokumente mund të jenë djegur gjatë revolucionit kulturor në Shqipërinë komuniste në vitet 1965-1967, por edhe më pas duke u trajtuar si fetare gjithçka që gjendej në gjuhët orientale (turke-osmane-arabe). Një anë negative në asgjësimin e dokumentacionit luajti edhe propaganda antifetare e revolucionit kulturor, e cila krijoi idenë se çdo gjë e shkruar me germa turko-osmane ose arabe që e natyrës fetare. Kështu vrulli i asgjësimit të shkrimeve me germa turko-osmane-arabe na ka privuar edhe nga shumë shkresa dhe letërkëmbime me të dhëna historike mbarëkombëtare që mbaheshin në gjuhën osmane.

Duke lënë mënjanë diskutimin teologjik rreth mësimave dhe riteve të krijuara nëpër shekuj nëpër urdhrat mistikë myslimanë (tariketet), e parë në aspektin historik, teqetë e tarikateve të ndryshme dhe veçanërisht atij bektashi, në trevat shqiptare kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen e kulturës së shkruar duke u shndërruar në biblioteka të sigurta në të cilat ruheshin dorëshkrimet dhe dokumentet e ndryshme me rëndësi historike. Kështu fer-

mani në bakër që sulltan Mehmeti II u lëshoi esnafëve të Beratit u ruajt një kohë të gjatë në teqenë e sheh Hasanit në Berat, ndërsa studiuesi i mirënjohur shqiptar i letërsisë së bejtexhinjve, Osman Myderizi, e zbuloi këtë zhanër të letërsisë shqiptare pikërisht gjatë shëtitjeve të tij nga njëra teqe bektashinje në tjetrën në Jug të Shqipërisë. Prandaj sulmet e çetave nga brenda dhe jashtë vendit, që synonin djegien e teqeve na ka kushtuar shumë në aspektin e humbjes së burimeve tona historike, kulturore, fetare dhe kombëtare.

Në kongresin bektashian në Prishtë u caktua statusi i këtij komuniteti, vërtetimi i të cilit prej Këshillit Ministror do të bënte të mundur të zbatoheshin ligjërisht de facto vendimet e marra në këtë kongres.

Në shkresën e datës 23.12.1921, hartuar nga Aqif Elbasani, drejtuar Kryeministrit në Tiranë, shkruhej se dërgohej një kopje e programit të mbledhjes që do të bënin baballarët bektashinj, në janar të 1921 dhe i kujtohej Kryeministrit se kabineti i mëparshëm u pati dhënë leje baballarëve për mbajtjen e kësaj mbledhjeje dhe për këtë ishin lajmëruar prefekturat e Beratit dhe Gjirokastrës. Në një letër të marrë prej organizatorëve Ahmet Turani dhe Hysen Prishta kërkohej që medoemos në këtë mbledhje të ishte i pranishëm një delegat i caktuar nga shteti shqiptar, madje propozohej Halim bej Gostivari ose Kadiu Vexsel efendiu. Qeveria vendosi që të dërgonte si të deleguar Fehim Zavalanin.

Statusi i këtij këshilli, që sot ruhet në AQSH, përbëhet prej 28 neneve të grupuara në katër tituj, zëvendëspindëria bektashiane në Shqipëri, arka e përgjithshme, mësimorja bektashiane dhe nyje të veçanta (shtatë të tilla). Në fund të dokumentit gjenden vulat me germa turko-osmane të baballarëve pjesëmarrës në këtë kongres, listë nga e cila shohim se merrnin pjesë nga Shqipëria e Jugut dhe një masë e madhe nga Shqipëria e Mesme, Elbasan dhe Krujë.

Në shkresën e datës 20.06.1921, drejtuar kryesisë së Parlamentit, kryetari i Këshillit Atnor bektashi Ahmet Turani, theksonte me vendosmëri se statusi i hartuar nga baballarët bektashinj në Prishtë synonte kontributin e bektashinjve **“në përmirësimin e jetës shoqërore dhe kombëtare, shpresonte lulëzimin dhe përparimin për hir të atdheut dhe përkrahjes së nacionalizimit”,** si dhe lypte **“përkrahjen e çdo shqiptari zemërbar-dhë duke i siguruar që ata nuk do të përpiqeshin për gjë tjetër vetëm se të rregullonin trupin bektashian, por pa i prurë dëm askujt, përveçse dobi dhe mirësi”.**

Skrapar 15-01-2011



Vazhdimësia e dritës Profetike, Hz. Fatma (r.a.)

Hz. Fatma është lulja e fundit e Profetit të mëshirës, vajza më e vogël, nëna e zotërinjve të rinj të xhenetit, Hz. Hasanit dhe Hz. Husejnit, gruaja e Hz. Aliut (r.a.), zonjusha e hurive të xhenetit, e nderuara e umetit të fundit, e umetit të kurorës Profetike.

Lindi në Meke një vit para profetësisë. Si vajza më e vogël që ishte, nuk u nda asnjëherë nga vatra e babait të nderuar (s.a.s.). Nganjëherë shëtiste me Profetin (s.a.s.), në rrugët e Mekes, nganjëherë e ndiqte atë nga pas..., por shpeshherë ishte e detyruar të përballej me torturat, mundimet, shtypjet, shqetësimet që përjetonte Profeti (s.a.s.), nga politeistët.

E në situata të tilla ku rrethohej nga një shoqëri injorante e vrazhdë, në rrethana rrënuqethëse, nuk kishte shembull më të mirë në durim dhe sakrificë, qëndrueshmëri dhe vetflijim në rrugë të Allahut për të, se sa vetë babai i saj, simbol i mëshirës, i cili pas çdo mudi mi a torture ngrinte duart lart duke iu lutur Zotit të tij krijues: “O Allah! Ti je gjykues, ata nuk dinë, prandaj udhëzoji”. Si shkëndijë e plotësimi të kësaj duaje (lutjeje) durimi do kurorëzohej me fitore. Fitore e cila do të çlironte dhe ndriçonte zemrën e çdo myslimani.

Hz. Fatma pati fatin të rritej dhe të edukohet në frymën e dashurisë dhe mëshirës së pafundme të këtij personaliteti shembullor. Duke jetuar në vatrën Profetike mësoi si të ishte e qëndrueshme dhe e palëkundur në rrugën e vështirë dhe plot mundime të të jetuarit si myslimane e devotshme. Ajo kultivoi dhe edukoi në brendësinë e saj të gjitha virtytet e moralit të pastër dhe të lartë, për ti paraprirë detyrës së shenjtë si nënë, veçorisë për t’u cilësuar si vazhdimësi e dritës Profetike.

Fëmijërinë e kaloi duke u përballur me shtypjet, embargot dhe bojkotet e politeistëve. Teksa po shijonte pranverën e jetës së saj, humbi nënën e shenjtë, burimin

e përkëdheljeve dhe dashurisë.

Emigroi në Medine duke i dhënë lamtumirën qytetit të Mekes, ku kishte kaluar fëmijërinë dhe rininë. Filloi një jetë të qetë me premisat për t’u bërë shembull i besimtareve myslimane.

Karakterizohej nga mirësia, qetësia, morali i lartë, butësia, zgjuarsia dhe modestia. Fjalët dhe mendimet e saj si perla ishin mbushur plot urtësi, sepse ishte pjesë e diellit të dy botëve, ishte fryt i zemrës së Profetit.

...vitet kalonin, në moshën 17 vjeçare i kërkuan dorën për martesë sahabët më të nderuar si, Hz. Ebu Bekri, Hz. Omeri, por trëndafili i kurorës Profetike pati fatin të martohej me Hz. Aliun (r.a.).

Martesa e tyre u kurorëzua me një dasëm modeste në vitin e dytë të hixhretit, shoqëruar nga një lutje dalë thellë nga shpirti dhe zemra e babait të nderuar (s.a.s.), e artikuluar me fjalë të shenjta dhe duar të ngritura drejt qiellit, ku thuhej: “Allahu im! Bëje të begatë këtë martesë, begatoje bijën time dhe zotërinë e saj si dhe brezin që do të lindë prej tyre”.

Pastaj këshilloi Hz. Fatmën duke i thënë: “Bija ime! Po të martoj me më të mirin e familjes sime, me të parin e sahabëve, me të diturin, të zgjuarin, gjykatësin e imamëve, me heroin e islamit... prandaj mos kundërshtoj asnjëherë urdhrat dhe dëshirat e tij, bindju atij me sinqeritet”.

Pastaj iu drejtua Hz. Aliut (r.a.), djalit të xhaxhait që tashmë ishte dhëndrri i tij, duke i thënë: “O Ali! Nderoj dhe respektoj Fatmën, kujdesu për të. Ajo është pjesë nga unë e nëse e mërzi atë më ke mërzi mua”.

E si nuk do të ishte e begatë një martesë e tillë e kurorëzuar nga lutja dhe këshillat e shenjta të Nderit të njerezimit (s.a.s.)?!

I riu i dashuruar

Asgjë tjetër veç emrit të saj nuk shqiptonte gjuha e të riut të dashuruar:

“Që kur e pa atë vajzë, sytë e tij s’kanë njohur gjumë. Tashmë nuk ha as nuk pi. Çfarëdo që i them nuk bën dobi, o çoban plak!” - ishin këto fjalët e shokut të të riut të dashuruar pas vajzës së mbretit.

Çobani plak, pasi vështroi të riun me dhembshuri, buzëqeshi dhe foli:

- Nëse je i pashpresë, dije mirë se shpresë është vetja jote.

Askush s’e dinte që çobani plak ishte miku më i ngushtë i mbretit, i cili, kohë më parë, i qe lutur të jetoonte aty në thellësinë e fshatit e të gostiste kalimtarët me sherbet e trëndafila të kuq...

- Do qëndrosh dyzet ditë në shpellë e do thuash: “Allah! Allah!..” - i tha plakui i mençur çobanit të dashuruar. Ai pa humbur kohë, u nis drejt shpellës me tespihët që i mbante të shtrënguara fort në duar e me zemër të lidhur së dashurës, filloi: “Allah! Allah!..”

Ashtu siç ndoqën njëra tjetrën sferat e tespihëve edhe ditët kaluan shpejt. Lajmi i çobanit në shpellë mori dhenë...

Shoku i çobanit të ri u merakos. Një ditë vendosi ta vizitonte mikun e tij. E gjeti me sy të mbyllur, të strukur e të përulur. “Paska fjetur”, mendoi për një çast, por pa si lëvizte gishtat me tespihët në dorë. U çudit.

- Allah! Allah! - pëshpëriti.

Mendoi t’i fliste shokut të tij, që nuk po shihte askund gjurmët e së dashurës, edhe pse kishin kaluar më se tri javë. U tërhoq...

Pasi nuk kishin mbetur vetëm tri ditë para se të plotësohej dyzet ditëshi, tashmë lajmi i të riut kishte mbërritur edhe në veshin e sulltanit. E dinte se njerëz të tillë ishin më të vlefshëm se vezirët, prandaj men-

doi gjatë e vendosi të kërkonte ndihmë te miku i tij, çobani plak. Rrugëtoi gjatë derisa u takua me të:

- Njerëzit e zemrës nuk presin vezirllëk, miku im, - ishin këto fjalët që i morën çdo shpresë sulltanit...

- Por mund t’i propozosh vajzën tënde, - vazhdoi ai duke buzëqeshur.

- Po si mundet? - tha sulltani i habitur. A mundet vallë të pranojë vajzën time?!

Ishte dita e dyzetë. Sulltani, çobani plak, shoku i të riut dhe një turmë e madhe njerëzish pranë shpellës. Prisnin të shihnin të riun...

Sulltani e thirri të riun, i cili nuk dukej aspak i çuditur. I propozoi vezirllëk e salltanet, por pa shpresë...

Në fund iu drejtua:

- Zotëria im! Unë kam një vajzë, të lutem pranoma atë të paktën...

Dyzet ditë vuajtje, pritje, kishin marrë fund. E pamundura ishte bërë e mundur.

I riu e kishte arritur qëllimin. Heshtja donte të ulërinte. Të gjithë sytë ishin mbi të riun.

- Jo! U përgjigj ai, nuk e dua vajzën tuaj!

Heshtja u prish. Sulltani u tërhoq. Vezirët e turma pëshpërisnin... Çobani plak buzëqeshi.

Shoku i të riut u hodh te miku i tij:

- Ç’bën? - tha ai, dyzet ditë vuajtje, heshtje, pritje. Për çfarë?

I riu po kërkonte me sy çobanin plak.

- Miku im, - tha, unë dyzet ditë përmenda emrin e Zotit për vajzën e mbretit e Ai më solli në këmbët e mia sulltanë e vizirë. Po sikur të kisha thënë Allah, për Allahun?

Gjuha heshti, zemra foli...



Ilaç i ri për shërimin e shpejtë të djegieve

Shkencëtarët kanë zhvilluar një ilaç që ndihmon në shërimin e shpejtë të djegieve serioze.

Studiuesit e Institutit të mjekësisë rigjeneruese të universitetit të Pitsburgut deklaruan se kanë eksperimentuar me sukses mbi dhjetra pacientë një lloj ilaçi në formë spreji, i cili ndihmon në shërimin e shpejtë të plagëve të shkaktuara nga djegiet, duke marrë qeliza embrionale nga pjesa e lëkurës së shëndoshë dhe duke i përzier në një solucion, me anë të një aparati sprucues aplikohet mbi plagë.

Ky ilaç aplikohet për 90 minuta dhe



plagët shërohen në më pak se katër ditë. Pasi aplikohet ilaçi, plaga mbulohet me një shtresë të veçantë dhe, derisa qelizat embrionale të zënë vendin e tyre, ky ilaç ndihmon në pastrimin e

plagës dhe ushqimin e saj me glukoz, amino-acide, antibiotikë dhe elektrolite. Me anë të kësaj teknike do të dalin nga përdorimi shumë teknika të tjera, të cilat përdoren aktualisht.

Një teknikë e re në kurimin e paralizës

Biologët rusë pretendojnë se kanë gjetur zgjidhjen për fijet nervore të këputura të cilat çdo vit bëhen shkak për paralizimin e mijëra njerëzve në mbarë botën.

Biologët rusë të cilët kanë ndjekur një rrugë ndryshe nga kolegët e tyre në përfundim, deklaruan se në vend që t'i de-tyrojnë qelizat nervore të rigjenerohen, kanë zbuluar një material përçues që do të zgjidhë problemin duke lidhur përsëri fijen nervore të këputur.

Lajmin që do të hapë horizonte të reja në mjekësi, e komunikoi një pjesëtar i Akademisë së Shkencave të Rusisë, Juri Kulçin. Në konferencën e Akademisë së Shkencave, Juri Kulçin lexoi raportin në lidhje me mënyrën e riparimit të nervit, ku ndër të tjera tha:

“Deri dje, nervi i këputur ose i dëmtuar, ishte e pamundur të riparohet dhe konsiderohej si një mrekulli. Zgjidhja e këtij problemi nuk erdhi nga fakultetet e mjekësisë, por nga Instituti i biologjisë detare që kryen studime neurologjike në një



krahinë të largët të Rusisë lindore. Specialistët tanë zhvilluan një material të ri, të aftë për të përcjellë sinjalet në sistemin nervor. Duke përdorur nano-teknologjinë, me anë të materialit të sapozbuluar lidhin me njëra-tjetrën fijet e këputura dhe kështu arrijnë të bëjnë kalimin e sinjalit elektrik në zonën e dëmtuar. Eksperimentet nxorën përfundime që na mahnitën të gjithëve. Tani jemi në fazën e eksperimentimit të kësaj teknike te njerëzit. Besoj se shumë shpejt, njerëzit që vuajnë nga paraliza për shkak të këputjes apo dëmtimit të fijeve nervore, do të shpëtojnë njëherë e përgjithmonë nga ky ankth i keq”.

Shi në shkretëtirë



Që nga vera e vitit 2010 e këtej, në disa nga vendet arabe dhe veçanërisht në Abu Dhabi, po ndodhin ngjarje të çuditshme. Në ato vende ka filluar të bjerë shi me rrebesh. Kjo dukuri është përsëritur shumë herë.

Pas këtyre ndodhive qëndron një projekt i zhvilluar nga disa shkencëtarë të kompanisë Zvicerane “Metro Systems International” të cilët financohen nga mbreti i Emirateve të bashkuara Arabe, Sheik Halife bin Zayed el Nahjan. Shkencëtarët e këtij projekti të quajtur “Weathertec” dhe për të cilin janë shpenzuar plot 11 milion dollarë, pretendojnë se kanë krijuar stuhi artificiale në qiellin pa re të shkretëtirës. Për vite me radhë arabët po shpenzojnë shumë para duke u përpjekur të bëjnë tokë pjellore dhe fitimprurëse në shkretëtirë dhe shkencëtarët gradualisht po i afrohen çdo ditë e më shumë synimit të tyre.

Drejtori i këtij projekti, Helmut Fuller, mendon se rezultatet e marra janë të kënaqshme. “Sapo kemi filluar



projektin në qershor 2010 dhe deri tani kemi arritur të krijojmë 50 stuhi shiu artificiale nga qielli i kthjellët në mes të verës në shkretëtirë”, tha drejtori për “Telegraf”. Përveç shiut, shkencëtarët kanë arritur të riprodhojnë edhe breshër, erë, madje edhe rrufe.

Bateri diellore nga silikonin i lëngshëm

Në sajë të një teknike të re të zhvilluar prej shkencëtarëve japonezë, bateritë do të karikohen me energji diellore dhe do të përdoren lehtësisht në makina dhe telefona.

Ekipi shkencor i drejtuar nga shkencëtari japonez, Tatsuja Shimoda, arriti të prodhojë një bateri diellore duke përdorur silikonin e lëngshëm.

Kjo teknikë e re, do ta ulë shumë koston e prodhimit të baterive diellore. Për shkak se teknologjia e përdorur në këtë lloj baterie është më e lirë, pritet që kostoja e baterive diellore të bjerë deri në 50%.

Profesor Shimoda thotë se, duke e zhvilluar edhe më tej këtë teknikë të re, do të arrijmë të prodhojmë një bateri, e cila do të përdoret gjerësisht në të gjithë botën.



Trevjetori i Pavarësisë së Kosovës

Kosova të enjten, me 17 shkurt shënoi tre vjetorin e shpalljes së pavarësisë së saj nga Serbia, duke bërë edhe vlerësimet për atë që është bërë e nuk është bërë gjatë kësaj periudhe. Udhë-

heqësit e saj politikë përgëzuan qytetarët e Kosovës duke vënë theksin në përpjekjet e së kaluarës dhe ndihmën e aleatëve ndërkombëtarë të saj.



Frika për kombësinë, një turp me përmasa historike

Regjistrimi i popullsisë, i cili për herë të parë do të përfshijë edhe kombësinë dhe fenë, ka marrë së fundmi një vëmendje të madhe mediatike e publike. Në tërësi ka një qëndrim kundër kësaj forme regjistrimi, përveç qeverisë, që e gatoi dhe opozitës, e cila vetëm këtë bëmë të qeverisë

nuk quan kusari. Historikisht, nga viti 1990, politika shqiptare ka qenë impotente karshi Athinës dhe ajo nuk refuzon dot as ushqimet e skaduara, nëse ato kanë etiketë greke, e jo më çështje kaq të rëndësishme për nacionalistët në Athinë. Kontestimi që i bëjnë historianët dhe në përgjithësi

shoqëria shqiptare, buron nga frika se shteti helen, me kalin e Trojës të modifikuar si ndihmë ekonomike, mund të bëjë që në Shqipëri të dalin çereku i popullsisë me kombësi greke dhe pastaj Athina do të kërkojë edhe çerekun e tokës tonë.

Përleshje në Maqedoni



Përleshje me gurë është shënuar në Maqedoni mes qytetarëve shqiptarë dhe atyre maqedonas. Përplasja në Shkup ka ndodhur për shkak se organizatat joqeveritare të drejtuara nga shqiptarët kanë thirrur një protestë kundër ndërtimit të një kisha në Kalanë e Shkupit. Ndërkohë, si kundërreagim, në një iniciativë qytetare,

maqedonasit kanë thirrur protestë në mbrojtje të ndërtimit të kësaj kisha. Reagimi i shqiptarëve në Maqedoni ka ardhur në një kohë kur kishte një marrëveshje qeveritare për ndërprerjen e punimeve të ndërtimit të kishës. Kjo nuk është zbatuar, pasi ndërtimi ka filluar në orët vona të natës.

Trazira në Libi

Protestat kundër qeverisë në Libi, të cilat po shtohen, janë përhapur për herë të parë në qendër të kryeqytetit Tripoli.

Ditën e diel për disa orë, rrugët u mbushën me turma njerëzish që hidhnin parulla për rrëzimin e qeverisë së koloneli Gaddafi.

Gjatë protestës janë dëgjuar vazhdimisht të shtëna me armë, ndërsa në

mbarë qytetin kanë lëvizur shtëllungat e gazit lotsjellës.

Disa ndërtesave iu vu zjarri, përfshirë edhe rajone të policisë.

Në agim, qendra e qytetit u duk e qetë, megjithëse janë dëgjuar vazhdimisht të shtëna sporadike me armë.



